



**DHUNA NË MARRËDHËNIET INTIME
DHE DHUNA SEKSUALE
TEK TË RINJTË NË SHQIPËRI**

Ky studim është realizuar nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) në kuadrin e programit “Mbrojtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri 2019-2021”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze.

“Ky material është plotësisht i financuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Sida nuk është domosdoshmërisht dakord me opinionin e shprehur.”

Autorët

Elona Dhëmbo
Veronika Duci

Kontribuan në të gjitha fazat e studimit:

Irena Shtraza
Ines Leskaj

Punimi grafik dhe faqosja

Eduart Cani

@Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Referenca e botimit: *Dhëmbo E., Duci V., Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri*, AWEN, 2021.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive	8
1. Hyrje	13
2. Shqyrtimi i literaturës	15
2.1. Përkufizime dhe fakte	15
2.2. Faktorët e riskut	17
2.3. Dhuna ndaj djemve dhe burrave	20
2.4. Dhuna në marrëdhënie intime tek të rinjtë	20
2.5. Dhuna seksuale në marrëdhëniet intime tek të rinjtë	22
2.6. Dhuna seksuale e lehtësuar nga teknologjia	23
2.7. DhMI në kohën e pandemisë COVID – 19	24
3. Metodologjia	25
3.1. Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore	25
3.2. Qasja metodologjike	25
4. Gjetjet	31
4.1. Të dhëna të përgjithshme	31
4.2. Stereotipat gjinorë dhe dhuna me bazë gjinore	39
4.3. Ngacmimet dhe dhuna seksuale	49
4.4. Dhuna virtuale – pornografia dhe dhuna seksuale e lehtësuar nga teknologjia	63
4.5. Krizat shoqërore dhe dhuna: rasti i pandemisë Covid19	73
5. Përfundime	76
6. Referenca	79
7. Shtojca	86
7.1. Pyetësori	86
7.2. Guida e FG	114
7.3. Lista e kërkueseve në terren	116

Lista e figurave

<i>Figura 3.1.1. Planifikimi dhe zbatimi i sondazhit</i>	26
<i>Figura 4.1.1. Vendbanimi (N = 1032)</i>	31
<i>Figura 4.1.2. Gjinia (N = 1086)</i>	31
<i>Figura 4.1.3. Arsimimi</i>	32
<i>Figura 4.1.4. Punësimi</i>	32
<i>Figura 4.1.5. Lloji i punësimit</i>	33
<i>Figura 4.1.6. Të ardhurat personale</i>	34
<i>Figura 4.1.7. Gjendja Civile</i>	34
<i>Figure 4.1.8. Përfshirja në marrëdhënie intime</i>	35
<i>Figura 4.1.9. Të pasurit fëmijë</i>	35
<i>Figura 4.1.10. Konsumimi i alkoolit</i>	36
<i>Figura 4.1.11. Përdorimi i substancave narkotike</i>	37
<i>Figura 4.1.12. Probleme të shëndetit mendor</i>	38
<i>Figura 4.2.1. Qëndrime ndaj stereotipave gjinorë</i>	39
<i>Figura 4.2.2. Qëndrimet mbi rolet e burrave dhe grave në shoqëri</i>	40
<i>Figura 4.2.3. Shqetësime nga sulme të mundshme fizike apo seksuale</i>	42
<i>Figura 4.2.4. Sjellje të adoptuara nga frika nga dhuna fizike apo seksuale</i>	44
<i>Figura 4.2.5. Perceptime mbi përhapjen e dhunës ndaj grave dhe ndërgjegjësimi për të</i>	45
<i>Figura 4.2.6. Incidenca e rasteve të njohura të dhunë ndaj grave në familje</i>	46
<i>Figura 4.2.7. Vetëvlerësim mbi nivelin e informimit për përballimin e situatave të dhunës seksuale</i>	47
<i>Figura 4.2.8. Kujt do t'i tregonte një grua e dhunuar mbi dhunën?</i>	47

<i>Figura 4.2.9. Ku do të drejtoheshit në rast dhune në marrëdhëniet intime</i>	48
<i>Figura 4.2.10. Qëndrimet mbi përfshirjen e shërbimit mjekësor në identifikimin e dhunës ndaj grave</i>	49
<i>Figura 4.3.1. Marrëdhëniet seksuale</i>	50
<i>Figura 4.3.2. Detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale</i>	50
<i>Figura 4.3.3. Përdorimi i metodave kontraceptive</i>	51
<i>Figura 4.3.4. Perceptime mbi përhapjen e dhunës seksuale ndaj grave në Shqipëri</i>	52
<i>Figura 4.3.5. Ekspozimi indirekt dhe direkt ndaj rasteve të ngacmimit/dhunës seksuale ndaj grave</i>	54
<i>Figura 4.3.6. Përjetimi i dhunës seksuale në marrëdhëniet intime</i>	55
<i>Figura 4.3.7. Përjetimi i formave të ndryshme të dhunës</i>	57
<i>Figura 4.3.8. Kërkimi i ndihmës</i>	58
<i>Figura 4.3.9. Arsyet për të kërkuar ndihmë</i>	59
<i>Figura 4.3.10. Arsyet për të mos kërkuar ndihmë</i>	60
<i>Figura 4.3.11. Qëndrimet mbi shkaqet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime</i>	61
<i>Figura 4.3.12. Qëndrimet mbi tolerancën ndaj dhunës seksuale</i>	62
<i>Figura 4.4.1. Përhapja e pornografisë: raportimet mbi perceptimet mbi bashkëmoshatarët vs. personalisht</i>	64
<i>Figure 4.4.2. “Konsumi” i pornografisë dhe gjinia</i>	64
<i>Figura 4.4.3. Bërja/marrja e imazheve nudo/me përmbajtje seksuale nga persona të njohur</i>	65
<i>Figura 4.4.4. Faktorët që do pengonin postimin online të imazheve ose videove me përmbajtje seksuale</i>	66
<i>Figura 4.4.5. Foto/video nudo apo me përmbajtje seksuale të vetes</i>	67
<i>Figura 4.4.6. Trajtimi i fotove/videove nudo apo me përmbajtje seksuale të vetes</i>	68

<i>Figura 4.4.7. Pasoja me të cilat duhet të përballen ata/o që postojnë foto & video pa pëlqimin e personave të përfshirë si dhe faqet në internet që e lejojnë këtë</i>	68
<i>Figura 4.4.7. Pasoja me të cilat duhet të përballen ata/o që postojnë foto & video pa pëlqimin e personave të përfshirë si dhe faqet në internet që e lejojnë këtë</i>	69
<i>Figura 4.4.8. Platformat më të përdorura nga shantazhuesit/et</i>	69
<i>Figura 4.4.9. Lidhja me shantazhuesi/en</i>	70
<i>Figura 4.4.10. Format dhe qëllimet e shantazhit</i>	71
<i>Figura 4.4.11. Raportimi i shantazhit</i>	72
<i>Figura 4.4.12. Burimet e mbështetjes në përballimin e situatave të shantazhit</i>	72
<i>Figura 4.5.1. Efektet e krizave shoqërore në nivelin e dhunës</i>	73
<i>Figura 4.5.2. Ndikimi i mbylljes dhe situatës së pandemisë në nivelin e dhunës së familje, marrëdhëniet në çift, komunitet</i>	74

Lista e tabelave

<i>Tabela 3.1.1. Shpërndarja e kampionit sipas qarqeve</i>	28
<i>Tabela 4.2.1. Dhuna, dhuna në familje dhe komuniteti</i>	41

Lista e shkurtesave

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
ASBI	Abuzimi Seksual i Bazuar në Imazhe
CDC	Qendra e Kontrollit të Sëmundjeve (ang. Center for Disease Prevention)
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
DFG	Diskutime në Fokus Grupe
DhMI	Dhuna në Marrëdhëniet Intime
DhSLT	Dhuna Seksuale e Lehtësuar nga Teknologjia
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Pavarur mbi Veprimin kundër Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje
INSTAT	Instituti i Statistikave
LGBT+	Persona Lezbike, Gej, Biseksualë dhe Transgjinorë +
OBSH (WHO)	Organizata Botërore e Shëndetit
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OJF	Organizata Jo – Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UN WOMEN	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Emergjencat e Kombeve të Bashkuara

Përmbledhja ekzekutive

Studimi “Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri” vjen në kontekstin e problematikave të dhunës me bazë gjinore, shtimin e sfidave si pasojë e pandemisë Covid – 19 dhe adresimin e aspekteve dhe grup – moshave më pak të studiuara. Ky studim është në vijimësi të studimit të kryer nga AWEN për të njëjtën problematikë në vitin 2019.

Qëllimi i këtij studimi është portretizimi në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse i çështjeve të dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve/të rejave në Shqipëri, nga këndvështrimi gjinor në kuadrin e dhunës me bazë gjinore në përgjithësi. Në këtë studim është përdorur metodologjia mikse: sondazhi kombëtar me N = 1095 përgjigjedhënës ka vijuar me diskutime në fokus grupe me të rinj/të reja nga zona të ndryshme të Shqipërisë dhe me profesionistë që punojnë në këtë fushë. Pyetjet kërkimore të studimit janë:

1. Cila është incidenca e dhunës në marrëdhënie intime mes të rinjve në Shqipëri dhe cilat janë karakteristikat e saj?
2. Si mund të lexohet situata e dhunës në marrëdhëniet e të rinjve në Shqipëri nga këndvështrimi gjinor?
3. Cilët janë faktorët e riskut dhe reziliencës ndaj dhunës në marrëdhëniet intime për djemtë dhe vajzat?

Gjetjet kryesore

- Në këtë studim kanë marrë pjesë 56% vajza dhe 44% djem. Ato/a banonin kryesisht në zonat urbane (63%). Thujse gjysma e përgjigjedhënësve ishin me arsim të lartë dhe 1 në 3 prej tyre ishin të punësuar, por me të ardhura personale të ulëta, kryesisht tek vajzat.
- Të rinjtë prireshin të konsumonin më shumë alkool dhe substanca narkotike në raport me të rejtat. Nga ana tjetër, vajzat kryesojnë në të gjitha format e shqetësimeve të shëndetit mendor, si p.sh 30% më shumë të reja kanë raportuar se kanë patur shqetësime me ankthin;

Stereotipat gjinorë dhe dhuna me bazë gjinore

- Ndonëse ka një trend të përgjithshëm drejt reduktimit të paragjyqimeve gjinore, ende 28% e përgjigjedhënësve janë plotësisht apo pjesërisht dakord me pohimin se gratë nuk janë aq të zgjuara sa burrat, apo 19% që nuk bien dakord se gratë mund të mendojnë në mënyrë logjike si edhe burrat.
- 33% e përgjigjedhënësve besojnë se martesë funksionon më mirë nëse bashkëshorti nuk përfshihet në punët e shtëpisë, apo se aktivitete të tilla si ndërrimi i foshnjës apo mbikëqyrja e aktiviteteve të fëmijëve janë aktivitete që i shkojnë përshtat nënave (me 51% dhe 36% respektivisht). Qëndrimet janë disi më të hapura drejt barazisë gjinore në sferën publike – punësim, marrëdhëniet shoqërore dhe edukim

(mbi 75% e pjesëmarrësve besojnë në edukimin dhe rëndësinë e edukimit në nivele të ngjashme si për djemtë dhe për vajzat).

- Ndonëse në përgjithësi duket se ka ende një sens komuniteti, ai vjen dhe zbehet nga konstatimi tek reagimi ndaj problemeve të dhunës dhe kanë pikën më të ulët tek iniciativa për të ndërhyrë apo bërë diçka (me 34%) nga fqinjët nëse dikush në komunitet do të përfshihej në një situatë dhune në familje.
- Diferencat gjinore janë më të thella dhe në disfavor të vajzave, veçanërisht në përgjigjet që tregojnë mungesën e kërcënimeve apo shkallën e sigurisë. 85% e djemve raportojnë të mos jenë ndjerë kurrë të kërcënuar nga një i/e panjohur, përkundrajt vetëm 55% të vajzave. Edhe në raport me ish-partnerët, 90% e djemve raportojnë se nuk e kanë ndjerë asnjëherë një kërcënim të tillë, përkundrajt 78% të vajzave, duke lënë rreth 22% të vajzave të shqetësuara të paktën ndonjëherë nga ish-partnerët.
- Të paktën 15% e përgjigjedhënësve raportojnë se kanë shmangur daljen vetëm nga shtëpia, vende të caktuara, qëndrimin vetëm me dikë tjetër, si pasojë e frikës/pasigurisë nga ndonjë sulm i mundshëm fizik dhe/ose seksual. Vetëm 53% e vajzave nuk kanë nguruar ndonjëherë që të dalin shtëpia vetëm përkundrajt 85% të djemve. Po kështu, vetëm 43% e vajzave raportojnë se nuk kanë shmangur ndonjëherë kalimin nga rrugë të caktuara apo vajtjen në vende të caktuara përkundrajt 77% të djemve përgjigjedhënës. Tre herë më shumë vajza sesa djem kanë shmangur qëndrimin vetëm me një koleg/shefin në mjediset e punës.
- 88% e përgjigjedhënësve raportojnë se dhuna ndaj grave është e përhapur dhe

nuk ka asnjë që të mohojë problematikën (asnjë nuk ka zgjedhur alternativën “aspak e përhapur”). Më shumë vajza (50% e tyre) sesa djem (37% e tyre) raportojnë perceptimin se dhuna ndaj grave në Shqipëri është shumë e përhapur.

- Puna për rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave të ndryshme ndërgjegjësuese duket se ka kontribuar në këto rezultate. 67% e përgjigjedhënësve kanë parë/dëgjuar mbi fushata ndërgjegjësuese kundër dhunës ndaj grave, ku mes tyre vajzat (75%) prej tyre më shumë se djemtë (59%) dhe përgjigjedhënësit në zona urbane (72% e tyre) sesa ata në zona rurale (59% e tyre) kanë qenë në kontakt me një fushatë ndërgjegjësimi kundër dhunës ndaj grave në 12 muajt e fundit.
- Në rreth 47% të rasteve përgjigjedhënësit njohin dikë në lagjen e tyre që ka përjetuar forma të dhunës me bazë gjinore në familje dhe në 41% të rasteve raportojnë për situata të ngjashme në rrethin e tyre shoqëror dhe familjar. Ndonëse me diferenca jo shumë të mëdha, vajzat më shumë sesa djemtë, zonat urbane më shumë sesa ato rurale dhe ata me arsim të lartë më shumë sesa përgjigjedhënësit më arsim të mesëm apo të ulët, kishin tendencën të raportonin/njihnin dhunën ndaj grave edhe në familje/rrethin e tyre shoqëror.
- Pengesë në raport me identifikimin/raportimin e dhunës me bazë gjinore është edhe niveli i informimit. Një në katër përgjigjedhënës nuk e kishte idenë (8%) apo nuk ndihej i informuar mjaftueshëm (18%) për të ditur se si duhet të reagojë në situata dhunë.
- Familja mbetet “streha” e parë për të kërkuar ndihmë (83%), më pas, me peshë të ngjashme janë miqtë dhe organizatat e shoqërisë civile (62% dhe

61% respektivisht). Më shumë se gjysma e përgjigjedhënësve nuk e shohin alternativë të përshtatshme raportimin e dhunës në familje tek përfaqësues të institucioneve fetare (51% nuk janë dakord). Duhet të nënvijëzohet se më shumë se 1/3 kanë të njëjtin qëndrim edhe kundrejt një oficeri/je policie (35%).

- Familja është zgjedhja e parë edhe për t'u drejtuar në rast përballje me DHMI. Më shumë se gjysma e përgjigjedhënësve raportojnë sedo i drejtoheshin njërit nga prindërit nëse partneri/ja do i kërcënonte (68%), dhunonte fizikisht (75%) apo kryente akte seksuale pa dëshirën e tyre (56%). Vendi i prindërve/familjes është i ngjashëm me atë të organizatave joqeveritare dhe policisë kur bëhet fjalë për dhunën seksuale (56%, 52% dhe 51% respektivisht). Psikologu apo ndonjë profesionist tjetër që ofron këshillim zgjidhet edhe më shpesh në këto rast (59% do u drejtoheshin atyre në rastet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime).
- Roli i shërbimeve shëndetësore në identifikimin e dhunës me bazë gjinore vlerësohet me vend dhe i pranueshëm. 68% e përgjigjedhënësve janë dakord që gjatë kontrolleve rutinë, mjekët që vënë re lëndime fizike/plagë te gratë t'i pyesin ato nëse lëndimet janë si pasojë e akteve të dhunës, ushtruar ndaj tyre. 76% e të rejave janë dakord që kjo të ndodhë përkundrejt 58% të djemve.

Ngacmimet dhe dhuna seksuale

- Një përqindje shumë e lartë e përgjigjedhënësve mendojnë se dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri është e përhapur (80%), qoftë kjo nga partnerët ose nga njerëz në rrethin e besimit apo të panjohur, edhe pse ka akoma paqartësi në përkufizimin dhe

përcaktimin e qartë të dhunës seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet intime;

- Thujse gjysma e përgjigjedhënësve kanë dëgjuar për raste të dhunës ndaj grave në qytetin ose fshatin e tyre, ndërsa 1 në 5 prej tyre në lagjen e tyre;
- Moshë mesatare e kryerjes së marrëdhënies seksuale për herë të parë është disi më e lartë sesa në studime të tjera, 18 për vajzat dhe 17 për djemtë;
- Thujse 1 në 10 vajza është detyruar që të kryejë marrëdhënie seksuale për herë të parë kundër dëshirës së saj. Vajzat kanë pothuajse tre herë më shumë probabilitet që të detyrohen të kryejnë marrëdhënie seksuale nga frika e partnerit/ish – partnerit;
- Vajzat kanë përjetuar më shpesh dhunë seksuale në raport me djemtë me diferenca të konsiderueshme që arrinin 30%, nga njerëz të njohur, shpesh të rrethit të afërt familjar dhe shoqëror si dhe nga të panjohur;
- 41% e përgjigjedhënësve kanë deklaruar se nuk kanë përdorur asnjë metodë kontrceptive në marrëdhënien e fundit seksuale, si pasojë e mungesës së informimit dhe/ose e turpmit. Përdorimi i kontrceptivëve ishte më i ulët tek ata/o që kishin kryer marrëdhënie seksuale me detyrim për herë të parë;
- 2 në 3 përgjigjedhënës nuk kanë kërkuar asnjë ndihmë për dhunën e përjetuar, qoftë fizike qoftë seksuale, për shkak të mungesës së besimit tek institucionet e ndryshme (policia dhe shërbime të tjera), ndjenjës e turpmit dhe druajtjes, dhe frikës nga prishja e reputacionit të familjes;
- Qëndrimet stereotipizuese ndaj disa sjelljeve “provokuese/ambigje” të vajzave janë ende të pranishme mes djemve dhe vajzave, si p.sh. 23% prej tyre e justifikojnë dhunën seksuale

kundër dëshirës së personit kur është paraprirë nga flirtimi, 22% kur ka veshur një sjellje provokuese dhe 16% kur personi ecën vetëm natën.

Dhuna virtuale – pornografia dhe dhuna e lehtësuar nga teknologjia

- Pornografia vlerësohet të jetë e përhapur (mjaft e përhapur 47% apo disi e përhapur 31%) midis të rinjve dhe të rejave të grup-moshës 20-24 vjeç. Megjithatë, përhapja e pornografisë tek bashkëmoshatarët është e raportuar në nivele më të larta se në planin individual (vetëm 25% e të pyeturve pranojnë se shohin porno të paktën disa herën në muaj). Më shumë djem (55% e tyre) sesa vajza (40.3% e tyre) mendojnë se pornografia është mjaft e përhapur ndër bashkëmoshatarë. Gjithashtu, i këtij mendimi janë më shumë përgjigjedhënësit e zonave urbane dhe atyre me arsim të ulët. Diferenca më e ndjeshme është ajo midis vajzave dhe djemve që raportojnë se nuk shohin kurrë porno. Rreth 59% e përgjigjedhënësve vajzave deklarojnë se nuk shohin kurrë porno kundrejt vetëm 16% të përgjigjedhënësve djem.
- Mesatarisht, të pyeturit deklarojnë se kanë parë për herë të parë porno rreth moshës 15 vjeç. Rreth 26% e tyre e kanë bërë këtë në një moshë 13 vjeç apo më të vogël dhe 10% në një moshë 18+ vjeç. Në një shkallë nga 1 (aspak) në 10 (totalisht) vlerësojnë se shikimi i pornografisë mund të ndikojë perceptimet ndaj seksit është 5.4 (mesatar) por përgjigjja më e shpeshtë është në 1 (aspak), gjë që tregon për ndërgjegjësimin e ulët mbi impaktin e pornografisë.
- Vetëm 16% e të pyeturve (ose 24% e djemve dhe 9% e vajzave) pranojnë se kanë bërë apo marrë foto nudo apo ndonjë imazh ose video me përmbajtje të qartë seksuale të një personi që njohin, përkundrajt 80% që e mohojnë një gjë të tillë.
- Ndërgjegjësimi se postimi i materialeve të tilla online mund t'u bëjë keq personave të përfshirë (58%) apo ndonjë shoku/shoqeje (33%) do ishin arsyt kryesore që do i frenonin ta bënin një gjë të tillë. E treta në listën e faktorëve frenues është frika se mund të zbulohen/kapen dhe arrestohen/ndiqen penalisht (24%).
- Rreth 17% e të pyeturve raportojnë se iu ka ndodhur të bëjnë foto nudo apo foto/video me përmbajtje seksuale ku kanë qenë të përfshirë ata vetë, me diferenca pak më të ngushta midis vajzave (14%) dhe djemve (22%) që pranojnë se kanë bërë diçka të tillë.
- Imazhe të fotove nudo apo videove me përmbajtje seksuale rezulton të jenë qarkulluar në shumicën e rasteve. Vetëm 42% e atyre që kanë realizuar foto/video të tilla të vetes i kanë mbajtur ato vetëm për vete, ndërsa 58% ia kanë dërguar ato dikujt me të cilin kanë qenë të përfshirë në një marrëdhënie seksuale/romantike (30%) apo dikujt tjetër (24%) apo kanë bërë diçka tjetër që refuzojnë ta ndajnë (28%).
- 78% e të pyeturve kërkojnë që personat që postojnë imazhe dhe/ose video pa dëshirën e personave të përfshirë duhet të ndiqen penalisht dhe dënohen me burg përkundrajt vetëm 2% që mendojnë se nuk duhet të kenë asnjë pasojë. Në mënyrë të ngjashme, 67% mendojnë se ndjekja penale duhet të jetë një pasojë me të cilën duhet të përballen edhe faqet në internet që lejojnë që një gjë e tillë të ndodhë. 52% mendojnë se ato duhet të përballen me kosto financiare (gjoba) dhe vetëm 3% nuk shohin arsye që ato të përballen me ndonjë pasojë për mundësimin e postimit/shpërndarjes së këtyre imazheve.

- Gati 1 në 10 nga përgjigjedhënesit në këtë studim raportojnë të kenë qenë të paktën një herë pre e shantazhit ku janë përdorur foto/video apo materiale të tjera me përmbajtje seksuale. 12% e vajzave dhe gati 5% e djemve e kanë pasur një eksperiencë të tillë.
- Instagrami është aplikacioni që përmendet më shpesh si platforma kryesore e përdorur nga shantazhuesit (44%), i ndjekur nga Facebook/ Messenger (26%). Nën kategorinë të tjera janë renditur edhe përdorimi i telefonatave apo komunikime me mesazhe.
- Forma më dominuese e vënies në kontakt me shantazhuesit është përmes profileve të rreme (41%). Në 39% të rasteve shantazhuesi ka qenë një i/e njohur. Në 69% të të gjitha rasteve të raportuara, shantazhuesi ka qenë mashkull, në 17% femër dhe në gati 14% të rasteve ka qenë e panjohur gjinia e shantazhuesit/es.
- Kryesisht imazhet (me 59%) dhe bisedat seksuale (33%) dominojnë ndër materialet intime që iu janë vjedhura apo janë keqpërdorur nga shantazhuesit. Në 39% të rasteve shantazhuesi ka pasur për qëllim arritje e realizimit të aktiviteteve seksuale të mëtejshme (p.sh. pas refuzimit, ndarjes etj.).
- Në rreth 29% të rasteve shantazhi ka pasur qëllim përdorimin e materialeve me përmbajtje seksuale për të kërcënuar e mbajtur nën kontroll viktimën. Eksperiencat e shantazhimit kanë zgjatur zakonisht deri në 3 muaj (71%), por nuk janë të pakta rastet kur shantazhimi ka zgjatur thuhet një vit (8%) apo edhe më shumë (3%).
- Ndonese efektet e shantazhit tek ata që kanë rënë pre e tij vlerësoheshin si mjaft serioze, raportimi i tij është në nivele të ulëta. Raportimi është

realizuar në platformat në të cilat ka ndodhur/është zhvilluar shantazhi (32%) dhe në polici (29%).

- Në përpjekjet e tyre për raportimin/ adresimin e situatës së shantazhit, 37% janë drejtuar/kanë gjetur mbështetje tek familja dhe miqtë dhe 24% kanë marrë këshillim profesional. Kryesisht të rejat dominojnë në këto zgjedhje. Të rinjtë që kanë qenë përfshirë në situata të tilla raportojnë të kenë kërkuar/ gjetur forma “të tjera” të mbështetjes.
- Ndonese organizatat e ndryshme raportohen të kenë qenë zgjedhje vetëm në 7% të rasteve, ato janë zgjedhur kryesisht nga përgjigjedhënesit në zona rurale. Nga diskutimet në DFG kuptohet se kjo mund të jetë rezultat i njohurive/ mbështetjes së ulët nga familja/miqtë në këto zona, apo nga shtrirja më e dobët e shërbimeve dhe mosbesimi më i lartë ndaj tyre në këto zona.

Pandemia e Covid - 19

- 62% e përgjigjedhënesve besojnë se krizat si p.sh. ajo e krijuar nga pandemia e Covid19 ndikojnë në nivelin e dhunës në shoqëri.
- Shumica vlerësojnë se krizat shoqërore çojnë në rritjen e dhunës në përgjithësi (83%) dhe gjysma e përgjigjedhënesve shohin si rrezik shtimin e dhunës vetëm brenda familjes.
- Ngjashëm me raportimin e dhunës, edhe në raport me efektet e pandemisë, përgjigjedhënesit tregojnë një situatë të rënduar (përkeqësuar shumë) të dhunës në komunitetin e tyre (11%) dhe lagjen e tyre (10%) sesa në familjen e tyre (5%) apo në marrëdhënien e tyre në çift (5%).

1. Hyrje

Që nga shtatori i vitit 2015, 193 shtetet anëtarë të OKB-ve, përfshi Shqipërinë, kanë përcaktuar si një nga 17 Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e vajzave dhe grave, ndër të tjera, duke luftuar dhe eliminuar dhunën me bazë gjinore ndaj vajzave dhe grave. Pavarësisht prioritizimit të kësaj problematike dhe përpjekjeve të vazhdueshme, dhuna me bazë gjinore mbetet një nga shkeljet më të përhapura dhe shkatërruese të drejtave të njeriut dhe një shqetësim për të gjitha shoqëritë (UNDP, 2020). Për më tepër, pandemia Covid-19 duket se ka ç'bërë edhe një pjesë të arritjeve. Në përpjekje për t'u përballur me Covid-19, të dhënat në nivel global tregojnë se një pandemi tjetër u shpërfaq, ajo e dhunës me bazë gjinore. Përtej vështirësive tradicionale në identifikimin, parandalimin dhe adresimin e DHBGJ, kufizimet për shkak të Covid-it e kanë përkeqësuar situatën e dhunës me bazë gjinore thuajse kudo.

Për vitin 2020, rreth 243 milion gra dhe vajza (15-49 vjeç) në të gjithë botën raportohet të kenë qenë subjekt dhune seksuale dhe/ose fizike në 12 muajt e fundit (UNDP 2020). Por moria e efekteve afatmesme dhe afatgjata të Covid-19 në aspektin ekonomik, social e politik, pritet që të shtojnë më tej incidencën e dhunës me bazë gjinore. Pasojat e pandemisë do të vazhdojnë të ndihen për shumë vite me radhë (O'Leary & Tsui, 2021; Truell & Crompton, 2020) dhe zbutja e tyre kërkon që t'i kushtohet vëmendje veçanërisht grupeve që janë goditur më fort nga pandemia – grupet, mirëqenia e siguria e të cilëve është e rrezikuar – si të moshuarit, të papunët, viktimat e dhunës në familje, dhe personat me aftësi të kufizuara (United Nations Albania, 2020).

AWEN në misionin dhe veprimtarinë e saj ka qenë dhe mbetet e vendosur për të adresuar çështjet e dhunës me bazë gjinore si dhe të përballet me sfidat e reja që parashtrihen. Kështu, në vitin 2019, AWEN realizoi studimin e parë në vend që hedh dritë mbi problematikat e dhunës në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve. Një nismë që adresonte edhe një nga hendeqet e vërejtura si në literaturën vendase, por edhe në kuadrin ligjor dhe institucional në vend. Raporti bazë i vlerësimit për Shqipërinë, i publikuar në nëntor 2017 nga GREVIO (Grupi i Ekspertëve të Pavarur mbi Veprimin kundër Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje), thekson se reagimi ligjor dhe institucional në Shqipëri përqendrohet kryesisht tek dhuna në familje. Format e tjera të dhunës, ndonëse të parashikuara si vepra penale, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur në lidhje me parandalimin dhe masat e mbrojtjes civile. Nga ana tjetër, kërkimet e viteve të fundit konfirmojnë se dhuna në marrëdhëniet intime në të gjitha moshat, por veçanërisht tek të rinjtë përbën një problem social që duhet të luftohet (Foshee e të tjerë, 2007, Barter e të tjerë, 2017). Një numër i lartë i të rejave dhe të rinjve dhunohen brenda marrëdhënies së tyre romantike. Studimet kanë treguar se pasojat e një dhunë të tillë mund të jetë serioze (Romito, Beltramini dhe Escrivà-Agüir, 2013). Studimi i tyre dhe krijimi i evidencave që do ushqejnë politikëbërjen dhe vendimmarrjen janë një hap thelbësor në adresimin e këtyre problematikave.

Ky studim vjen në kontekstin e persistencës së problematikave të dhunës me bazë gjinore, shtimin e sfidave si pasojë e pandemisë Covid – 19 dhe adresimin e aspekteve dhe grup – moshave më pak të

studiara (siç paraqitet në Kapitullin II të shqyrtimit të literaturës). Duke marrë shkas nga mungesa e studimeve kombëtare rreth natyrës gjinore, formave dhe faktorëve të riskut lidhur me incidencën e dhunës në marrëdhënie intime midis të rinjve në Shqipëri, nëpërmjet këtij studimi, AWEN synon të pasurojë hartën kombëtare të studimeve që adresojnë çështjet e dhunës me bazë gjinore në vend. Studimi vjen në vijimësi të studimit të vitit 2019 me fokus adoleshentët dhe targeton DHMI tek të rinjtë dhe të rejat në Shqipëri.

Qëllimi i këtij studimi është portretizimi në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse i çështjeve të dhunës në marrëdhëniet intime mes të rinjve/të rejave në Shqipëri, nga këndvështrimi gjinor dhe në kuadër të dhunës me bazë gjinore në përgjithësi. Përmes një qasje mikse të metodave të kërkimit (siç shpjegohet në Kapitullin III),

studimi synon t'u japë përgjigje pyetjeve:

- 1.** Cila është incidenca e dhunës në marrëdhënie intime mes të rinjve në Shqipëri dhe cilat janë karakteristikat e saj?
- 2.** Si mund të lexohet situata e dhunës në marrëdhëniet e të rinjve në Shqipëri nga këndvështrimi gjinor?
- 3.** Cilët janë faktorët e riskut dhe reziliencës ndaj dhunës në marrëdhëniet intime për djemtë dhe vajzat?

Gjetjet e studimit paraqiten të organizuara sipas tematikave dhe çështjeve kryesore të shqyrtuara në Kapitullin IV dhe pasohen nga përfundimet e paraqitura në kapitullin përmbyllës të këtij raporti studimor.

2. Shqyrtimi i literaturës

Dhuna ndaj vajzave dhe grave është forma më e shpeshtë e dhunës me bazë gjinore. I referohet çdo veprimi të dhunshëm që rezulton (ose ka gjasë që të rezultojë) në dëmtim fizik, seksual ose mendor ose në vuajtjen e vajzave dhe grave duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimi apo deprivimi i lirisë, edhe nëse ndodh në jetën private apo publike (OBSH, 2013). Ajo përmban lloje dhe forma të ndryshme të dhunës, duke përfshirë këtu dhunën nga një partner intim, përdhunimin, sulmin seksual si dhe forma të tjera të dhunës seksuale ku abuzuesi është dikush tjetër e jo partneri, dhunën seksuale ndaj fëmijëve, prostitucionin e detyruar, trafikimin e vajzave dhe grave dhe praktika të tjera tradicionale të dëmshme, si martesat e hershme, mutilimin gjenital dhe vrasjet e nderit (Garcia-Moreno e të tjerë, 2015).

Dhuna me bazë gjinore ndaj grave është një shkelle e të drejtave të njeriut dhe është e përhapur në mbarë botën, përfshirë Shqipërinë. Vlerësohet se 35% e grave në të gjithë botën gjatë jetës së tyre kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim, apo dhunë seksuale nga një jopartner (OBSH, 2013). Por, shumica e këtyre përvojave vinin nga partnerët në marrëdhëniet intime. Gjithashtu, 38% e vrasjeve të grave në të gjithë botën janë kryer nga partnerët intimë. Në SHBA rreth 1 në 4 gra dhe thuajse 1 në 10 burra kanë përjetuar dhunë seksuale me kontakt, dhunë fizike dhe/ose përndjekje nga një partner intim përgjatë jetës së tyre dhe kanë raportuar një nga pasojat e dhunës në marrëdhënie intime (Smith e të tjerë, 2018).

2.1. Përkufizime dhe fakte

Organizata Botërore e Shëndetit e përkufizon dhunën në marrëdhënie intime si *“një sjellje e kryer nga një partner intim që shkakton dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, duke përfshirë akte të agresionit fizik, të detyrimit për marrëdhënie seksuale, të abuzimit psikologjik dhe të sjelljes kontrolluese”*.

Dhuna në marrëdhëniet intime mund të variojë në shpeshtësinë dhe seriozitetin me të cilin ndodh. Mund të variojë nga një episod i vetëm i dhunës që mund të ketë një impakt afatgjatë në episode të shpeshta dhe kronike përgjatë shumë viteve, me pasoja shumë serioze. Ajo mund të shfaqet në një nga format e mëposhtme:

- **Dhunë fizike:** kur një person dëmton ose përpiqet të dëmtojë partnerin/en duke e gjuajtur, duke e shtyrë me shkelm ose duke përdorur një formë tjetër të forcës fizike.
- **Dhunë seksuale** është detyrimi ose përpjekja për të detyruar partnerin/en për të marrë pjesë në një akt seksual, në prekje seksuale ose në një aktivitet seksual jo – fizik (sexting) për të cilin partneri/ja nuk ka dhënë miratimin e tij/saj.
- **Përndjekja** është një model i përsëritur, vëmendjes dhe kontaktit të padëshiruar nga një partner/e që shkakton frikë ose shqetësim për sigurinë personale ose për sigurinë e dikujt tjetër afër viktimës.
- **Dhunë psikologjike** është përdorimi i komunikimit verbal dhe jo – verbal me qëllim dëmtimin ndaj një personi tjetër emocionalisht ose mendërisht dhe

ushtrimin e kontrollit ndaj tij/saj (CDC, 2015).

- **“Partneri intim”** nënkupton bashkëshortin/partnerin aktual dhe të mëparshëm.

Sipas ligjit 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 dhunë do të thotë: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”. Në të njëjtin ligj gjenden përkufizimet e marrëdhënies intime, si “marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional” dhe dhunës nga partneri intim që është “Çdo sjellje në një marrëdhënie intime që shkakton lëndim fizik, psikologjik ose seksual të personave në një marrëdhënie, përfshirë veprime të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjelljes së kontrolluar”.

Në shtator të vitit 2015, 193 shtetet anëtarë të OKB – së kanë adoptuar Agjendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm, të përbërë nga 17 Objektiva për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), 169 targete dhe 232 indikatorë. Agjenda 2030 prek një sërë sfidash globale, si eliminimi i varfërisë, reduktimi i pabarazive me bazë komplekse, adresimi i ndryshimit klimaterik, fundi i konflikteve etj. Një çështje e rëndësishme në këtë Agjendë është barazia gjinore. OZHQ 5 synon arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e vajzave dhe grave, dhe përfshin targete të qarta për barazinë gjinore, si dhe për dhunën ndaj vajzave dhe grave (Beyene, 2019).

Dy targetet më të rëndësishme në këtë drejtim janë:

- Eliminimi i diskriminimit kundër të gjitha vajzave dhe grave kudo.
- Eliminimi i të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha vajzave dhe grave në sferën publike dhe private, duke përfshirë trafikimin dhe forma të tjera të shfrytëzimit.

Shqipëria ka ratifikuar një sërë dokumentesh ndërkombëtarë të lidhur me dhunën ndaj vajzave dhe grave në përgjithësi, duke përfshirë këtu por jo vetëm, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), të cilat janë instrumentet kryesore për të siguruar detyrime të qarta për Shqipërinë për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës ndaj grave (IDRA dhe UNWOMEN, 2018). Me nënshkrimin e deklaratës COMMIT, Qeveria Shqiptare u angazhua të intensifikojë përpjekjet e saj për pakësimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje, duke siguruar zbatimin e Konventës së Stambollit, legjislacionin kombëtar, strategjitë dhe planet e veprimit mbi dhunën në familje. Përveç kuadrit ligjor të mësipërm, Qeveria Shqiptare ka përgatitur edhe strategji dhe politika të ndryshme, përfshirë Strategjinë Kombëtare më të fundit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe Planin e saj të Veprimit të miratuar në vitin 2016, të cilat përfshijnë objektivin specifik të reduktimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe veprimet specifike. Në janar 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën nr. 1 datë 04.12.2017 “Për Ndëshkimin e Dhunës Kundër Grave dhe Vajzave dhe Rritjen e Efektshmërisë së Mekanizmave Ligjorë për Parandalimin e saj”, e cila përkrah gjetjeve krijon një nën-komision të përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave” pranë Komisionit përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetin. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili tërheq vëmendjen dhe rrit rolin mbikëqyrës të parlamentit shqiptar, jo vetëm për masat për të adresuar dhunën në familje, por të gjitha format e dhunës ndaj grave, në përputhje me Konventën e Stambollit.

Në veçanti, raporti bazë i vlerësimit për Shqipërinë, i publikuar në nëntor 2017

nga GREVIO (Grupi i Ekspertëve të Pavarur mbi Veprimin kundër Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje), i cili është një organ i pavarur i monitorimit të të drejtave të njeriut i autorizuar për të monitoruar zbatimin e Konventës së Stambollit, thekson se reagimi ligjor dhe institucional në Shqipëri përqendrohet kryesisht tek dhuna në familje. Format e tjera të dhunës, ndonëse të parashikuara si vepra penale, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur në lidhje me parandalimin dhe masat e mbrojtjes civile. GREVIO inkurajon autoritetet shqiptare që dhuna në familje ndaj grave dhe natyrën e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, ta bëjnë më të dukshme në statistikat e krimit që paraqiten për publikun, të kryejnë anketime që matin shtrirjen e formave të dhunës ndaj grave që nuk janë vlerësuar më parë, sidomos ngacmimet seksuale, dhunën seksuale dhe martesën e detyruar, të zhvillojnë kategori të të dhënave për llojin e marrëdhënieve ndërmjet dhunuesit dhe viktimës për të gjitha format e dhunës ndaj grave, që do të lejonin që natyra e marrëdhënieve të tyre të dokumentoheshin më saktë (GREVIO, 2017).

Në Shqipëri janë realizuar studime të ndryshme me fokus dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, ku përfshiheshin elementë të dhunës në marrëdhëniet intime (Home Office, 2016). Një studim i fundit i kryer nga organizata AWEN për dhunën në marrëdhënie intime ndërmjet adoleshentëve të moshës 16 – 19 vjeç tregoi se 22% prej tyre kanë patur të paktën një eksperiencë të tillë. Dhuna u raportua më shumë nga vajzat (28%) sesa nga djemtë (20%). Në një studim tjetër nga IDRA dhe UNWOMEN (2018) rezultoi se pothuajse gjysma e të anketuarave (44%), kanë patur një mike ose një pjesëtare të familjes e cila është ngacmuar ose dhunuar seksualisht. Gjetjet e përgjithshme treguan një situatë po aq alarmante, ku 38 për qind e 750 të anketuarave kanë raportuar të jenë rrezikuar nga ose ekspozuar ndaj ngacmimeve dhe dhunës seksuale para ose

pas moshës 15-vjeçare (disa i kanë përjetuar të dyja).

Kërkimet e viteve të fundit konfirmojnë se dhuna në marrëdhëniet intime në të gjitha moshat, por veçanërisht tek të rinjtë përbën një problem social që duhet të luftohet (Foshee e të tjerë, 2007, Barter e të tjerë, 2017). Një numër i lartë i të rejave dhe të rinjve dhunohen brenda marrëdhënies së tyre romantike. Studimet kanë treguar se pasojat e një dhunë të tillë mund të jetë serioze (Romito, Beltrami dhe Escrivà-Agüir, 2013). Marrëdhëniet e pashëndetshme në fakt mund të fillojnë që herët në jetë sepse adoleshentët/et dhe të rinjtë/rejat nuk perceptojnë gjithmonë saktë disa sjellje si të dhunshme. Megjithatë, këto sjellje mund të bëhen abuzive dhe të evoluojnë në forma më serioze të dhunës. Për më tepër fenomene si dhuna seksuale, përndjekja dhe dhuna në marrëdhëniet intime janë probleme serioze që kanë një impakt serioz dhe afatgjatë tek shëndeti fizik dhe mendor i viktimave.

2.2. Faktorët e riskut

Faktorët që lidhen me dhunën në marrëdhëniet intime dhe dhunën seksuale janë të një niveli individual, familjar, komunitar dhe të shoqërisë së gjerë. Disa lidhen me të qenit abuzues, disa me të qenit i/e abuzuar dhe disa faktorë të tjerë me të dyja.

Burrat që ka më shumë shanse që të përdorin dhunën janë kryesisht me arsim më të ulët, mund të kenë një historik të keqtrajtimit si fëmijë, të jenë ekspozuar më shumë në dhunën në familje nga baballarët e tyre ndaj nënave, mund të jenë përdorues të alkoolit dhe/ose substancave narkotike. Gjithashtu, shpesh ata besojnë në norma të pabarazisë gjinore që janë pranuese ndaj dhunës dhe kanë një sens “pronësie” ndaj grave. Vajzat dhe gratë që kanë më shumë gjasa që të bëhen viktima të dhunës nga partneri intim shpesh kanë një arsim

më të ulët, janë ekspozuar në dhunën e ushtruar nga babai/partneri ndaj nënës së tyre, janë dhunuar vetë në fëmijëri dhe kanë qëndrime pranuese ndaj dhunës. Ato besojnë se burrat kanë më shumë privilegje në shoqëri dhe në familje dhe se roli i gruas është që të jetë e nënshtruar (OBSH, 2017). Këto gjetje mbështeten dhe nga studimi i mëparshëm i AWEN (2019), sipas të cilit të rinjtë që kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare ishin tre herë më shumë të predispozuar të jenë dhe viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime. Gjithashtu, të rinjtë/rejat që kanë në rrethin e tyre të dhunuar ose dhunues ishin pothuaj dy herë më të predispozuar për të qenë viktimë të dhunës krahasuar me ata që nuk kishin viktimë ose dhunues në rrethin e tyre. (AWEN, 2019)

Disa faktorë të tjerë që mund të shkaktojnë dhunën me në marrëdhëniet intime janë: mosmarrëveshjet në martesë/ marrëdhënie dhe pakënaqësi, vështirësi për të komunikuar mes partnerëve dhe sjelljet e kontrollit të burrave ndaj grave. Në veçanti, faktorët që janë lidhur me dhunën seksuale përfshijnë krahas të tjerëve: besime për nderin e familjes dhe për pastërtinë seksuale, qëndrime “pronësie” ndaj grave dhe sanksionet e dobëta ndaj dhunës seksuale (OBSH, 2017). Në veçanti tek të rinjtë/të rejat në Shqipëri faktorë të tjerë risku janë toleranca ndaj sjelljeve të dhunshme, abuzimi me substanca narkotike dhe të qenit nga zonat rurale. Në studimin e AWEN (2019) rezultoi se ka një lidhje të fortë mes tolerancës ndaj sjelljeve të dhunshme dhe përjetimit të dhunës në marrëdhëniet intime (dy herë më shumë rrezik). Gjithashtu, të rinjtë në zonat rurale janë më të prekur nga dhuna në marrëdhëniet familjare krahasuar me ata/o të zonave urbane, diçka që e rrit dhe probabilitetin për të përjetuar dhunë në marrëdhënien intime.

Stereotipat e ngurta ndaj feminitetit dhe maskulinitetit dhe rolet gjinore stereotipike janë ndër shkaqet kryesore për dhunën me

bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave. Për të eliminuar dhunën ndaj vajzave dhe grave, është e rëndësishme të transformohen normat gjinore dhe stereotipat dhe të promovohen marrëdhënie jo të dhunshme, me respekt reciprok dhe të barabarta mes burrave, grave dhe personave me orientim tjetër seksual. Një transformim i tillë mund të bëhet nëpërmjet masave si edukimi i përgjegjshëm gjinor që në fëmijërinë e hershme, integrimi i barazisë gjinore në të gjitha kurrikulat arsimore dhe edukimi për seksualitetin i përshtatshëm për moshën. Gjithashtu, promovimi i ndarjes së barabartë të përgjegjësisë në punën e papaguar, duke përfshirë politikën e lejes prindërore dhe rritja e fleksibilitetit në mjedisin e punës si dhe reduktimi i stereotipave për shëndetin seksual dhe riprodhues (OHCHR, 2018).

Katër tipa faktorësh:

a. Faktorët kulturorë

Qëndrimet patriarkale dhe seksiste, të përmendura dhe më sipër, që legjitimojnë dhunën për të siguruar dominancën dhe superioritetin e burrave ndikojnë në dhunën me bazë gjinore. Faktorë të tjerë kulturorë janë stereotipat gjinore dhe paragjykimet, pritshmëritë për feminitetin dhe maskulinitetin, socializimi gjinor, i kuptuari i sferës së familjes si private nën autoritetin e burrave, pranimi i përgjithshëm i dhunës në jetën publike (p.sh. ngacmimi i vajzave dhe grave në mjedise publike) dhe/ se pranimi i metodave të dhunshme për zgjidhjet e konflikteve.

Traditat fetare dhe historike kanë legjitimuar pronësinë e burrave ndaj grave. Seksualiteti është lidhur me “nderin e familjes” në shumë shoqëri. Normat shoqërore në këto kultura lejojnë që gratë të vriten për shkak të kryerjes së marrëdhënieve seksuale të palejuara. Janë të njëjtat norma që tolerojnë ose nxisin dhunën seksuale ndaj grave.

Në një studim të kryer nga INSTAT (2019) shpjegohet se dhuna në familjet shqiptare i ka rrënjët e thella në “identitete dhe role gjinore strikte, në autoritetin patriarkal, mbështetjen e sistemit të nderit dhe turpit dhe zakoneve të hierarkisë në familje me kontroll ndërbrezor”. Studimi shton se shqiptarët “konsiderojnë se dhuna në familje është një çështje private që shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet hapur, as nuk adresohet, prandaj viktimat vuajnë në heshtje”. Në të njëjtën linjë, në studimin e AWEN (2019) rezultoi se të rinjtë/të rejat besonin se shkaqet e dhunës ishin sjelljet dhe qëndrimet diskriminuese, qëndrimet seksise dhe problemet psikologjike.

b. Faktorët ligjorë

Të qenit viktimë e dhunës me bazë gjinore perceptohet si diçka e turpshme ose si një dobësi në shumë shoqëri. Shumë vajza dhe gra etiketohen si “fajtores” sepse thuhet se ato joshin djemtë dhe burrat me sjelljet e tyre. Këto qëndrime dhe perceptime shpjegojnë dhe numrat e ulëta të raportimit dhe investigimit të mëtejshëm të dhunës me bazë gjinore.

Deri para disa vitesh, legjislacioni në vende të ndryshme bënte dallime mes hapësirave publike dhe private të dhunimit, diçka që i bënte vajzat dhe gratë më vulnerable ndaj dhunës në familje.

Konventa e Stambollit siguron të drejtën e të gjithëve, veçanërisht grave, për të jetuar të lirë nga dhuna në sferën publike dhe private. Shumica e formave të dhunës me bazë gjinore konsiderohen vepra penale në vendet europiane dhe më tej. Megjithatë, nga praktika e zbatimit të ligjeve është vënë re një tendencë për të favorizuar abuzuesit, diçka që shton në shkallën e ulët të besimit të publikut ndaj autoriteteve dhe tek fakti se shumë nga këto krime mbeten të pa raportuara.

c. Faktorë ekonomikë

Mungesa e burimeve ekonomike në përgjithësi i bën gratë, por edhe grupet LGBT+ vulnerable ndaj dhunës. Krijon modele të dhunës dhe varfërisë që përjetësohen duke e bërë shumë të vështirë për viktimat që të nxjerrin veten nga kjo situatë. Kur papunësia dhe varfëria prekin burrat mund t'i bëjë ata që të shprehin agresionin nëpërmjet dhunës.

d. Faktorë politikë

Nën – përfaqësimi i grave dhe i personave LGBT+ në vendimmarrje dhe në politikëbërje nënkupton se kanë më pak mundësi për të formësuar agjendat dhe diskutimet që të sjellin ndryshim për të luftuar dhunën me bazë gjinore. Çështja e dhunës me bazë gjinore dhe e dhunës në familje nuk gjen mbështetjen e duhur, e as burimet e duhura (Këshilli i Evropës, n.d.). Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria ka zhvilluar një paketë politikash solide dhe të përditësuar në lidhje me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore, por ende ka mungesë serioze buxhetimi për zbatimin e tyre, sidomos në nivel vendor (AWEN, 2016).

2.2.1. Konsumimi i alkoolit dhe substancave narkotike

Përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike është lidhur me ushtrimin më të madh të dhunës në familje, në marrëdhëniet intime dhe dhunës ndaj vajzave dhe grave (p.sh. shih Leonard, 2008). Kërkimet ndër – seksionale tregojnë se burrat alkoolistë kanë nivele më të larta të dhunës në marrëdhëniet intime se sa ata jo – alkoolistë (Chermack, Fuller dhe Blow, 2000) dhe konsumimi i madh i alkoolit në fillimet e një martese është një parashikues i fortë për DhMI. Megjithatë, në studime të tjera ka rezultuar se burrat që ka më shumë gjasë që të bëhen dhunues janë ata që kanë predispozita të mëparshme ndaj dhunës,

si p.sh. nivele më të larta të zemërimit (Eckhardt, Parrott dhe Sprunger, 2015). Në lidhje me përdorimin e substancave, lidhja e saj me DhMI është shumë e lartë, sidomos kur janë të dy partnerët përdorues të rregullt (Chase e të tjerë, 2003).

Në një studim që analizoi shtatzënitë e padëshiruara mes grave që kanë lindur, rezultoi se abuzimi fizik gjatë shtatzënisë kishte lidhje të fortë me pasjen e një shtatzënie të paplanifikuar dhe të padëshiruar (D'Angelo, Gilbert, Rochat, Santelli, dhe Herold, 2004). Gratë që kërkonin të abortonin kishin nivele më të larta të raportimit të DhMI krahasuar me popullatën e gjerë (Woo, Fine dhe Goetzl, 2005; Williams, Larsen, McCloskey, 2008). Këto gjetje mbështeten dhe nga studimi i mëparshëm i AWEN (2019) ku të rinjtë / të rejtat që ishin përdorues të substancave narkotike kishin më shumë probabilitet që të përjetonin dhunë në marrëdhëniet intime.

2.3. Dhuna ndaj djemve dhe burrave

Edhe pse dhuna me bazë gjinore prek kryesisht vajzat dhe gratë në mënyrë disproporcionale nuk mund të anashkalohej dhuna e ushtruar ndaj djemve dhe burrave, sidomos brenda marrëdhënieve intime. Në një studim që ka eksploruar kërkimin e ndihmës nga burrat e dhunuar dhe barrierat në këtë proces rezultoi se këto përvoja kishin patur impakt në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, në zhvillimin e marrëdhënieve të ardhshme dhe në marrëdhëniet e tyre me fëmijët e tyre. Pjesëmarrësit e studimit raportuan se për shkak të qëndrimeve të shoqërisë për dhunën ndaj burrave shpesh të tjerët nuk besonin se çfarë i kishte ndodhur dhe se i perceptonin si “të dobët” ose si “abuzuesit”. Këto qëndrime i kanë frenuar nga kërkimi i ndihmës dhe nga ndërprerja e marrëdhënies (Bates, 2020)

2.4. Dhuna në marrëdhënie intime tek të rinjtë

Dhuna në marrëdhëniet intime mes adoleshentëve dhe të rinjve ndryshon nga ajo mes të rriturve në një sërë mënyrash. DhMI shfaqet më shpesh para moshës 25 – vjeçare, kështu që është më e shpeshtë në këto mosha. Shumica e viktimave të DhMI përjetojnë dhunë për herë të parë para se të bëhen 25 vjeç (Faulkner, Goldstein dhe Wekerle, 2014). Gjithashtu, DhMI mes adoleshentëve mund të jetë më reciproke në natyrë, çka do të thotë se të dyja gjinitë mund të jenë abuzues dhe të abuzuar (Whitaker e të tjerë, 2007). Në adoleshencë dhe në rininë e hershme marrëdhëniet nuk kanë norma të mirëpërcaktuara, nuk janë të konsoliduara, shprehitë e ndërtimit dhe vazhdimet të marrëdhënieve nuk janë të zhvilluara, sikurse nuk kanë të njëjtat dinamika të pushtetit si tek të rriturit. Prandaj, shpesh DhMI në këto mosha mund të mos shihet si problem (Faulkner, Goldstein dhe Wekerle, 2014; Katz, Courtney dhe Sapiro, 2017).

Një sërë studimesh kanë gjetur se mosha e re ka një lidhje të fortë me të qenit viktimë e DhMI. (Abramsky e të tjerë, 2011; AWEN, 2019). Gjetjet për vajzat e reja tregojnë se shifrat mund të arrijnë deri në 66% në disa vende. Për shembull, Stöckl e të tjerë (2014), në analizën e tyre të DhMI mes adoleshenteve dhe vajzave të reja të moshave 15 deri 24 vjeç në nëntë vende, gjetën se ka një prevalencë të DhMI që varionte nga 19% deri në 66%. Decker e të tjerë (2014), në një studim të adoleshentëve që jetonin në komunitete urbane në pesë qytete të mëdha gjetën se mes vajzave që kanë pasur të paktën një partner, DhMI varionte nga 10.2% deri në 36%. Vajzat e reja që ishin ekspozuar në DhMI kishte gjasë që ta përjetonin dhe në marrëdhëniet e tyre të ardhshme; megjithatë, një sfida më shumë për ato është fakti se përjetimi i DhMI në këtë moshë zhvillimore është një faktor risku për të qenë e dhunuar në marrëdhëniet e tyre të ardhshme (Bruce,

2011). Exner-Cortens e të tjerë (2013), në një studim të “marrëdhënive longitudinale mes përjetimit të dhunës në adoleshencë dhe pasojave në shëndet” gjeti se vajzat adoleshente që kishin përjetuar dhunë në marrëdhënien intime në moshën e adoleshencës kishin një sërë pasojash shëndetësore në të ardhmen, si abuzimi me substancat, mendime vetëvrasëse dhe risk më të lartë për të përjetuar DhMI në vazhdim. Këto studime vënë në dukje pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të DhMI tek adoleshentet dhe vajzat e reja. Një grup me rrezik akoma më të lartë këtu janë vajzat e reja që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta ekonomike. (United Nations Children’s Fund, 2012; Onanubi, Olumide dhe Owoaje, 2017).

2.4.1. Faktorët e riskut dhe faktorët mbrojtës për DhMI në adoleshencë dhe në rini

Kërkuesit janë përpjekur që të gjejnë faktorët që ndikojnë tek adoleshentët dhe të rinjtë për t’u bërë abuzues ose viktimë e DhMI. Faktorët e riskut lidhen me një sërë variabëlash demografikë, si dhe në rastin e DhMI tek të rriturit (raca, gjinia etj.), individualë (shëndeti mendor, abuzimi me substancat etj.), dhe familjarë (dhuna si fëmijë, DhMI mes prindërve etj.). Përdorimi i DhMI për vajzat dhe për djemtë ndodh për arsye të ndryshme brenda marrëdhënies (Johnson, Giordano, Longmore dhe Manning, 2014). Si djemtë dhe vajzat identifikojnë zemërimin si arsyen kryesore për sjellje të dhunshme, por vajzat përdorin dhunë më shumë për t’u mbrojtur apo në përgjigje ndaj një lëndimi emocional ndërsa djemtë e përdorin si një mjet për të kontrolluar partneret e tyre, apo në përgjigje të ndjenjave të xhelozisë. (Hickman e të tjerë, 2004). Gjithashtu, dhuna e të rinjve ndaj të rejave ka më shumë pasoja fizike dhe psikologjike, në raport me atë të rejave ndaj të rinjve (Capaldi, Kim dhe Shortt, 2004). Të rejtat janë në një risk më të lartë për dhunë seksuale gjatë një takimi me partnerin (dating) (Foshee e të tjerë, 2004). Përjetimi

i dhunës në familje, si nëpërmjet dhunimit të vetë fëmijës ose nëpërmjet të parit të saj mes prindërve është një faktor rreziku për përjetimin e DhMI në adoleshencë. Studimet kanë treguar disa herë se të rinjtë që kanë qenë viktimë të dhunës në familje si fëmijë ka më shumë gjasa që të reagojnë ndaj konfliktit të perceptuar, sidomos në marrëdhëniet e para në adoleshencë dhe në rini (shih për shembull, Fang & Corso, 2007). Fang dhe Corso (2007) gjetën se të rinjtë/rejtat të keqtrajtuar/a si fëmijë kishin shanse nga 9% deri në 17% më shumë për të qenë të abuzues ose viktimë në një marrëdhënie tjetër (Sabina, Cuevas dhe Cotignola-Pickens, 2016).

Simptomat depresive dhe një historik vetëvrasjeje rrisin mundësinë për të qenë viktimë e DhMI si tek vajzat ashtu dhe tek djemtë (Renner dhe Whitney, 2012). Adoleshentët që përjetojnë pakënaqësi nga jeta mund të kërkojnë sjellje të rrezikshme për të përballuar disstresin; ndjenja e trishtimit dhe e vetmisë mund t’i bëjnë adoleshentët/et dhe të rinjtë/rejtat që të tolerojnë dhunën në marrëdhëniet intime për shkak të frikës së braktisjes ose të refuzimit (Vézina dhe Hébert, 2007). Literatura për abuzimin nga substancat tregon se përdorimi i alkoolit është një faktor risku si për të qenë dhunues ashtu dhe për të qenit viktimë. Përdorimi i marihuanës dhe narkotikëve tek të rinjtë lidhet me të qenit abuzues dhe viktimë. Përdorimi i rregullt i substancave mund të reduktojë aftësinë e gjykimit dhe përdorimin e shprehive për zgjidhjen e konfliktit (Reyes, Foshee, Bauer dhe Ennett, 2014).

Studimi i mëparshëm i dhunës në marrëdhëniet intime, i realizuar nga Rrjeti AWEN tregoi se pothuajse trefishohet mundësia për të hyrë në ciklin e dhunës në marrëdhëniet intime në adoleshencë midis të rinjve e të rejave që kanë përjetuar dhunë në familje. Të dhënat në këtë studim treguan se 43 përqind e të rinjve/rejave që kanë qenë viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë edhe

viktimë e dhunës në marrëdhëniet intime, përkundrejt 16 përqind e atyre që nuk kanë përjetuar dhunë në familje. Gjithashtu, adoleshentët/et që kanë në rrethin e tyre të dhunuar/a ose dhunues/e janë pothuaj dy herë më të predispozuar (24 përqind) për të qenë viktima të dhunës se ata që nuk kanë në rrethin e tyre viktima ose dhunues/e (13 përqind) (AWEN, 2018).

Studimet që lidhen me faktorët mbrojtës ndaj DhMI tek të rinjtë/rejat janë shumë të pakta në numër. Richards, Branch dhe Ray (2014) gjetën se mbështetja sociale nga miqtë, por jo nga prindërit, parashikonte një risk të reduktuar për të qenë dhunues/viktima në marrëdhëniet intime. Megjithatë, Staggs e të tjerë (2007) treguan se mbështetja sociale nuk mund të parandalojë ekspozimin në DhMI në të ardhme. Studime të tjera kanë treguar se afërsia me prindërit dhe monitorimi i prindërve mbrojnë nga ekspozimi në DhMI (Yan e të tjerë, 2010).

2.5. Dhuna seksuale në marrëdhëniet intime tek të rinjtë

Dhuna seksuale në marrëdhëniet intime tek të rinjtë nuk është eksploruar aq shumë, sidomos në kontekstin shqiptar. Një meta – analizë në vende të tjera tregoi se 1 në 10 adoleshentë të moshave 13 deri në 18 vjeç kanë raportuar dhunë seksuale, ku vajzat kishin përqindje më të larta se djemtë (Wincentak, Connolly dhe Card, 2017). Këto shifra janë shqetësuese duke marrë parasysh se viktimat e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime raportojnë disstres më të madh psikologjik, çrregullim të stresit post – traumatik, simptoma të depresionit dhe mendime vetëvrasëse. Vlerësimi i konsentit seksual është një çështje komplekse, veçanërisht në një marrëdhënie intime (Muehlenhard, Humphreys, Jozkoëski dhe Peterson, 2016). Disa akte të dhunës seksuale mund të jenë të fshehta ose të ambigje, sa që të mos kuptohet qartë nëse është dhunë seksuale apo jo. Përkufizimet

e dhunës seksuale ose sjelljeve detyruese mund të ndryshojnë shumë edhe në studimin e fenomenit. Wilson dhe Miller (2016) gjetën se 60% e vajzave të reja viktima të dhunës seksuale (jo medoemos nga një partner intim) nuk e quanin përvojën e tyre përdhunim, nuk mendonin se ishin viktima të dhunës seksuale dhe përdornin më shumë emërtime si “seks i keq” ose “keqkomunikim” për të përshkruar përvojat e tyre. Prevalenca e përdhunimit të “paidentifikuar” është më e lartë tek vajzat e reja (Wilson dhe Miller, 2016). Një studim tjetër gjeti se sa më i njohur dhe sa më afër me viktimën të ishte abuzuesi aq më e vogël mundësia për ta quajtur dhunë seksuale (Orchoëski, Untied dhe Gidycz, 2013).

Faktorë të shumtë mund të shpjegojnë pse vajzat e reja nuk i quajnë këto eksperiencë si dhunë seksuale: taktikat që përdoren nga abuzuesit, shkalla e intruzionit të aktit, aktiviteti i mëparshëm seksual me abuzuesin, përdorimi i substancave nga abuzuesi dhe nga viktima, besime stereotipizuese për përdhunimin, shkalla e rezistencës së viktimës, pasiguri për qëllimet e abuzuesit, dëshira për të mos e quajtur abuzuesin “të keq” ose për të pranuar se një njeri i dashur mund të të lëndojë (Dardis, Kraft dhe Gidycz, 2017; Peterson dhe Muehlenhard, 2011). Këto paqartësi janë më të forta tek të rinjtë për shkak të mungesës së eksperiencës në marrëdhëniet intime, dëshirës për të mbajtur marrëdhënien “ideale” dhe normale kulturore që tolerojnë dhe normalizojnë disa sjellje seksuale, si një pjesë e pashmangshme e seksualitetit në rini (Weiss, 2013). Weiss (2013) zbuloi se adoleshentët raportojnë më shumë paqartësi dhe ambiguitet për dhunën seksuale kur ajo ka ndodhur nga një partner intim/shok. Një arsye për këtë mund të lidhet me faktin se të rinjtë kanë vështirësi për të kuptuar dhe dalluar format e ndryshme të dhunës seksuale në një marrëdhënie intime (Toscano, 2007). Mosnjohja e mjaftueshme e dhunës seksuale me format e ndryshme të saj nga

të rinjtë mund të çojë në hezitime për ta raportuar dhe në ndjenja të izolimit (Fernet, Hébert, Couture dhe Brodeur, 2019).

2.6. Dhuna seksuale e lehtësuar nga teknologjia

Përdorimi në rritje i Teknologjive të Informacionit dhe Telekomunikacionit gjatë dekadës së fundit ka çuar në shfaqjen dhe përhapjen e një forme të re të dhunës me bazë gjinore. Për shkak të përdorimit të madh të TIK – ut vajzat dhe gratë janë më vulnerable se sa kurrë ndaj abuzimit dhe dhunës. Gratë përballen me forma të shumta të dhunës së lidhur me teknologjinë, duke përfshirë shpërndarjen e imazheve intime jo – konsensuale, shantazhi, bullizmi, përndjekja dhe ngacmimi seksual (Aceng, 2017). Disa nga format e dhunës në marrëdhëniet intime, si p.sh. aspekte të dhunës seksuale, dhuna psikologjike, taktikat detyruese dhe përndjekja, mund të marrin forma të tjera përmes përdorimit të celularëve ose site – ve të medieve sociale (CDC, 2017).

Rrjedhimisht, dhuna seksuale e lehtësuar nga teknologjia (DhSLT) (e njohur ndryshe si “pornografia hakmarrëse”, abuzimi seksual i bazuar në imazhe, pornografi jokonsensuale ose shpërndarja elektronike e imazheve/ videove seksuale të të tjerëve) është bërë më e shpeshtë; pasja e telefonave celularë dhe aksesit i lehtë në internet e kanë bërë më të lehtë për individët që të jenë ose abuzues ose viktima të DhSLT. Të dhënat nga një studim tregojnë se 1 në 10 individë angazhohen në një sjellje të tillë (abuzues) (Powell e të tjerë, 2019), prandaj është e nevojshme që të kuptohet më mirë fenomeni për të ofruar trajtim të posaçëm ndaj viktimave dhe abuzuesve. Pasojat negative të DhSLT janë probleme të shëndetit mendor, si depresioni, ankthi dhe vetëvlerësimi i ulët, ndërmjet shumë pasojave të tjera (Kamal dhe Newman, 2016). Në disa raste viktimat mund të kenë pasoja sociale dhe profesionale, si humbja

e punës, tërheqja nga shkolla dhe sfidat për të qëndruar anonim në komunitetin e tyre kur jeta private është bërë “virale” (Citron dhe Franks, 2014). Probleme të ngjashme janë evidentuar dhe në studime që lidhen me pasojat psikologjike të formave të tjera të dhunës seksuale, përfshirë këtu ngacmimin seksual (Nielsen e të tjerë, 2010), sulmin seksual (Nickerson e të tjerë, 2013), dhe përdhunimin (Campbell e të tjerë, 2009).

Kërkuesit në këtë fushë nuk kanë arritur në një konsensus në lidhje me përkufizimin e DhSLT, edhe pse studimet empirike në këtë fushë janë të shumta. Shumë prej tyre fokusohen në shpërndarjen e formave të ndryshme të materialeve eksplicite seksuale (Henry dhe Flynn, 2019). Autorë të tjerë janë të interesuar dhe për rastet kur këto imazhe krijohen nga vetë abuzuesit dhe shpërndahen më tej (Powell dhe Henry, 2019).

Abuzimi seksual i bazuar në imazhe (ASBI) dhe DhSLT janë termat më të përdorur pasi mbulojnë një spektër të gjerë të sjelljeve dhe theksojnë se natyra e tyre është njësoj si ato të krimeve të seksit (Henry dhe Powell, 2018). Tradicionalisht, ASBI është lidhur me mediat vizive, si imazhe dhe video ndërsa DhSLT ka zgjeruar kriteret duke përfshirë sjellje si ngacmimi seksual digjital, i cili përfshin sjellje të çdo forme dhe niveli që janë ngacmuese dhe të një natyre seksuale dhe ndodhin online (Henry dhe Powell, 2018).

Në Shqipëri, në një studim të kryer në vitin 2014 nga World Vision in Albania tek adoleshentët e moshave 13 deri 18 vjeç, 44% prej tyre treguan se përdorin internetin për të parë materiale pornografike çdo ditë dhe 62% konfirmuan se kanë shokë që bëjnë të njëjtën gjë. 47% raportuan se janë kontaktuar nga një i huaj gjatë dy viteve të fundit, i cili në disa raste ka qenë dhe nga një shtet tjetër (World Vision, 2014). Në vitin 2019, UNICEF ka bërë një studim për sigurinë e fëmijëve online, ku moshat e përfshira ishin nga 9 deri në 17 vjeç. Përsa i përket

adoleshentëve, ata kanë patur të paktën një eksperiencë seksuale të padëshiruar online në 9% të rasteve (12 deri 14 vjeç) dhe 12% të rasteve (15 deri 17 vjeç) (UNICEF, 2019). Studime kombëtare që të fokusohen vetëm tek të rinjtë mungojnë në Shqipëri.

2.7. DhMI në kohën e pandemisë COVID – 19

Studimet tregojnë se vajzat dhe gratë do vuajnë më shumë pasojat e pandemisë në disa drejtime. Edhe pse në Shqipëri të dhënat zyrtare të raportuara nga policia e shtetit tregojnë se ka një rënie të numrit të raportimeve të rasteve të dhunës në familje krahasuar me një vit më përpara, telefonatat e organizatave që mbrojnë të drejtat e grave janë trefishuar. Kështu, shifrat e publikuara nga AWEN – Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri tregojnë se Linja Kombëtare për Gratë dhe Vajzat 116117 ka marrë rreth 2000 telefonata gjatë periudhës së izolimit 10 Mars – 18 Maj

2020, një shifër tre herë më e lartë se ajo e një viti të mëparshëm. Gjithashtu, rastet që janë bërë mediatike tregojnë se dhuna me bazë gjinore, një fenomen prezent në familjet dhe shoqërinë shqiptare, ka marrë tashmë përmasa më të mëdha, padyshim nga efekti i izolimit dhe pasojat e COVID – 19 në ekonominë e vendit dhe në shëndetin mendor në njerëzve.

Ulja e denoncimeve zyrtare në policinë e shtetit nuk tregon medoemos ulje të dhunës në familje. Përkundrazi, shkak mund të jetë frika më e madhe e grave për të denoncuar për shkak të rritjes së pasigurisë nga e ardhmja, në një periudhë të pasigurt për të gjithë. Një raport i UNWomen tregon se ishin burrat ata që humbën më shumë punën në raport me gratë gjatë kësaj kohe (17% burra dhe 12% gra nga pjesëmarrësit e studimit). Megjithatë, gratë janë shpesh të punësuar në sektorin informal të ekonomisë, diçka që nuk raportohet dhe nuk i jep mundësinë të kenë mbështetje të mëtejshme (si p.sh. “paga e luftës”).

3. Metodologjia

3.1. Qëllimi i studimit dhe pyetjet kërkimore

Ky studim merr shkas nga hendeku i identifikuar në literaturën dhe evidencat mbi dhunë në marrëdhëniet intime mes të rinjve në Shqipëri. Në kontekstin e analizës së literaturës së paraqitur më herët në këtë raport si dhe të hendekut të identifikuar, ky studim ka si qëllim kryesor portretizimin në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse të çështjeve të dhunës në marrëdhëniet intime, e veçanërisht atë seksuale, mes të rinjve në Shqipëri, nga këndvështrimi gjinor.

Procesi hulumtues për përmbushjen e këtij qëllimi u udhëhoq nga disa pyetje kërkimore:

1. Cila është incidenca e dhunës në marrëdhënie intime mes të rinjve në Shqipëri dhe cilat janë karakteristikat e saj?
2. Si mund të lexohet situata e dhunës në marrëdhëniet e të rinjve në Shqipëri nga këndvështrimi gjinor?
3. Cilët janë faktorët e riskut dhe reziliencës ndaj dhunës në marrëdhëniet intime për djemtë dhe vajzat?

3.2. Qasja metodologjike

Për realizimin e këtij studimi u përdor metodologjia Shpjeguese Sekuenciale “Quan-Qual” (Halcomb dhe Hickman, 2014) që nënkupton kombinimin e metodave sasiore dhe atyre cilësore në mënyrë sequenciale, në mbledhjen dhe analizën e të dhënave, me qëllim adresimin sa më të plotë të pyetjeve kërkimore. Metodatat mikse

(të përziera) të kërkimit janë ideale për të kuptuar më mirë lidhjet/të përbashkëtat ose kontradiktat midis të dhënave cilësore dhe sasiore; ato ofrojnë mundësi që pjesëmarrësit të kenë një zë të spikatur gjatë gjithë procesit të hulumtimit, si dhe ofrojnë mundësi shtesë në eksplorim që pasurojnë të dhënat dhe mundësojnë përgjigje më të thellë dhe më të plotë të pyetjeve kërkimore (Wisdom dhe Creswell, 2013). Në këtë studim metodologjia sasiore i parapriu asaj cilësore. Të dy këto komponente përbërës të qasjes kërkimore detajohen në vijim duke adresuar strategjinë për mbledhjen e të dhënave, instrumentet e përdorura për mbledhjen e tyre, strategjinë e analizës dhe interpretimit të të dhënave si dhe çështje të tjera të rëndësishme për planifikimin, zbatimin dhe raportimin profesional dhe etik të kërkimit shkencor.

3.2.1. Komponenti sasior

Metodat sasiore të kërkimit janë veçanërisht të përshtatshme në studimin e pyetjeve kërkimore që kërkojnë saktësi dhe precision në matje, besueshmëri dhe vlefshmëri të rezultateve, si dhe replikueshmërinë e procesit. Me këtë në mendje dhe qëllimin e studimit tonë, u vlerësua se sondazhi do ishte modeli kërkimor më i përshtatshëm për dhënien përgjigje pyetjeve kërkimore të sipër përmendura, ndërsa komponenti cilësor do mundësonte kuptueshmërinë më të thellë të gjetjeve.

Ndonëse sondazhet nuk janë modeli kërkimor më i mirë për të eksploruar marrëdhëniet shkak-pasojë, ato mbeten modeli më i përshtatshëm për të hartëzuar përhapjen e problematikave/fenomeneve

dhe për shqyrtimin e marrëdhënieve midis një sërë konceptesh (variabëlash) me interes. Për më tepër, sondazhet japin mundësinë për të mbuluar popullata të mëdha, në një shtrirje të madhe, me fleksibilitet dhe anonimat me kosto më të ulëta (Bryman, 2008).

Modeli Kërkimor Sasior

Modeli i përdorur për komponentin sasior

të këtij studimi është sondazhi trans-seksional, si modeli më i përshtatshëm për të mbledhur dhe analizuar të dhëna nga një popullatë interesi, në një kohë specifike. Për realizimin e këtij modeli, u hartua dhe administrua një pyetësor (intervistë e strukturuar) me të rinjtë dhe të rejtat 20-24 vjeç, në Republikën e Shqipërisë, (tetor-nëntor) 2020.

Procesi i planifikimit dhe zbatimit të sondazhit paraqitet në Figurën 3.1.1.

Figura 3.1.1. Planifikimi dhe zbatimi i sondazhit

1

PLANIFIKIMI

1. Mbledhje dhe reflektim mbi kërkesat specifike.
2. Finalizimi i objektivave specifik.
3. Finalizimi i qasjes kërkimore.

2

EKSPLORIMI

1. Eksplorimi i tematikave përmes rishikimit të literaturës.
2. Kuptueshmëria e problemeve, çështjeve, implikimeve.
3. Identifikimi i faktorëve/koncepteve/variablove kyç.

3

HARTIMI DHE ZBATIMI I SONDAZHIT

1. Zhvillimi i pyetjeve dhe hipotezave për testim
2. Zhvillimi i instrumentit për mbledhjen e të dhënave - pyetësori
3. Zhvillimi i strategjisë për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.
4. Zhvillimi i strategjisë për raportim.

Instrumenti për mbledhjen e të dhënave – pyetësi.

Instrumenti kryesor që u përdor për mbledhjen e të dhënave parësore sasiore është pyetësi. Ka një sërë studimesh që përdorin pyetësin si instrument për matjen e problematikave të dhunës në marrëdhënie intime (Russle e të tjerë, 2014; NISVS, 2012; WHO, 2005; Trucker-Harper, 2009). Nga rishikimi i qasjeve metodologjike dhe instrumenteve të studimeve në fushën e dhunës në marrëdhëniet intime, si dhe nga problematikat e njohura në raport me kontekstin lokal dhe zhvillimet specifike gjatë vitit 2020, pyetësi i përdorur në këtë studim përfshiu tematikat dhe seksionet si vijon:

Seksioni 1 – Të dhëna /pyetje të përgjithshme. Në këtë seksion u mbledhën të dhëna të përgjithshme demografike për përgjigjedhësit si dhe të dhëna socio-ekonomike mbi ta dhe kontekstin e tyre familjar/shoqëror.

Seksioni 2 – Stereotipat gjinorë dhe dhuna (dhuna me bazë gjinore). Në këtë seksion u eksploruar dhe u mbledhën të dhëna për qëndrimet e përgjigjedhësve në raport me stereotipat gjinorë si dhe u eksploruan eksperiencat dhe qëndrimet në raport me dhunën me bazë gjinore në planin individual, familjar dhe komunitar.

Seksioni 3 – Ngacmimi dhe dhuna seksuale. Në këtë seksion fokusi ishte tek eksplorimi i eksperiencave seksuale dhe ndërlidhjes me dhunën në marrëdhënie intime. Po kështu, u eksploruan qëndrimet mbi shkaqet e dhunës në marrëdhënie intime.

Seksioni 4 - Pornografia dhe pornoja hakmarrëse. Ky seksion shënjestroi problematikën relativisht të re, por gjithnjë e më shqetësuese, sidomos midis të rinjve, të përdorimit të pornografisë për hakmarrje. Për këtë, në këtë seksion u eksploruan qëndrimet dhe eksperiencat në raport me pornografinë në përgjithësi dhe pornon hakmarrëse në veçanti.

Seksioni 5 – Krizat shoqërore dhe dhuna.

Në kontekstin e një pandemie, në seksionin e fundit të pyetësit, u drejtuan pyetje mbi perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me impaktin e pandemisë në incidencën e dhunës në shoqëri.

Draft-pyetësi i konsultuar me grupin e gjerë të punës, u pilotua me qëllim validimin dhe kontekstualizimin e tij, me 37 pjesëmarrës. Ai u kthye në variant final pas analizimit të feedback-ut nga terreni, adresimit të çështjeve të identifikuara në pilotim (kryesisht në kuadër të thjeshtësimeve në plotësimin e pyetësit), si dhe analizës së të dhënave të pilotimit për të vlerësuar funksionimin e tij në kontekstin shqiptar. Instrumenti final u administrua me një kampion të përzgjedhur nga popullata e interesit siç paraqitet më tej në seksionin në vijim.

Popullata dhe kampioni i sondazhit

Popullata e këtij studimi janë të rinjtë dhe të rejtat, 20-24 vjeç, në Shqipëri gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave (viti 2020). Kjo grup-moshë e të rinjve është e pastudiuar në raport me çështjet e dhunës me bazë gjinore ashtu edhe atyre në marrëdhëniet intime dhe u synua si një vijimësi e studimit të AWEN (Arqimandriti et. al., 2019) për dhunën në marrëdhëniet intime tek adoleshentët në Shqipëri. Sipas të dhënave të INSTAT për fillimin e vitin 2020, popullsia e kësaj grup-moshe ishte 226.425, me një ndarje thuhet të barabartë midis gjinive (112.810M dhe 113.615F) (INSTAT, 2020 f.6). Kjo fashë e popullsisë së Republikës së Shqipërisë shërbeu edhe si kuadër për kampionin e këtij studimi. Me një nivel konfidence (besimi) në 95% dhe një shkallë gabimi prej 3%, masa e kampionit të nevojshëm për përgjithësim të gjetjeve ishte 1062 të rinj dhe të reja. Duke marrë në konsideratë edhe erozionin e mundshëm të kampionit, në terren pyetësi u administrua me 1128 pjesëmarrës.

Për përzgjedhjen e kampionit u aplikua strategjia e kampionimit rastësor të stratifikuar, si më i përshtatshmi për studimin e popullatave në të cilat ne jemi të interesuar për disa karakteristika të caktuara. Fillimisht, kampioni u nda në mënyrë proporcionale për madhësinë

e secilës zonë rezidence (në kontekstin tonë, çdo qark). Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke mbajtur në konsideratë se mëse 1/3 e popullsisë është e vendosur në kryeqytetin e vendit.

Tabela 3.1.1. Shpërndarja e kampionit sipas qarqeve

	%	Kampioni total	Numri i njësive për qark
Tirana	31.8	1,100	350
Durrësi	10.2	1,100	112
Fieri	10.2	1,100	112
Elbasani	9.5	1,100	105
Korça	7.2	1,100	79
Shkodra	7	1,100	77
Vlora	6.6	1,100	73
Lezha	4.3	1,100	47
Berati	4.3	1,100	47
Dibra	4.1	1,100	45
Kukësi	2.7	1,100	30
Gjirokastra	2.1	1,100	23

Për përzgjedhjen e përgjigjedhënësve në terren u aplikua strategjia e spirales, duke lëvizur nga qendrat e urbanizuara të njësive kryesore administrative, drejt atyre rurale.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave u përdorën mjete të ndryshme për garantimin e cilësisë së procesit. Intervistueseve në terren iu kërkua që të mbanin dhe dërgonin raporte ditore, raportimi në avancë i daljes në terren dhe identifikimi i lokacionit. Staf i administrativ i AWEN bëri kontroll të rastësishme dhe të vazhdueshme.

Analiza e të dhënave Data

Të dhënat e grumbulluara u përpunuar përmes paketës statistikore IBM SPSS, versioni 25. Statistikat deskriptive (frekuenca, përqindje, tabela e kryqëzuara etj.) u përdorën për të paraqitur gjetjet e observuara në bazën e të dhënave.

3.2.2. Komponenti cilësor

Në kontekstin e një studimi të parë mbi çështjet e DHMI tek të rinjtë e të rejtat 20-24, në Shqipëri, u vlerësua e dobishme

që për një kuptueshmëri më të thellë të çështjeve dhe problematikave të identifikuar, komponenti sasior i kërkimit të kombinohej me një komponent cilësor në modelin sekuencial “Quan-Qual”. Ndonëse metoda sasimore është jo vetëm pararendëse, por edhe dominuese në këtë studim, komponenti cilësor ka një vlerë të shtuar të pazëvendësueshme në krijimin e mundësive për një eksplorim dhe kuptueshmëri më të plotë dhe më të thellë të çështjeve nën shqyrtim, ashtu edhe për validimin e gjetjeve të identifikuar përmes komponentit sasior. E provuar që funksionon mirë edhe në kontekstin e studimit të tematikave të tilla si sjelljet seksuale dhe dhuna me bazë gjinore (shiko p.sh. Ruark dhe Fielding-Miller, 2016).

Për realizimin e mbledhjes së të dhënave cilësore u përdor instrumenti i diskutimeve në fokusgrupe (DFG). Në kuadër të validimit të gjetjeve të komponentit sasior, zbërthimit dhe kontekstualizimit të tyre, u organizuar katër DFG, diskutimi i të cilave u lehtësua sipas guidës (shiko për më shumë shtojcat e këtij studimi). Popullata e targetuar në komponentin cilësor përfshiu të rinjtë e të rejat 20-24 vjeç, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me të rinj dhe të reja dhe/ose me çështjet e dhunës me bazë gjinore. Mbi bazat e një miratimi të mirë-informuar, aktiviste të organizatave të rrjetit AWEN, identifikuan dhe rekrutuan për pjesëmarrje në DFG 3 kategori pjesëmarrësish:

- FG1 – të rinj dhe të reja, 20-24, nga zona urbane me arsim të lartë (10 pjesëmarrës)
- FG2 – të rinj dhe të reja, 20-24, nga zonat rurale (11 pjesëmarrës)
- FG3 – të rinj dhe të reja, 20-24, nga zonat urbane me arsim më pak se të lartë (10 pjesëmarrës)
- Për FG4, AWEN dhe studiueset u angazhuan në rekrutimin e aktivisteve dhe stafeve të OSHC-ve me eksperiencë

dhe njohje të gjatë të problematikave të dhunës me bazë gjinore dhe/ose të rinjve në vend (11 pjesëmarrës).

Në kushtet e kufizimeve të diktuar nga situata e pandemisë së Covid-19, të katër aktivitetet u mbajtën online, përmes platformës Zoom. Në to morën pjesë një total prej 42 pjesëmarrësish. Secili DFG u lehtësua nga një prej studiueseve dhe u asistua prej studiueses tjetër, si dhe prej stafit të AWEN (përfshi çështjet teknike) dhe zgjati nga 60-90 min. Me miratimin e informuar të pjesëmarrësve, të gjitha DFG u regjistruan dhe më pas u transkriptuan dhe u përgatitën për analizë tematike mbi konceptet kyçe që kërkonin kuptueshmëri të thelluar. Gjetjet e bazuara në të dhënat e komponentit cilësor përdoren përgjatë gjetjeve të këtij raporti studimor të gërshetuara me ato sasimore, duke synuar një analizë sa më të plotë dhe gjithëpërfshirëse.

3.2.3. Çështjet etike dhe kufizimet

Çështjet etike u adresuan përgjatë gjithë fazave të studimit. Miratimi i informuar u sigurua (gojarisht) nga çdo pjesëmarrës (si në komponentin sasior dhe në atë cilësor) përpara se të bëhej pjesë e procesit. Çështjet e anonimitetit dhe konfidencialitetit të të dhënave u trajtuan me prioritet për t'u kuptuar qartë nga të gjithë pjesëmarrësit në studim. Për të rritur shanset për përgjigje sa më të sinqerta, u aplikua vetë-administrimi i pyetësorit, përveç rasteve kur pjesëmarrësi kishte nevojë për asistencë. Megjithatë, një kufizim i njohur për sondazhet është edhe potenciali që përgjigjedhënësit të mos jenë të sinqertë/të ndershëm për atë që raportojnë. Për të tejkaluar/minimizuar këto kufizime u realizua trajnimi i kërkuesve në terren dhe u mbikëqyr puna e tyre në mënyrë konsistente. Po kështu, kombinimi i metodave na mundëson një objektivitet më të lartë të gjetjeve.

Strategjia e kampionimit të përdorur në këtë

studim është ajo e kampionimit rastësor të stratifikuar, bazuar në të dhënat e INSTAT janar 2020. Megjithatë, duhet të mbahet në konsideratë se të rinjtë janë një grupmoshë me mobilitet të lartë si dhe të rinjtë dhe të rejtat ndikohen në mënyra/nivele të ndryshme nga mobiliteti i brendshëm dhe i jashtëm.

Situata e krijuar nga Covid19 dhe kufizimet e ndryshme u reflektuan edhe në proceset e këtij studimi. Përgjatë mbledhjes së të dhënave në terren, administrimi i pyetësorit u bë në kushtet e distancës së domosdoshme dhe mbajtjes së mjeteve parandaluese për shpërndarjen e COVID19 (maskë, dezinfektantë etj.). Aktivitetet që kërkonin grumbullim (si p.sh. DFG) u realizuan virtualisht duke mos venë në rrezik në asnjë moment pjesëmarrësit dhe kërkuesit. Sigurisht që kufizime të tilla mund të kenë ndikuar edhe në nivelin dhe natyrën e pjesëmarrjes përgjatë DFG, sidomos për të rinjtë më pak të familjarizuar me përdorimin e teknologjisë apo komunikimit virtual.

4. Gjetjet

4.1. Të dhëna të përgjithshme

Përgjigjedhënësit e këtij studimi ishin të moshave 18 deri në 25 vjeç. Shumica dërrmuese e tyre i përkisnin grupmoshës 20 deri në 24 vjeç (95%) dhe një përqindje e vogël ishin 18, 19 dhe 25 vjeç (5%). 63% prej tyre banonin në zona urbane dhe 37% në zona rurale (Figura 4.1.1.). Siç shihet dhe

në figurën 4.1.2. në studim kanë marrë pjesë pak më shumë të reja (55.5%) dhe më pak të rinj (43.9%), ndërkohë që ka pasur dhe përgjigjedhënës që kanë shënuar tjetër (0.1%) edhe pse në përqindje të vogël dhe nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen (0.5%).

Figura 4.1.1. Vendbanimi (N = 1032)





Figura 4.1.2. Gjinia (N = 1086)



48.9% e pjesëmarrësve kishin përfunduar arsimin universitar dhe/ose atë pasuniversitar, 35.7% arsimin e mesëm dhe një përqindje prej 12.5% arsimin e detyrueshëm. Edhe pse në përqindje të vogla ka pasur përgjigjedhënës që kishin përfunduar vetëm arsimin fillor (2.1%) ose më pak klasa (0.5%) (Figura 4.1.3).

Në figurën 4.1.4 vihet re se një përqindje e konsiderueshme e përgjigjedhënësve ishin të punësuar me pagesë (35.5%), por edhe të papunë (21.8%). Gjithashtu, disa ishin studentë ose ishin në trajnim (18.4%), të

tjerë ndihmonin familjen në biznesin që kishte (10.2%), disa ishin të vetëpunësuar (7%) ose merreshin me punë shtëpie dhe përkujdesje (5.1%). Një përqindje e ulët ishin të papunë për shkak të një sëmundjeje ose aftësie të kufizuar (0.5%). Tek alternativa "tjetër" kanë shënuar se janë edhe studentë/në trajnim dhe të punësuar diku ose se ishin emigrantë.

Figura 4.1.3. Arsimimi

Niveli më i lartë arsimor që keni kryer, N = 1091





Figura 4.1.4. Punësimi

Cili nga pohimet në vijim përshkruan më së miri gjendjen tuaj aktuale të punësimit?, N = 1093




Siç shihet në figurën 4.1.5, prej përgjigjedhënësve që ishin në një marrëdhënie pune 52% punonin me kohë

të plotë, 20% me kohë të pjesshme dhe 18% me raste, ndërkohë që 7% kanë refuzuar të përgjigjen.

Figura 4.1.5. Lloji i punësimit

Punoni me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo thjesht me raste? N = 791



Edhe pse një përqindje e konsiderueshme e të rinjve ishin të punësuar, të ardhurat e tyre mujore personale sërish mbeten në nivele të ulëta. 36% ishin pa të ardhura personale, 28% me të ardhura nën 26,000 lekë në muaj, 15% kishin të ardhura deri në 35,000 lekë dhe vetëm 17% kishin të ardhura më të larta se 35,000 lekë në muaj (Figura 4.1.6). Diferencat gjinore janë të pranishme dhe këtu, ku të rinjtë ishin më shumë të punësuar me kohë të plotë (56.8% të rinj dhe 48.8% të reja), diçka që shpjegon dhe faktin se vajzat kishin më pak të ardhura mujore sesa djemtë (40% e të rejave ishin pa të ardhura në raport me 30% të të rinjve).

Në lidhje me gjendjen civile, më shumë se gjysma e të rinjve dhe të reja të studimit ishin beqarë/e (52.3%), 27.8% ishin në një marrëdhënie, por pa bashkëjetesë, 9.3% ishin të martuar dhe jetonin bashkë me

bashkëshortin/en, 5.6% bashkëjetonin me partnerin/en dhe 1.9% ishin të martuar, por nuk bashkëjetonin. Një përqindje e ulët, e cila gjithsesi nuk duhet të anashkalohej ishin të ndarë/divorcuar (2%) (Figura 4.1.7).

Në vazhdim të pyetjes për gjendjen civile, pjesëmarrësit janë pyetur për numrin e marrëdhënieve të mëparshme si dhe natyrën e tyre. Siç vihet re në tabelën 1, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve nuk kanë qenë të martuar më përpara (91%) ose në bashkëjetesë me partnerin/en (90%). Megjithatë, thuajse 2 në 3 prej tyre kanë patur të paktën një marrëdhënie të mëparshme pa bashkëjetesë (65%) (Figura 4.1.8). Përsa i përket diferencave gjinore, vajzat raportuan më shpesh se djemtë se kanë qenë të martuara (6% më shumë).

Figura 4.1.6. Të ardhurat personale

Cila është mesatarja e të ardhurave tuaja personale? N = 974




Figura 4.1.7. Gjendja Civile

Cili nga pohimet në vijim përshkruan më së miri gjendjen tuaj civile aktuale? N = 1088




Figure 4.1.8. Përfshirja në marrëdhënie intime

Sa herë keni qenë më përpara:

(pa përfshirë marrëdhëniet aktuale, nëse jeni në një të tillë)?





Figura 4.1.9. Të pasurit fëmijë

A keni fëmijë? N = 1074




87.2% e të rinjve/rejave raportuan se nuk kanë fëmijë dhe vetëm 11% e tyre kishin 1 ose 2 fëmijë, ndërkohë që një përqindje e ulët kishin më shumë se 3 fëmijë (0.7%). Përsa i përket diferencave gjinore vajzat e reja raportuan më shumë se kishin një ose më shumë fëmijë (10% më shumë se djemtë) (Figura 4.1.9).

Shpesh konsumimi i alkoolit është lidhur për prirjen për të ushtruar dhunë në familje dhe/ose dhunë me bazë gjinore. Sipas të dhënave në figurën 4.1.10 rezulton se thuajse gjysma e pjesëmarrësve nuk konsumojnë alkool ose e konsumojnë por nuk dehen

(45%) dhe 26% prej tyre e konsumojnë rrallë brenda një viti (26%). Prej atyre që kanë thënë se nuk konsumojnë alkool 29% ishin djem dhe 71% vajza, kështu që përdorimi i alkoolit në përgjithësi ishte më i lartë tek të rinjtë. Gjithashtu, vajzat pjesëmarrëse kanë thënë se partnerët/et konsumojnë më shumë alkool se ata vetë (57% vajza kanë thënë “nuk pi kurrë” ndërsa në raportimin për partnerin e tyre 29% kanë thënë të njëjtën gjë). Tek konsumimi javor ose i përditshëm shifrat afrohen mes partnerit/es dhe vetes (3% për konsumimin javor dhe 1% - 2% për konsumimin ditor).

Figura 4.1.10. Konsumimi i alkoolit

Sa shpesh e konsumoni alkoolin ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë)?




Në të njëjtën linjë me konsumimin e alkoolit, ishte dhe përdorimi i lëndëve narkotike, por me përqindje më të larta të moskonsumimit për veten (85.9%) dhe për partnerin (74.4%). Prej atyre që kanë thënë se nuk kanë përdorur asnjëherë substanca narkotike 39% ishin djem dhe 71% vajza, kështu që sërish djemtë rezultojnë me përdorim më të lartë të substancave narkotike, sikundër me alkoolin. Kjo vërtetohet dhe nga raportimi i vajzave për veten dhe për partnerin e tyre, ku 95% prej tyre kanë thënë se nuk kanë

përdorur asnjëherë substanca narkotike, ndërsa në raportimin për partnerin e tyre shifra ishte 68%. Këtu vlen për t'u theksuar se 16% e vetë përgjigjedhënësve dhe 26% e partnerëve të tyre konsumojnë lëndë narkotike të paktën një herë në vit, diçka shqetësuese duke marrë parasysh pasojat që lënë dhe rrezikun e varësisë (Figura 4.111). Arsimiti ka lidhje me përdorimin e substancave, pasi sa më i lartë të ishte arsimiti aq më pak ishin përdorues të substancave.

Figura 4.111. Përdorimi i substancave narkotike

Sa shpesh merrni lëndë narkotike/drogë ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë)?




Në pyetjen për probleme të shëndetit mendor janë përgjigjur N = 955 përgjigjedhënës për veten e tyre dhe N = 535 për partnerin/en. Prej tyre 45% raportuan se kanë vuajtur nga ankthi dhe 29% kanë thënë të njëjtën gjë për partnerin/en, 45% vetë dhe 30% partneri/ja kanë patur problem me gjumin, 35% vetë dhe 26% partneri/ja kishin mungesë vetëbesimi, 30% dhe 24% probleme me përqendrimin, 28% dhe 20% mungesë oreksi ose oreks i tepërt, 13% nga depresioni dhe 10% partneri/ja. Vlen për t'u përmendur fakti se 4% e përgjigjedhësve kanë menduar vetëvrasjen, një shifër

e lartë duke marrë parasysh dhe të gjitha shqetësimet e tjera emocionale të raportuara në këtë pyetje (Figura 4.1.12). Vajzat kryesonin në të gjitha këto probleme të shëndetit mendor, me diferencën më të lartë tek ankthi (ndryshimi ishte 30% më shumë tek vajzat), mungesa e oreksit ose oreksi i tepër (17% më shumë vajza) dhe mungesa e vetëbesimit (11% më shumë vajzat). Si vajzat ashtu dhe djemtë kanë raportuar nivele më të larta të problemeve të shëndetit mendor për veten e tyre se sa për partnerin/en.

Figura 4.1.12. Probleme të shëndetit mendor

A keni vuajtur ndonjëherë ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë) nga problemet e mëposhtme të shëndetit mendor?




4.2. Stereotipat gjinorë dhe dhuna me bazë gjinore

Në këtë seksion raportohen gjetjet lidhur me qëndrimet mbi stereotipat gjinorë, dhunën me bazë gjinore dhe diferencat gjinore në qëndrime. Përmes një sërë pohimesh u vlerësuan qëndrimet e të rinjve dhe të rejave pjesëmarrës në studim lidhur me stereotipa/qëndrime thellësisht të gjinizuara përkundrejt atyre neutrale. Grafiku në Figurën 4.2.1 paraqet shkallën e dakordësisë që kanë gjetur këto pohime

ku vihet re një trend i përgjithshëm mosdakordësie me stereotipa të tillë si “gratë nuk janë aq të zgjuara sa burrat” apo që kujdesi për fëmijën është kryesisht një detyrë/përgjegjësi e nënës, si në pohimin e fundit, ashtu si dhe një dominim i dakordësisë për qëndrime jo-paragjyquese për profesionalizmin e burrave dhe grave si në pohimin mbi eprorët apo aftësinë e grave për të menduar në mënyrë logjike po aq sa dhe burrat.


Figura 4.2.1. Qëndrime ndaj stereotipave gjinorë
Sa dakord bini me deklaratat e mëposhtme?



Pavarësisht një trendi të përgjithshëm, nuk mund të anashkalohen pa u nënvijëzuar se ende 42% e të rinjve dhe të rejave të pyetur mendojnë se djemtë duhet të nxiten më shumë se vajzat për t'u përfshirë në sporte/atletikë. Po kështu, 28% e përgjigjedhënësve janë plotësisht apo pjesërisht dakord me pohimin se gratë nuk janë aq të zgjuara sa burrat dhe 19% që nuk bien dakord se gratë mund të mendojnë në mënyrë logjike si edhe burrat. Më tej, duke i zbrërthyer këto gjetje sipas gjinisë bëhet e dukshme se djemtë dy herë më shumë se vajzat janë

plotësisht dakord se gratë në përgjithësi nuk janë aq të zgjuara sa burrat dhe 76% e vajzave përkundrejt 46% të djemve besojnë se gratë janë po aq të afta sa burrat për të menduar në mënyrë logjike. Diferenca vihet re edhe midis zonave urbane dhe rurale. Për shembull, ndonëse 19% e përgjigjedhënësve janë plotësisht dakord se djemtë duhet të inkurajohen më shumë se vajzat për t'u marrë me sporte, ky qëndrim është më i përhapur tek të rinjtë e të rejtat e zonave rurale sesa atyre urbane (me 5 pikë për qind diferencë).

Figura 4.2.2. Qëndrimet mbi rolet e burrave dhe grave në shoqëri
Sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme mbi rolet e burrave dhe grave në familje?



Këto rezultate përforcohen edhe nga ato mbi qëndrimet mbi rolet e burrave dhe grave në raport me martesën, familjen e rritjen e fëmijëve, punësimin e më gjerë. Kështu 33% e përgjigjedhënësve besojnë se martesa funksionon më mirë nëse bashkëshorti nuk përfshihet në punët e shtëpisë, apo se aktivitete të tilla si ndërimi i foshnjës apo mbikëqyrja e aktiviteteve të fëmijëve janë aktivitete që i shkojnë përshtat nënave (me 51% dhe 36% respektivisht). Qëndrimet janë disi më të hapura drejt barazisë gjinore në sferën publike – punësim, marrëdhëniet shoqërore dhe edukim (mbi 75% e pjesëmarrësve besojnë në edukimin dhe rëndësinë e edukimit në nivele të ngjashme si për djemtë dhe për vajzat).

Në shqyrtimin e të gjitha elementeve, në të dy ekstremet e qëndrimeve (plotësisht dakord dhe plotësisht jo dakord) ka një hendek të ndjeshëm gjinor (pjesa më e madhe me një diferencë midis vajzave dhe djemve prej 15 pikë përqindje). Diferencat e mëdha veçanërisht tek pritshmëritë e ndryshme mbi rolet e burrave dhe grave në martesë dhe familje logjikshëm çojnë drejt supozimit se çiftet/familjet e krijuara mes të rinjve me këto ndryshime në qëndrime kanë gjasa për tensione në ndarjen e roleve dhe menaxhimin e tensioneve që krijohen

në përpjekjet për të kombinuar jetën në familje me atë në tregun e punës (Knight dhe Brinton, 2017).

Ndoshta edhe e pritshme, por zonat urbane raportojnë qëndrime më rezistuese ndaj stereotipave tradicionalë të ndarjes gjinore të roleve. Kjo vlen edhe për nivelin e arsimit. Për shembull, 73% e përgjigjedhënësve me arsim fillor ishin plotësisht dakord se kreu i familjes duhet të jetë burri përkundrejt vetëm 33% të përgjigjedhënësve me arsim të lartë. Tendenca dhe diferencat ishin të ngjashme edhe në elementët e tjerë të paraqitur në Figurën 4.2.2.

Për të eksploruar mbi çështjet e dhunës me bazë gjinore, fillimisht përgjigjedhësit u pyetën mbi çështjet e dhunës dhe dhunës në familje, perceptimet e tyre mbi përhapjen e këtyre problematikave dhe perceptimet e prishmëritë për shkallën e reagimit të komuniteteve të tyre respektive. Siç lexohet edhe në tabelën e mëposhtme, ndonëse në përgjithësi duket se ka ende një sens komuniteti, ai vjen dhe zbehet nga konstatimi tek reagimi ndaj problemeve të dhunës dhe kanë pikën më të ulët tek iniciativa për të ndërhyrë apo bërë diçka (me 34%) nga fqinjët nëse dikush në komunitet do të përfshihej në një situatë dhune në familje.

Tabela 4.2.1. Dhuna, dhuna në familje dhe komuniteti.

	Po	Jo	Nuk e di	Total
Në komunitetin tuaj a janë fqinjët në përgjithësi të prirur për ta njohur mirë njëri-tjetrin?	62.1%	18.2%	19.7%	100.0%
Nëse do të ndodhte një sherr në rrugë në komunitetin tuaj, a do të ndërhynin njerëzit/ do të bënin diçka për ta ndaluar sherrin?	55.0%	18.8%	26.2%	100.0%
Nëse dikush në komunitetin tuaj do të hynte në telashe, a do të ofronin ndihmë fqinjët?	46.4%	19.2%	34.4%	100.0%
Nëse dikush në komunitetin tuaj do të hynte në telashe, a do të telefononin policinë fqinjët?	49.6%	19.4%	31.0%	100.0%


	Po	Jo	Nuk e di	Total
Nëse dikush në komunitetin tuaj do të përfshihej në një situatë dhune në familje, a do të ndërhynin/bënin diçka fqinjët?	33.9%	27.2%	38.9%	100.0%
Nëse dikush në komunitetin tuaj do të përfshihej në një situatë dhune në familje, a do të telefononin policinë fqinjët?	41.9%	20.1%	38.0%	100.0%

Ndonëse me diferenca të ngushta, në të gjitha elementët e tabelës, dukej një tendencë me e madhe e të rinjve/të rejave nga zonat rurale për të raportuar gatishmëri më të madhe për ndërhyrje direkte, përkundrajt njoftimit të policisë që

dominonte si zgjedhje tek përgjigjedhënësit e vendosur në komunitete urbane. Sipas përfaqësuesve të organizatave të SHC që punojnë me të rinjtë në këto zona disa shpjegime të mundshme lidhen me mentalitetin dhe besimin në shërbime.

Figura 4.2.3. Shqetësime nga sulme të mundshme fizike apo seksuale

Gjatë 12 muajve të fundit, a jeni shqetësuar ndonjëherë se mund të sulmoheni apo lëndoheni fizikisht apo seksualisht nga ndonjë prej personave në vijim? Nëse po, sa shpesh?



“Në zona rurale, dikur shumica janë martuar me mblesëri, dhe u thonë: “Ju ma gjetët, tani përballojeni!”. Ndërsa tani që e gjejnë vetë [partnerin/en], familja u thotë: “E gjeje vetë!”. Sidomos kur bëhet fjalë për moshën të reja 18 vjeçare, që familja mund t’i ketë kërkuar që të presin dhe pak kohë. Prandaj mund të kenë turp që të shkojnë tek familjarët dhe të afërmit dhe kërkojnë mbështetje tek organizatat”. (DFG me OSHC)

“Kanë një mungesë besimi për policinë, duan të këshillohen nga gratë. Vijnë direkt tek ne dhe pastaj në polici.” (DFG me OSHC)

Më tej, pyetjet u fokusuan tek raportimi i eksperiencave individuale. Nga të gjithë të pyeturit, 7% raportuan se në 12 muajt e fundit kishin qenë vazhdimisht apo shpesh herë të ndjerë të kërcënuar nga një i/e panjohur. Të dytët në radhë për nga shpeshësia e raportimit si kërcënim i vazhdueshëm ishin ish-partnerët (4%).

Vajzat dominojnë ndër ata që janë ndier vazhdimisht apo shpesh herë të kërcënuar në të gjitha skenarët përveç alternativa ku përgjigjedhësit janë ndier të kërcënuar nga një i/e afërm/e apo anëtar/e i/e familjes, përveç partnerit/es suaj dhe nga policia. Në të dy këto raste, janë më të shumtë djemtë, por diferencat janë të vogla. Diferencat gjinore janë më të thella dhe në disfavor të vajzave, veçanërisht në përgjigjet që tregojnë mungesën e kërcënimeve apo shkallën e sigurisë. Kështu 85% e djemve raportojnë të mos jenë ndjerë kurrë të kërcënuar nga një i/e panjohur, përkundrajt vetëm 55% të vajzave. Edhe në raport me ish-partnerët, 90% e djemve raportojnë se nuk e kanë ndjerë asnjëherë një kërcënim të tillë, përkundrajt 78% të vajzave, duke lënë rreth 22% të vajzave të shqetësuara të paktën ndonjëherë nga ish-partnerët. Kërcënimet nga ish-partnerët është më i përhapur tek vajzat si pasojë e mentalitetit, por edhe mos marrjes së

ndihmës së nevojshme për t’u mos riviktimizuar (kryesisht për vajzat) apo për të mos vazhduar të jesh dhunues (kryesisht për djemtë).


“Kemi fenomenin e përndjekjes. Djemtë dhe burrat ende nuk arrijnë ta pranojnë që gruaja, e dashura ka vendosur të shpëputet nga ai... Kjo persiston dhe tek të rinjtë.” (DFG me të rinj)

“Duhet të humbasësh shumë dhe të fillosh të reflektosh. Edhe ne nuk e ndëshkojmë dhe as e ndihmojmë mjaftueshëm dhunuesin që të detyrohet të reflektojë dhe ndryshojë. Nga ana tjetër shumë gra dhe vajza thonë: “atë që më bëri mua nuk e lejoj më të më ndodhi”... Na ndodh shumë shpesh që partner i ardhshëm është përsëri dhunues.” (DFG me OSHC)

Tendencat e vërejtura më sipër, qëndrojnë edhe në raport me adoptimin e sjelljeve të caktuara për të parandaluar/mbrojtur nga sulmet të mundshme fizike apo seksuale. Në përgjithësi, të paktën 15% e përgjigjedhësve raportojnë se kanë shmangur daljen vetëm nga shtëpia, vende të caktuara, qëndrimin vetëm me dikë tjetër, si pasojë e frikës/pasigurisë nga ndonjë sulm i mundshëm fizik dhe/ose seksual. Vetëm 53% e vajzave nuk kanë nguruar ndonjëherë që të dalin shtëpia vetëm përkundrajt 85% të djemve. Po kështu, vetëm 43% e vajzave raportojnë se nuk kanë shmangur ndonjëherë kalimin nga rrugë të caktuara apo vajtjen në vende të caktuara përkundrajt 77% të djemve përgjigjedhës. Tre herë më shumë vajza sesa djem kanë shmangur qëndrimin vetëm me një koleg/shëfën në mjediset e punës.

Figura 4.2.4. Sjellje të adoptuara nga frika nga dhuna fizike apo seksuale

Gjatë 12 muajve të fundit, a keni kryer ndonjë prej veprimeve të mëposhtme nga frika e dhunës fizike apo sulmit seksual



Në përgjithësi, ka një nivel të lartë ndërgjegjësimit mbi problematikën e dhunës ndaj grave në vendin tonë. Pjesa dërrmuese e përgjigjedhënësve (88%) raportojnë se dhuna ndaj grave është shumë e përhapur (45%) apo e përhapur (43%) dhe nuk ka asnjë që të mohojë problematikën (asnjë nuk ka zgjedhur alternativën “aspak e përhapur”). Puna për rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave të ndryshme ndërgjegjësuese duket se ka kontribuar në këto rezultate. Siç shihet edhe në grafikun më poshtë, 67% e përgjigjedhënësve kanë parë/dëgjuar mbi

fushata ndërgjegjësuese kundër dhunës ndaj grave.


Edhe këtu, si pasojë e eksperiencave të drejtpërdrejta ose/dhe e ndjeshmërisë më të madhe ndaj problematikës, gjejmë se më shumë vajza (50% e tyre) sesa djem (37% e tyre) raportojnë perceptimin se dhuna ndaj grave në Shqipëri është shumë e përhapur. Po kështu, vajzat (75% e tyre) më shumë sesa djemtë (59%) dhe përgjigjedhënësit në zona urbane (72% e tyre) sesa ata në zona rurale (59% e tyre) kanë qenë në kontakt me një fushatë ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave në 12 muajt e fundit duke

krijuar hapësirë interpretimi se fushata të tilla nevojitet të targetojnë në mënyra më të drejtpërdrejta/më efikase djemtë dhe

zonat rurale, pasi mentaliteti në këto zona vazhdon të jetë pengues siç përshkruhet edhe nga pjesëmarrësit në DFG.

Figura 4.2.5. Perceptime mbi përhapjen e dhunës ndaj grave dhe ndërgjegjësimi për të **Në përgjithësi, sa e përhapur mendoni se është dhuna ndaj grave në Shqipëri (nga partnerët, persona të njohur apo të panjohur)?**

A keni parë apo dëgjuar së fundmi për ndonjë fushatë ndërgjegjësuese kundër dhunës ndaj grave?



“Mundohemi që zonat rurale t’i fusim në projektet tona. Kemi pasur projekte që edhe e kanë kërkuar vetë. Mendoj se këto duhet të jenë në kurrikulën shkollore dhe të fliten gjithmonë. Ndodh që shkojmë në klasa që të bëjmë sesione informuese. Mësueset nxjerrin çunat jashtë dhe informacionin e marrin vetëm vajzat.” (DFG me OSHC)


“Informacion ka, por në zona rurale nuk është i plotë, nuk janë të informuar siç duhet për këto pjesë. Janë zona të thella; është e vështirë se edhe mentaliteti është ende që ka turp të dëgjohet edhe vetë fjala seks – duket si jashtë normales. P.sh. në biologji, klasa e tetë – trupi i njeriut në zona rurale ende nuk i trajtojnë, i heqin.” (DFG me të rinj)

Në përgjithësi, duket se dhuna ndaj grave në familje identifikohet dhe raportohet më shumë tek të tjerët sesa në familjet përkatëse. Përgjigjedhënësit tregojnë në rreth 47% të rasteve se njohin dikë në lagjen e tyre që ka përjetuar forma të dhunës me bazë gjinore në familje dhe në 41% të rasteve për situata të ngjashme në rrethin e tyre shoqëror dhe familjar. Ndonëse me diferenca jo shumë të mëdha, vajzat më shumë sesa djemtë, zonat urbane më shumë sesa ato rurale dhe ata me arsim të lartë më shumë sesa përgjigjedhënësit më arsim të mesëm apo të ulët, kishin tendencën të raportnin/njihnin dhunën ndaj grave edhe në familje/rrethin e tyre shoqëror. Nga diskutimet në DFG rezultoi se një nga arsytet e një lloji rezistence për të pranuar se dhuna ndodh edhe në rrethin

tonë shoqëror dhe familjar lidhet ndër të tjera me faktin se fajësimi i viktimave

mbetet ende problematik.

Figura 4.2.6. Incidenca e rasteve të njohura të dhunës ndaj grave në familje
Kur mendoni për dhunën ndaj grave në familje (p.sh. nga bashkëshorti, partneri, kunati etj), a ju vjen ndërmend ndonjë grua që ka përjetuar ndonjë prej formave të dhunës në familje:



Pengesë në raport me identifikimin/ raportimin e dhunës me bazë gjinore është edhe niveli i informimit jo vetëm në raport me njohuritë për ta njohur dhe kategorizuar atë, por edhe për mënyrën sesi mund ta raportojnë dhe kërkojnë ndihmë për ta adresuar. Një në katër përgjigjedhënës nuk e kishte idenë (8%) apo nuk ndihej i informuar mjaftueshëm (18%) për të ditur se si duhet të reagojë në situata dhunë si p.sh. nëse do të përballeshin me sulm/ dhunë seksuale. Edhe këtu diferencat nuk i sfidojnë pritshmëritë, me vajzat më shpesh sesa djemtë, zonat urbane më shumë sesa ato rurale dhe ata më të arsimuarit që raportojnë nivele më të larta vetëvlerësimi për nivelin e informimit.

Dhe në fakt, familja mbetet “streha” e parë për të kërkuar ndihmë (83%), më pas, me peshë të ngjashme janë miqtë dhe organizatat e shoqërisë civile (62% dhe 61% respektivisht). Më shumë se gjysma e përgjigjedhënësve nuk e shohin alternativë të përshtatshme raportimin e dhunës në familje tek përfaqësues të institucioneve fetare (51% nuk janë dakord), por nuk mund të mos nënvijëzohet se më shumë se 1/3 kanë të njëjtin qëndrim edhe kundrejt një oficeri/je policie (35%).

Figura 4.2.7. Vetëvlerësim mbi nivelin e informimit për përballimin e situatave të dhunës seksuale

Sa i/e mirëinformuar mendoni se jeni rreth veprimeve që do t'ju duhej të ndërmerrnit nëse do të binit pre e dhunës seksuale?





Figura 4.2.8. Kujt do t'i tregonte një grua e dhunuar mbi dhunën?


Një grua e dhunuar nga bashkëshorti apo partneri i saj do t'i tregonte për këtë, edhe nëse dhuna nuk do të ishte aq e shpeshtë, si për shembull jo më shumë se një herë në vit?



Familja kryeson si zgjedhja e parë edhe kur përgjigjedhënesit u pyetën se ku do drejtoheshin në rast përballje me DHMI. Më shumë se gjysma e tyre raportojnë se do kishte (disi deri shumë të ngjatë se) do i drejtoheshin njërit nga prindërit nëse partneri/ja do i kërcënonte (68%), dhunonte fizikisht (75%) apo kryente akte seksuale pa dëshirën e tyre (56%). Por vendi

i prindërve/familjes është i ngjashëm me atë të organizatave joqeveritare dhe policisë kur bëhet fjalë për dhunën seksuale (56%, 52% dhe 51% respektivisht). Psikologu apo ndonjë profesionist tjetër që ofron këshillim zgjidhet edhe më shpesh në këto rast (59% do u drejtoheshin atyre në rastet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime).

Figura 4.2.9. Ku do të drejtoheshit në rast dhune në marrëdhëniet intime...
Ku do drejtoheshit nëse personi me të cilin/ën ti je në një marrëdhënie intime...




Shumica e përgjigjedhënësve do e gjenin me vend dhe të pranueshëm edhe rolin e shërbimeve shëndetësore në identifikimin e dhunës me bazë gjinore. Rreth 68% e tyre janë dakord që gjatë kontrolleve rutinë,

mjekët që vënë re lëndime fizike/plagë te gratë t'i pyesin ato nëse lëndimet janë si pasojë e akteve të dhunës, ushtruar ndaj tyre.

Figura 4.2.10. Qëndrimet mbi përfshirjen e shërbimit mjekësor në identifikimin e dhunës ndaj grave

A do ta gjykonit të pranueshme që gjatë kontrolleve rutinë, mjekët që vënë re lëndime fizike/plagë te gratë t'i pyesin ato nëse lëndimet janë shkaktuar nga dhuna?



Rreth 76% e të rejave janë dakord që kjo të ndodhë përkundrejt 58% të djemve. Po kështu, ndonëse me diferenca më të ngushta, kjo duket më e pranueshme ndër përgjigjedhënësit në zonat urbane dhe midis atyre më arsim të lartë.

4.3. Ngacmimet dhe dhuna seksuale

Seksioni i tretë i gjetjeve lidhet specifikiisht me dhunën seksuale në marrëdhëniet intime. Prej N = 1095 pjesëmarrësve 81% kishin kryer marrëdhënie seksuale dhe 19% jo. (Figura 4.3.1.). Moshë mesatare për marrëdhënien e parë seksuale ishte 17.9 vjeç, duke filluar nga moshë 13 vjeç (në të cilën nuk mund të jepet miratimi për

marrëdhënie seksuale) dhe deri në moshën 25 vjeç. Moshë më e shpeshtë e kryerjes së marrëdhënieve seksuale ishte gjithashtu moshë 18 – vjeçare. Moshë mesatare e kryerjes së marrëdhënieve seksuale ishte 17 vjeç për djemtë dhe 18 për 19 vjeç (mesatare 18.5) për vajzat. Prej atyre që nuk kishin kryer marrëdhënie seksuale 23% ishin djem dhe 77% vajza, 41% ishin nga zonat rurale dhe 59% nga zonat urbane.

Figura 4.3.1. Marrëdhëniet seksuale

A keni kryer marrëdhënie seksuale? N = 1095





Figura 4.3.2. Detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale

Si do ta përshkruanit marrëdhënien tuaj seksuale të parë?



Siç shihet në figurën 4.3.2. shumica e pjesëmarrësve/eve raportuan se ata/o kanë kryer marrëdhënie seksuale me dëshirë

(83%). Këtu vërehet 8% e kampionit kanë kryer marrëdhënie seksuale me detyrim, ku në këtë përqindje vajzat ishin më shumë


se djemtë me 8% diferencë. Gjithashtu, pjesëmarrësit/et me arsim fillor dhe 9 – vjeçar kishte më shumë gjasë që të raportonin se ishin detyruar që të kryenin marrëdhënie seksuale në raport me ata me arsim të mesëm dhe universitar. Pjesa tjetër kanë refuzuar të përgjigjen ose nuk e dinin si ta përshkruanin marrëdhënien e tyre të parë seksuale (9%) (Figura 4.3.2).

Në jetën e tyre seksuale aktive pjesëmarrësit/et kishin mesatarisht 2.6 partnerë/e dhe 1.2 gjatë vitit të fundit.

Përgjigja më e shpeshtë këtu (moda) për të dyja rastet ishte sërish 1, që do të thotë se shumica e pjesëmarrësve kanë pasur një partner/e gjatë jetës së tyre seksuale aktive dhe gjatë vitit të fundit. Numri i partnerëve varionte nga 1 deri tek 20 për të gjithë jetën seksuale aktive dhe nga 1 deri tek 6 për partnerët/et gjatë vitit të fundit. Krahasimi mes djemve dhe vajzave tregoi se mesatarja e partnereve për djemtë ishte M_{djem} = 3.3 dhe për vajzat M_{vajza} = 1.7.

Figura 4.3.3. Përdorimi i metodave kontraceptive

Cilat metoda kontraceptive keni përdorur gjatë marrëdhënies seksuale të fundit? N = 856



Përdorimi i metodave kontraceptive mbetet në nivele shumë të ulëta, 41% e përgjigjedhënësve nuk kanë përdorur asnjë metodë në marrëdhënien e tyre të fundit seksuale. Prezervativi është metoda më e përdorur me 47.3%, i ndjekur nga pilulat


kontraceptive por me një diferencë shumë të madhe sepse ato janë përdorur në 5.4% të rasteve. Injeksioni, pilulat e emergjencës dhe metoda të tjera u raportuan në përqindje shumë të ulëta. Sa më i lartë arsimit i tyre aq më pak kishte mundësi që të

mos përdornin asnjë metodë kontraceptive, ndërsa përsa i përket zonës së banimit ata/o të zonave rurale përdorin më pak kontraceptive pasi 5.5% më shumë prej tyre kanë thënë “asnjë” (Figura 4.3.3.). Gjithashtu, ka një lidhje mes mënyrës me të cilën është kryer marrëdhënia seksuale e parë dhe përdorimit të metodave kontraceptive në marrëdhënien e fundit, sepse ata/o që kishin kryer marrëdhënie me dëshirë kishin më pak mundësi që të mos përdornin asnjë metodë kontraceptive, në raport me ata/o që e kishin kryer me detyrim. Pjesëmarrësit në fokus grupe kanë shpjeguar arsyet pse

përdorimi i metodave kontraceptive është i ulët, veçanërisht në zona rurale:

“Në zonat rurale ose nuk i njohin, ose i kanë për turp t’i përdorin. Kjo jo vetëm në zona rurale por edhe në zona urbane. Ende në farmaci gjen të rinj që druajnë të blerë një prezervativ, i thonë farmacistes “me jep një paracetamol” dhe i shkelin syrin. Nuk ia njohin vlerën që kanë metodat kontraceptive” (DFG me të rinj)

Figura 4.3.4. Perceptime mbi përhapjen e dhunës seksuale ndaj grave në Shqipëri
Në përgjithësi, sa e përhapur mendoni se është dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri (nga partnerët, persona të njohur apo të panjohur)? N = 1077



Një përqindje shumë e lartë e përgjigjedhënësve mendonin se dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri është e përhapur (80%), qoftë kjo nga partnerët ose nga njerëz të njohur apo të panjohur (Figura 4.3.4). Ky mendim natyrisht është formuar mbi bazën e eksperiencave

personale, atyre në rrethin shoqëror dhe familjar ose komunitar si dhe nga çfarë mund të shihet/dëgjohej në lajmet herë pas here. Vajzat e reja prireshin më shumë të besonin se është e përhapur (8% më shumë), përgjigjedhësit/et me arsim universitar dhe të mesëm (10% më shumë)

dhe ata të zonave urbane (8% më shumë). Niveli arsimor dhe zona e banimit përkojnë me informimin dhe përkufizimin që mund të jepet për dhunën seksuale. Shpesh, në zonat rurale dhe tek njerëzit me nivel të ulët arsimor ekziston një paqartësi për dhunën seksuale ndaj grave. Aktorët kyç që morën pjesë në fokus grupe, si dhe të rinjtë dhe të rejtat e konfirmojnë këtë gjetje. Megjithatë, përfaqësueset e OSHC – ve ndjejnë se ka një ndryshim gjatë viteve të fundit për të kërkuar ndihmë edhe në rastet kur ka paqartësi nëse është dhunë apo jo.

“Ka një iniciativë më të madhe për të telefonuar dhe për të marrë informacion në lidhje me çfarë është ajo që po ndodh. Më shumë tek të rinjtë që nuk janë në lidhje të konsoliduara, kanë një dëshirë për të marrë informacion por pa qenë të sigurt nëse është apo jo dhunë”, (DFG me OSHC)

“P.sh. rastin e dhunës seksuale: më përpara në rrethin tim shoqëror kuptoja se me dhunë seksuale kuptoheshin vetëm marrëdhëniet, ndërkohë që sot edhe ngacmimet seksuale dhe veprat e turpshme dhe molestimi konsiderohen dhe merren parasysh”, (DFG me OSHC)

Në vijim të pyetjes së mëparshme për shkallën e përhapjes së dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, përgjigjedhësit/et kishin parë/dëgjuar shumë shpesh raste të ngacmimit ose dhunës seksuale në media (TV/radio/shtypi i shkruar, 86%), në mediat sociale (79%) dhe në mediat online (78%). Ekspozimi ndaj dhunës seksuale në mjedise më të afërta ishte në nivele më të ulëta, por gjithsesi të konsiderueshme. Kështu, 23%, e përgjigjedhënesve kanë parë/dëgjuar për dhunë seksuale në lagjen e tyre, 14% në rrethin e tyre shoqëror, 10% në punë dhe 7% në rrethin familjar. Thuajse gjysma prej tyre (48%) e kanë parë/dëgjuar në

qytetin apo në fshatin ku jetojnë. Nëqoftëse konsiderohen së bashku këto mjedise: familjar, shoqëror, lagjja dhe puna, rezulton se 54% e përgjigjedhënesve kanë parë apo dëgjuar për gra/vajza që kanë përjetuar dhunë seksuale në mjediset e tyre të afërta dhe të jetesës së përditshme (Figura 4.3.5.).

Përsa i përket diferencave gjinore vërehet se vajzat kanë thënë më shpesh (4% deri në 6%) se kanë parë dhunë në TV, media online dhe media sociale, ndërsa djemtë më shpesh në qytetin/fshatin dhe në lagje me 10% më shumë. Niveli arsimor dhe zona e banimit kishte ndryshime në rastet e TV – së, mediave online dhe atyre sociale, ku njerëzit me nivel më të lartë arsimor dhe ata të zonave urbane e kishin hasur më shpesh dhunën seksuale. Megjithatë, këto diferenca zbeheshin kur ishte fjala për fshatin/qytetin dhe për rrethin familjar.

Në pyetjen sa e kishin përjetuar vetë pjesëmarrësit/it dhunë seksuale nga partneri apo ish – partneri janë bërë një sërë pyetjesh që lidhen me detyrimin për të kryer akte seksuale të ndryshme me detyrim, deri në kryerjen e marrëdhënieve seksuale me detyrim.


Në këtë pyetje 7% e pjesëmarrësve kanë thënë se janë detyruar të paktën një herë për të kryer marrëdhënie seksuale me forcë nga partneri aktual, ndërsa 11% prej tyre janë detyruar nga ish – partneri. Të njëjtat përqindje janë dhe për rastet kur partneri aktual/ish – partneri janë përpjekur për të mbajtur me forcë pjesëmarrësin/en për të kryer marrëdhënie seksuale ose për t'i përfshirë në një aktivitet seksual kundër dëshirës së tyre. Vlen për t'u theksuar rritja në përqindje në rastet kur vetë përgjigjedhëneset/it kanë pranuar që të kryejnë marrëdhënie seksuale për shkak të frikës së reagimit të partnerit/ish – partnerit – 12% dhe 16% përkatësisht (Figura 4.3.6). Kjo tregon se një person mund t'i nënshtrohet dhunës seksuale dhe të mos kundërshtojë për shkak të frikës nga partneri/ja, edhe pse është kundër dëshirës së tij/saj. Gjithashtu, në këtë pyetje

spikat fakti se përgjigjedhënësit i kanë përjetuar më shumë këto në marrëdhënie të

mëparshme sesa në marrëdhëniet aktuale.

Figura 4.3.5. Ekspozimi indirekt dhe direkt ndaj rasteve të ngacmimit/dhunës seksuale ndaj grave

A keni parë apo dëgjuar së fundmi ndonjë rast ngacmimi/dhune seksuale ndaj vajzave/ grave?



Diferencat gjinore në këtë pyetje janë më të ndjeshme në të gjitha alternativat. Kështu në alternativat e para vajzat janë detyruar më shumë se djemtë që të kryejnë marrëdhënie seksuale (12% nga partneri aktual dhe 20% më shumë vajza nga ish - partneri). Të njëjtin trend kanë dhe alternativat e tjera. Diferenca bëhet dhe

më e madhe në rastet kur kanë pranuar që të kryejnë marrëdhënie seksuale nga frika e partnerit, ku arrin 26% më shumë vajzat sesa djemtë për partnerin aktual dhe 27% më shumë për partnerin e mëparshëm. Edhe në këtë rast niveli arsimor kishte ndikim, pasi ata me nivel më të lartë arsimor raportuan më shumë “asnjëherë”


në të gjitha alternativat. Pjesëmarrësit/et në fokus – grupet kanë dhënë dy shpjegime të ndryshme për raportimin e ndryshëm për partnerin aktual dhe ish – partnerin: mund të lidhet ose me ndërgjegjësimin më të madh të vajzave ose me turpin më të madh se po dështojnë në marrëdhëniet e tyre edhe një herë tjetër.

“Sepse një femër që e ka përjetuar është ndërgjegjësuar dhe tani i thotë partnerit ‘stop’”, (DFG me të rinj)

“Me të dytin mund të mos e raportojnë pasi është sërish paragjykim i se “ja u nda nga i pari, u nda edhe nga tjetri”. (DFG me të rinj)

Figura 4.3.6. Përjetimi i dhunës seksuale në marrëdhëniet intime

Sa herë ka kryer partneri/ja juaj aktual/e ndonjë prej veprimeve në vijim? Po ish-partneri/ja?



Krahas dhunës seksuale të përjetuar nga partneri apo ish – partneri përgjigjedhësit/et u pyetën nëse ata/o kanë përjetuar forma të tjera të dhunës fizike ose seksuale nga njerëz të tjerë. Kështu, nga përgjigjet e tyre vërehet se të paktën një herë: 26% janë goditur ose u janë shkukur flokët, 20% janë goditur duke u lënduar, 12 % janë goditur me shkelm, 9% janë goditur me një objekt, 4% janë goditur ose prerë me diçka. Kërcënimi se do i lëndonte keq ose do i vriste ishte më i lartë, arrinte në 15% të rasteve. Njerëzit që kanë ushtruar dhunë të kësaj natyre ishin nga më të ndryshmit/et: babai, mamaja, vëllai, mësuesit/et, kushërinjtë, shokët. Gjithashtu, ndër njerëzit që kanë ushtruar dhunë nuk mungonte partneri apo ish – partneri apo bashkëshorti, madje dhe ish – vjehrra dhe të afërm të tjerë nga ana e ish – bashkëshortit. Moshë e tyre varionte nga fëmijëria e hershme (5 vjeç) e deri në moshën e rritur aktuale 23 vjeç. Për më shumë, për dhunën më ekstreme që ishte goditja me thikë ose prerja me diçka abuzuesit më të shpeshtë ishin ish – partnerët, babai dhe shokët (Figura 4.3.7.).

17% e përgjigjedhësve/eve raportuan se dikush i kishte prekur apo përçafuar të paktën një herë në jetën e tyre. Tek njerëzit që e kanë bërë këtë veprim renditeshin të afërm, fqinjë por edhe njerëz të panjohur, njerëz që mund të ishin në autobusë etj. Moshat që u ka ndodhur varionte nga 5 vjeç e deri në moshën aktuale, me një shpeshësi më të madhe nga moshë 13 deri 20 vjeç. Vështrimet ngultas apo në mënyrë lakmitare që i kanë bërë që të ndihen në siklet kanë ndodhur në 28% të vajzave dhe djemve të këtij studimi. Njerëzit që e kanë bërë këtë akt sërish ishin të ndryshëm, por më së shumti ishin njerëz të panjohur, kalimtarë në rrugë dhe në ambiente të tjera publike, pa përjashtuar dhe këtu rastet e babait, xhaxhallarëve dhe shokëve të klasës. Sërish grupmosha më e shpeshtë e ekspozuar fillonte nga 13 deri në 20 vjeç. 17% nga përgjigjedhësit/et kanë thënë se janë gjendur në situata ku dikush ka

komentuar apo bërë shaka me konotacion seksual, kryesisht në rrethin e tyre shoqëror duke filluar që nga moshë 10 – vjeçare. Më shumë se 1 në 10 përgjigjedhës/e kanë marrë pamje ose dhurata me natyrë qartësisht seksuale, ose u kanë treguar pjesë intime të trupit që i ka bërë që të ndihen të fyer, kryesisht nga ish – partnerë dhe njerëz nga rrethi shoqëror, por edhe nga kushërinjtë apo njerku, duke filluar nga moshë 10 – vjeçare me më shumë shpeshësi në adoleshencë (Figura 4.3.7.).

6% e pjesëmarrësve/eve janë detyruar që të shohin material pornografik dhe 3% edhe të pozojnë nudo kundër dëshirës së tyre. Këtu rrethi i njerëzve që i kanë detyruar që të kryenin këto sjellje është më i ngushtë, qëndron tek ish – partneri, shokë dhe të afërm vetëm. Moshat e raportuara ishin 17, 18 dhe 19 vjeç.

Në lidhje me dhunën seksuale me kontakt fizik, në 3 alternativat e fundit të kësaj pyetjeje 11% e pjesëmarrësve/eve kanë thënë se dikush i ka prekur pa dëshirën e tyre në pjesët intime pa dëshirën e tyre, 9% janë detyruar që të preknin dikë tjetër dhe 8% (thuajse 1 në 10) janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale kundër dëshirës së tyre (Figura 4.3.7). Njerëzit që i kanë prekur ose i kanë detyruar që t'i preknin pa dëshirën e tyre varionin nga vëllai, kushëri, rrethi shoqëror dhe ish – partneri tek njerëz që ishin në punonjës në institucione. Janë raportuar raste që ngjarja ka ndodhur në moshën 10 – vjeçare, kurse shumica prej tyre ishin në moshën 13, 14 vjeç dhe 17 – 20 vjeç. Po të njëjtët njerëz përmenden dhe në rastin e detyrimit për të kryer marrëdhënie seksuale: ish – partneri apo partneri aktual, vëllai, njerku, shokë ose vjehri, diçka që tregon se dhuna fizike dhe dhuna seksuale shpeshherë ndodhin së bashku, siç është konfirmuar dhe në studimin e mëparshëm të AWEN (2019). Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë ka ndodhur duke filluar nga moshat 13 vjeç e deri në moshën 22 dhe 23 vjeç, në disa raste në mënyrë të përsëritur në vite.

Për alternativat e para që i referoheshin kryesisht dhunës fizike vajzat kanë patur më pak eksperiencë, madje për forma më serioze të dhunës fizike si p.sh lëndim i fortë vajzat kanë thënë “asnjëherë” me diferenca deri në 10% më shumë se sa djemtë. Kur vjen fjala tek dhuna seksuale, vajzat kanë një rritje të madhe në përjetimin e këtyre ngacmimeve që fillon nga 10% dhe arrin në 30%. Tek dhuna seksuale online nuk kishte ndryshime mes vajzave

dhe djemve. Niveli arsimor sërish ndikon në përjetimin e dhunës, pasi sa më i lartë arsimi i përgjigjedhënësve/eve aq më pak mundësi që të jenë ekspozuar në forma të ndryshme të dhunës, për të gjitha rastet e shprehura në këtë pyetje. Përgjigjedhësit/et nga zonat rurale janë ekspozuar më shumë në dhunë fizike, sesa ata të zonave urbane. Megjithatë, këto diferenca nuk qëndrojnë në rastet e alternativave që i referohen dhunës seksuale.

Figura 4.3.7. Përjetimi i formave të ndryshme të dhunës

A jeni përballur me persona të tjerë që ju kanë trajtuar në mënyrë të padëshiruar apo fyese?





Figura 4.3.8. Kërkimi i ndihmës

A i jeni referuar ndonjëherë personave në vijim për të kërkuar ndihmë?



Në figurën 4.3.8 vërehet se 72% e përgjigjedhënësve/eve nuk kanë kërkuar ndihmë për dhunën që kishin përjetuar, për asnjë nga format e saj të përmendura më sipër. Një përqindje e vogël (9%) kanë kërkuar ndihmë nga policia, dhe akoma më e vogël nga një spital/mjek (6%) dhe shërbimet sociale (6%). Konsulentët ligjorë (5%), zyrtarët e pushtetit vendor (3%), organizatat/strehat për gratë (4%) dhe përfaqësuesit e besimit fetar (3%) ishin institucionet dhe strukturat më pak të mundshme për të kërkuar ndihmë. Tek alternativa “tjetër” janë përmendur kryesisht familjarët – babai dhe nëna – ose shokët. Ajo çfarë vihet re është tendenca e ulët për të kërkuar ndihmë tek institucionet përgjegjëse. Veçanërisht në zonat rurale, përqindja është akoma më e ulët (me rreth

4% më pak për: spitalin shërbimet sociale, konsulentin ligjor dhe drejtuesit e pushtetit vendor). Pjesëmarrësit/et e fokus grupeve kanë thënë arsye të ndryshme për të mos iu drejtuar institucioneve për mbrojtje, ndër të cilat një faktor i rëndësishëm ishte dhe pandëshkueshmëria e abuzuesit dhe mungesa e mbështetjes për viktimën:


“Mungesa e mjaftueshme e ndëshkueshmërisë për personat që shkaktojnë dhunë. Atje [në një vend tjetër jashtë Shqipërisë] në momentin që do e denonconte penalizimet janë aq të forta sa që po të mendonte që ta ngrinte dorën për herë të dytë, prishej kredia e shtëpisë, puna etj. këtu nuk është e njëjta gjë..me një urdhër mbrojtjeje. Nëse ata nuk kanë

një ndëshkim të fortë, nuk e mendojnë shumë. Gjëja tjetër është mbështetja për viktimën: shërbimet, përkujdesi, transporti janë shumë lehtësuese. Këtu tek ne logohen nga dhuna dhe s'kanë ku mbështeten" (DFG me OSHC)

Arsyeja më e shpeshtë për të kërkuar ndihmë ishte ngaqë nuk duronin dot më (47%), ose ngaqë ishin të nxitura nga miqtë/familja (22%) apo ngaqë kishin pësuar lëndime të rënda dhe kishin frikë se partneri/ja do i vriste (18%, me 7% më

shumë vajzat). Edhe pse me përqindje më të ulëta, kishte raste që u raportua se kishin frikë se partneri/ja i kishte kërcënuar ose u përpoq që t'i vriste (12%), apo ka kërcënuar fëmijët (6%). Përqindja e refuzimit në këtë pyetje është e lartë (20%), diçka që tregon se këto çështje vazhdojnë të jenë të ndjeshme për njerëzit që i kanë kaluar (Figura 4.3.9). Përgjigjedhënëset/it nga zonat rurale raportuan më shpesh se nuk duronin dot më, kishin lëndime të rënda, abuzuesi kërcënoi t'i vriste dhe se i përzunë nga shtëpia (ndryshimet ishin nga 4% deri në 10%)

Figura 4.3.9. Arsyet për të kërkuar ndihmë
Cilat janë arsyet që ju kanë shtyrë të kërkonit ndihmë?




Përgjigjedhënësit/et që nuk kishin kërkuar ndihmë kryesisht u përballën vetë me situatën (29%) dhe për arsye të tjera (19%) si p.sh. fakti se dhuna ishte në nivele të vogla, nuk ishte shqetësuese, por edhe ngaqë nuk kishin besim tek policia. Gjithashtu, disa prej tyre kishin frikë nga pasojat (12%), turp/druajtje (11%), ose gjykonin se dhuna ishte e papërfillshme (10%), nga frika se nuk do i ndihmonin (10%) dhe nga frika se mos prishnin reputacionin e familjes (10%). “Kisha frikë nga pasojat”, “kisha turp” “frikë se do prishja reputacionin e familjes” ishin alternativat që janë përmendur më shumë nga vajzat (me 10% diferencë nga djemtë) ndërsa djemtë kanë thënë më shumë “dhuna ishte e papërfillshme” me 6% diferencë (Figura 4.3.10). Megjithatë, edhe

djemtë shpesh mund të ndihen në siklet ose të kenë turp që të kërkojnë ndihmë për diçka të tillë, siç shpjegohet dhe më poshtë. Pjesëmarrësit/et në fokus grupet kanë konfirmuar këto gjetje, dhe kanë dhënë shpjegime, siç është dhe përgjigja në vijim:

“Në zonat rurale nëqoftëse një femër dhunohet nuk e merr mundimin që të shkojë deri në qytet sepse janë të tjera kushte etj. atje [në zona rurale] rregulli është se po e mori vesh fisi, lagja e marrin vesh të gjithë...kështu që ato zbatojnë më shumë urdhra dhe qëndrojnë heshtur”. (DFG me të rinj)

Figura 4.3.10. Arsyet për të mos kërkuar ndihmë

Për cilat arsye nuk kërkuat ndihmë?



2 në 3 përgjigjedhënës/e mendojnë se arsyet kryesore për dhunën seksuale mes partnerëve janë abuzimi me drogat/alkoolin, 42% nga problemet e shëndetit mendor, 41% nga gjendja ekonomike e gruas/partnerit të abuzuar, 37% nga normat shoqërore për statusin e burrave dhe grave në shoqëri. Këtu nuk mungojnë dhe arsye si: konflikte mes partnerëve (29%), fakti se brenda marrëdhënieve intime nuk konsiderohet si dhunë (28%) dhe niveli arsimor i ulët (27%) (Figura 4.3.11). Ndryshimet gjinore ishin të qarta tek alternativat: “moskonsiderimi si dhunë nëse ndodh brenda çiftit” me 10% më shumë vajza dhe “mungesa e sanksioneve ndaj abuzuesit” me 6% më shumë vajza. Përgjigjedhësit e zonave rurale duke u krahasuar me ata të zonave urbane besonin më shumë se arsyeja ishte “gjendja ekonomike e gruas/partnerit të abuzuar” (7% diferencë). Disa nga këto gjetje janë në një linjë me ato të vendeve të tjera, sipas raportit të OBSH – së (2017) sipas të


cilit disa nga faktorët që lidhen me dhunën seksuale përfshijnë krahas të tjerëve: besime për nderin e familjes dhe për pastërtinë seksuale, qëndrime “pronësie” ndaj grave dhe sanksionet e dobëta ndaj dhunës seksuale.

Gjithashtu, për djemtë e rinj është akoma më e vështirë për të kërkuar ndihmë, siç u vu re dhe nga fokus grupet:

“Nga djemtë është më e vështirë, për faktin se përgjithësisht janë në mbrojtje të grave dhe vajzave, nuk është se ka ndonjë organizatë që merret me mbrojtjen e burrave dhe djemve. Nga ana tjetër, është edhe egoja e meshkujve. Ndikon edhe kjo! Bëhet edhe më e vështirë brenda familjes”, vajzë, zonë rurale

Figura 4.3.11. Qëndrimet mbi shkaqet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime

Sipas mendimit tuaj, cilat janë 3 arsyet kryesore të dhunës seksuale midis partnerëve?




Qëndrimet e përgjigjedhënësve/eve për rastet kur mund të justifikohet dhuna seksuale kundër dëshirës së viktimës janë mjaft tolerante. Për shembull, 23% kur është paraprirë nga flirtimi dhe po 23% kur nuk është thënë shprehimisht “jo”, 22% kur personi i abuzuar ka veshur një veshje provokuese, 21% e tyre kanë thënë se justifikohet kur ajo ndodh mes partnerëve në një marrëdhënie intime, 18% kur personi i abuzuar është dehur apo ka marrë drogë, 16% kur personi i abuzuar e ka ftuar dikë në shtëpi dhe po 16% kur personi abuzues ka qenë i dehur apo nën efektin e substancave narkotike, 14% kur e/i abuzuara/i ka disa partner seksualë dhe 12% kur ishte duke ecur vetëm natën (Figura 4.3.12). Nga përgjigjet duket se ende vazhdojnë të ekzistojnë paragjykime që justifikojnë dhunën seksuale në disa

rrethana specifike. Në këtë pyetje nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm mes përgjigjedhënësve/eve nga zonat urbane dhe rurale. Nga ana tjetër, djemtë duket se kanë qëndrime më paragjyquese dhe justifikuese për dhunën seksuale në të gjitha rrethanat e përmendura në pyetje me ndryshime që shkojnë deri në 13% më shumë. Gjithashtu, ata/o me nivel arsimor të ulët kanë shprehur më shpesh se janë dakord me këto justifikime. Këto gjetje janë në përputhje me të dhënat e studimit të OBSH - së (2017), sipas të cilave faktorët më të shpeshtë që çojnë në dhunën në marrëdhëniet intime janë mosmarrëveshjet në martesë/marrëdhënie dhe pakënaqësi, vështirësitë për të komunikuar mes partnerëve dhe sjelljet e kontrollit të burrave ndaj grave.

Figura 4.3.12. Qëndrimet mbi tolerancën ndaj dhunës seksuale

A jeni dakord se marrëdhëniet seksuale kundër dëshirës mund të justifikohen në rrethanat në vijim?



Siç është përshkruar dhe në rishikimin e literaturës, një nga gjërat më të vështira

për të kuptuar qartë është dhuna seksuale në marrëdhëniet intime, madje dhe mes

autorëve që studiojnë fenomenin. Kjo u vërtetua nga gjetjet dhe nga fokus grupet që u realizuan.

“Një arsye tjetër është mosperceptimi i dhunës seksuale si dhunë e tillë. Ata nuk e perceptojnë se janë duke kryer një vepër të tillë. Dhunë seksuale në përgjithësi ndodh jo vetëm nëpërmjet çifteve, por midis të panjohurve që duan të marrin atë që dëshirojnë pa e pasur partneren e tyre.” (DFG me të rinj)

“[për dhunën seksuale në marrëdhënie intime] ekziston dhe rëndom në fakt, shpeshherë merret si diçka normale nga partneri tjetër, por ndodh edhe nuk është se raportohen gjithmonë...se e marrin si një gjë normale. Por tek shumica e femrave në Shqipëri ndodh...dhuna seksuale merret më shumë e mirëqenë... edhe pse femrat nuk e dëshirojnë në atë moment, detyrohen nga mashkulli që ta kryejnë.” (DFG me të rinj)

4.4. Dhuna virtuale – pornografia dhe dhuna seksuale e lehtësuar nga teknologjia

Vitet dhe dekadat e fundit kanë dëshmuar një rritje galopante të përdorimit të internetit, teknologjisë dhe komunikimit virtual. Një pjesë e jetëve tona (apo një pjesa dominuese e tyre gjatë pandemisë) kanë kaluar në planin virtual, dhe këtij trendi nuk i ka shpëtuar as dhuna me bazë gjinore dhe ajo në marrëdhëniet intime. Krimi kibernetik në përgjithësi ka pësuar një rritje të madhe, veçanërisht me pandeminë, ku në vitin 2020 u regjistruan 240 denoncime, të cilat duhet t'i ndiqeshin nga vetëm 5 hetues të krimit kibernetik në vend¹. Rastet e denoncimeve të

shantazhimit të vazhdueshëm dhe dhunës të mundësuar përmes shantazheve ku instrumentalizohen imazhe, video dhe/ose biseda me karakter seksual/nuditetin kanë ardhur duke u shtuar gjithashtu – në media, polici apo organizatat e shoqërisë civile. Në këtë kontekst, ky seksion i dedikohet eksplorimit të eksperiencave dhe qëndrimeve të të rinjve/të rejave në raport me pornografinë dhe pornon hakmarrëse.

Në përgjithësi, duket se pranohet që pornografia është e përhapur (mjaft e përhapur 47% apo disi e përhapur 31%) midis të rinjve dhe të rejave të grup-moshës 20-24 vjeç. Megjithatë ngjashëm edhe me raportimin në nivel individual/familjar të problematikave të tjera të trajtuara në seksionet e mësipërme, përhapja e pornografisë tek bashkëmoshatarët është e raportuar në nivele më të larta se në planin individual (vetëm 25% e të pyeturve pranojnë se shohin porno të paktën disa herën në muaj, siç tregohen në krahun e djathtë të figurës 4.4.1.).

Këtu, më shumë djem (55% e tyre) sesa vajza (40.3% e tyre) mendojnë se pornografia është mjaft e përhapur ndër bashkëmoshatarë. Gjithashtu, i këtij mendimi janë më shumë përgjigjedhësit e zonave urbane dhe atyre me arsim të ulët, por është e vështirë të thuhet nëse kjo tregon shkallën më të lartë të incidencës në këto kategori apo një mendje më të hapur për të pranuar/raportuar atë. Ky trend ruhet në raportimin e nivelit individual. Diferenca më e ndjeshme është ajo midis vajzave dhe djemve që raportojnë se nuk shohin kurrë porno. Rreth 59% e përgjigjedhëseve vajzave deklarojnë se nuk shohin kurrë porno kundrejt vetëm 16% të përgjigjedhësve djem.



1 Policia e Shtetit Shqiptar, të dhëna të komunikuar në media Top Channel, dt. 7 shkurt 2021.

Figura 4.4.1. Përhapja e pornografisë: raportimet mbi perceptimet mbi bashkëmoshatarët vs. përkundrejt personalisht
Sipas mendimit tuaj, sa e përhapur është pornografia mes moshatarëve tuaj? **Sa shpesh shihni porno?**





Figura 4.4.2. “Konsumi” i pornografisë dhe gjinia
Sa shpesh shihni porno sipas gjinisë




Mesatarisht, të pyeturit deklarojnë se kanë parë për herë të parë porno rreth moshës 15 vjeç. Rreth 26% e tyre e kanë bërë këtë në një moshë 13 vjeç apo më të vogël dhe 10% në një moshë 18+ vjeç. Të pyetur se si e vlerësonin në një shkallë nga 1 (aspak) në 10 (totalisht) duhet që ajo që tregohet në filma pornografike t'i ngjajë marrëdhënieve seksuale në realitet, vlerësimi mesatar

është 3.5 dhe mediana 3, por përgjigjja më e shpeshtë (moda) është 1 (aspak). Ndërsa për ndikimin që shikimi i tyre mund të sjellë në perceptimet dhe qëndrimet ndaj seksi vlerësimi mesatar në një shkallë të njëjtë matje është 5.4 dhe mediana 5, por përgjigjja më e shpeshtë është sërish në 1 (aspak), gjë që tregon për ndërgjegjësimin e ulët mbi impaktin e pornografisë.

Figura 4.4.3. Bërja/marrja e imazheve nudo/me përmbajtje seksuale nga persona të njohur

A i keni bërë dikujt apo marrë ndonjëherë ndonjë foto nudo apo ndonjë imazh ose video me përmbajtje të qartë seksuale të një personi që njihni (PA përfshirë veten tuaj)?



Përtej këtyre, vetëm 16% e të pyeturve (ose 24% e djemve dhe 9% e vajzave) pranojnë se kanë bërë apo marrë foto nudo apo ndonjë imazh ose video me përmbajtje të qartë seksuale të një personi që njihin, përkundrajt 80% që e mohojnë një gjë të tillë.

“Vajzat nuk e pranojnë që humbin virgjërinë. Është tabu. Është e vështirë ta pranojnë që kalojnë kohën duke parë video porno. Kështu që si për shumë vajza bëhet model Kim Kardashian, ndoshta për shumë djem bëhet partnerja në filmat porno. Kjo është krizë...një vajzë që pranon të bëjë çdo gjë për ta kënaqur partnerin... Është më e lehtë për të folur në vetën e tretë...” (DFG me OSHC)

Nga ata që kanë poseduar materiale të tilla, vetëm pak më shumë se gjysma (54%) i kanë mbajtur ato vetëm për vete. Pjesa tjetër ia kanë dërguar dikujt (që kanë pasur interes/lidhje seksuale, apo postuar ato online) apo refuzojnë të tregojnë se çfarë kanë bërë me to (23%).


Ndërgjegjësimi se postimi i materialeve të tilla online mund t'u bëjë keq personave të përfshirë (58%) apo ndonjë shoku/shoqeje (33%) do ishin arsyt kryesore që do i frenonin ta bënin një gjë të tillë. E treta në listën e faktorëve frenues është frika se mund të zbulohen/kapen dhe arrestohen/ndiqen penalisht (24%). Shpesh këto trajta të dhunës janë të lidhura me bullizmin që

ndodh paralelisht edhe në trajta të tjera.

“Unë di një rast që përdorën fotot personale të vajzës dhe hapën llogari me fotot e saj. Më kërkuan ta bëj ‘report’. Vajzat ndjehen shumë të stepura dhe shumë keq kur gjenden në atë situatë, sidomos para familjes. Duhet shumë mbështetja e familjes dhe shoqërisë. Lidhet shumë me bullizmin sidomos tek adoleshentët. Me vonë arrihet një lloj pjekurie dhe fokusohen më shumë tek e ardhja dhe jo aq shumë tek elemente të tillë.” (DFG me të rinj)

Figura 4.4.4. Faktorët që do pengonin postimin online të imazheve ose videove me përmbajtje seksuale

Nëse do të merrnit një foto nudo apo një imazh ose video seksuale nesër, cilat nga sa vijon do t'ju shtynin të MOS e postonit atë online?



Nivelet e raportimit të realizimit të fotove/videove me përmbajtje të qartë seksuale të vetes janë në nivele të ngjashme me ato të bërjes/marrjes nga të njohur. Rreth


17% e të pyeturve raportojnë se iu ka ndodhur të bëjnë foto nudo apo foto/video me përmbajtje seksuale ku kanë qenë të përfshirë ata vetë, me diferenca pak më të

ngushta midis vajzave (14%) dhe djemve (22%) që pranojnë se kanë bërë diçka të tillë. Ndërsa ndryshimet midis zonave

urbane dhe rurale apo niveleve arsimore ishin të papërfillshme.

Figura 4.4.5. Foto/video nudo apo me përmbajtje seksuale të vetes

A i keni bërë ndonjëherë vetes suaj foto nudo apo imazhe ose video me përmbajtje të qartë seksuale?



Imazhe të fotove nudo apo videove me përmbajtje seksuale rezultojnë të jenë qarkulluar në shumicën e rasteve. Vetëm 42% e atyre që kanë realizuar foto/video të tilla të vetes i kanë mbajtur ato vetëm për vete, ndërsa 58% ia kanë dërguar ato dikujt me të cilin kanë qenë të përfshirë në një marrëdhënie seksuale/romantike (30%) apo dikujt tjetër (24%) apo kanë bërë diçka tjetër që refuzojnë ta ndajnë (28%).

Eksperiencat e drejtpërdrejta si dhe ndërgjegjësimi mbi pasojat që mund të sjellë shpërndarja e këtyre imazheve për personat e përfshirë mund të jenë arsye kryesore që bëjnë që mëse 78%

e të pyeturve të kërkojnë që personat që postojnë imazhe dhe/ose video pa dëshirën e personave të përfshirë duhet të ndiqen penalisht dhe dënohen me burg përkundrejt vetëm 2% që mendojnë se nuk duhet të kenë asnjë pasojë. Në mënyrë të ngjashme, 67% mendojnë se ndjekja penale duhet të jetë një pasojë me të cilën duhet të përballen edhe faqet në internet që lejojnë që një gjë e tillë të ndodhë. 52% mendojnë se ato duhet të përballen me kosto financiare (gjoba) dhe vetëm 3% nuk shohin arsye që ato të përballen me ndonjë pasojë për mundësimin e postimit/shpërndarjes së këtyre imazheve.

Figura 4.4.6. Trajtimi i fotove/videove nudo apo me përmbajtje seksuale të vetes
Çfarë keni bërë me këto imazhe ose video?




Figura 4.4.7. Pasoja me të cilat duhet të përballen ata/o që postojnë foto & video pa pëlqimin e personave të përfshirë si dhe faqet në internet që e lejojnë këtë
A mendoni se personat që postojnë imazhe dhe/ose video pa dëshirën e personave të përfshirë duhet të përballen me pasoja? Nëse po, me çfarë pasojash?




Figura 4.4.7. Pasoja me të cilat duhet të përballen ata/o që postojnë foto & video pa pëlqimin e personave të përfshirë si dhe faqet në internet që e lejojnë këtë

A mendoni se faqja e internetit/media sociale që lejojnë postime të tilla duhet të përballen me pasoja? Nëse po, me çfarë pasojash?





Figura 4.4.8. Platformat më të përdorura nga shantazhuesit/et

Cilën platformë ka përdorur shantazhuesi/ja juaj?




Gati një në 10 nga përgjigjedhënesit në këtë studim raportojnë të kenë qenë të paktën një herë pre e shantazhit ku janë përdorur foto/video apo materiale të tjera me përmbajtje seksuale. Rreth 12% e vajzave dhe gati 5% e djemve e kanë pasur një eksperiencë të tillë. Instagrami është aplikacioni që përmendet më shpesh si platforma kryesore e përdorur nga shantazhuesit (44%), i ndjekur nga Facebook/Messenger (26%). Nën kategorinë

të tjera janë renditur edhe përdorimi i telefonatave apo komunikime me mesazhe.

Ndërkohë forma më dominuese e vënies në kontakt me shantazhuesit është përmes profileve të rreme (41%). Në 39% të rasteve shantazhuesi ka qenë një i/e njohur. Në 69% të të gjitha rasteve të raportuara, shantazhuesi ka qenë mashkull, në 17% femër dhe në gati 14% të rasteve ka qenë e panjohur gjinia e shantazhuesit/es.

Figura 4.4.9. Lidhja me shantazhuesi/en
Si jeni kontaktuar nga shantazhuesi/ja?



Kryesisht imazhet (me 59%) dhe bisedat seksuale (33%) dominojnë ndër materialet intime që iu janë vjedhura apo janë keqpërdorur nga shantazhuesit. Në 39% të rasteve shantazhuesi ka pasur për qëllim arritje e realizimit të aktiviteteve seksuale të mëtejshme (p.sh. pas refuzimit, ndarjes etj.). Rreth 29% të rasteve shantazhimi ka pasur qëllim përdorimin e materialeve me përmbajtje seksuale për të kërcënuar e mbajtur nën kontroll viktimën. Eksperiencat e shantazhimit kanë zgjatur zakonisht deri në 3 muaj (71%), por nuk janë të pakta rastet kur shantazhimi ka zgjatur thujse një vit (8%) apo edhe më shumë (3%).


Efektet e situatave ku përgjigjedhënesit kanë qenë të shantazhuar kanë ndikuar ndjeshëm në jetën e subjekteve të shantazhit. Në një shkallë nga 1 në 10 (ku 1 është niveli më i ulët), në 22.5% të rasteve niveli me i lartë (10) është zgjedhur për të vlerësuar efektin që eksperiencat e shantazhimit kanë pasur në jetët e atyre që janë shantazhuar. Pavarësisht kësaj, shantazhimi është raportuar vetëm në 32% të rasteve. Vajzat (në 37% të rasteve) më shumë se djemtë (9% e tyre) që kanë pasur eksperiencat të tilla kanë ndjerë nevojën dhe e kanë realizuar raportimin e shantazhit. Po kështu, interesante është se shantazhi është

raportuar më shumë nga përgjigjedhënës të zonave rurale (35%) sesa zonat urbane (26%). Raportimi është realizuar në


platformat në të cilat ka ndodhur/është zhvilluar shantazhi (32%) dhe në polici (29%).

Figura 4.4.10. Format dhe qëllimet e shantazhit

Çfarë lloj materialesh intime ju janë vjedhur apo çfarë lloj veprimesh intime ju janë kërkuar me anë të shantazhit?



Në ç'mënyrë është kryer shantazhi?



Në përpjekjet e tyre për raportimin/adresimin e situatës së shantazhit 37% janë drejtuar/kanë gjetur mbështetje tek familja dhe miqtë dhe 24% kanë marrë këshillim profesional. Kryesisht të rejat dominojnë në këto zgjedhje. Të rinjtë që kanë qenë përfshirë në situata të tilla raportojnë të kenë kërkuar/gjetur forma “të tjera” të mbështetjes.

Është interesante se ndonëse organizatat e ndryshme raportohen vetëm në 7% të rasteve, ato janë zgjedhur kryesisht nga përgjigjedhënësit në zona rurale. Nga diskutimet në DFG kuptohet se kjo mund të jetë rezultat i njohurive/mbështetjes së ulët nga familja/miqtë në këto zona, apo nga shtrirja më e dobët e shërbimeve dhe mosbesimi më i lartë ndaj tyre në këto zona siç u pa edhe më herët.

Figura 4.4.11. Raportimi i shantazhit
Nëse po, ku?





Figura 4.4.12. Burimet e mbështetjes në përballimin e situatave të shantazhit
A kishit apo a gjetët ndonjë mbështetje/përfaqësim ligjor pas përvojës suaj?



“Mendoj se ka rënë besimi në institucione, ndaj policisë, dhe mendojnë se janë më komfort, gjejnë më shumë mbështetje tek organizatat” (DFG me të rinj)

“[tek organizatat] ruhet konfidencialiteti, ofrohet këshillim. Komisarati është më i ftohtë.” (FG me të rinj)

4.5. Krizat shoqërore dhe dhuna: rasti i pandemisë Covid19

Studimet të ndryshme kanë dokumentuar ndikimet e dëmshme që krizat dhe katastrofat e ndryshme sjellin në marrëdhëniet shoqërore në të gjithë kontekste (Le Masson, 2016)², megjithatë, është kombinimi i pasojave të këtyre krizave me dështimet në sistemin e mbrojtjes shoqërore (shpesh edhe totalisht të munguar) që çojnë në përkeqësimin e pabarazive gjinore, përfshi problematikat e dhunës me bazë gjinore (f.3). Ky studim u realizua gjatë vitin 2020, i cili u dominua nga zhvillimet e një pandemie globale me efekte lokale të qenësishme për jetën e të rinjve, ashtu di edhe të grup-moshave të tjera, si në sferën publike dhe atë private. Në këtë kontekst, në seksionin e fundit të gjetjeve të këtij studimi ndalemi në eksplorimin



e perceptimeve mbi efektet e krizës së shkaktuar nga Covid19 në raport me dhunën në përgjithësi dhe asaj me bazë gjinore në veçanti.

Rreth 62% e përgjigjedhënësve besojnë se krizat si p.sh. ajo e krijuar nga pandemia e Covid19 ndikojnë në nivelin e dhunës në shoqëri. Shumica vlerësojnë se krizat shoqërore çojnë në rritjen e dhunës në përgjithësi (83%) dhe gjysma e përgjigjedhënësve shohin si rrezik shtimin e dhunës vetëm brenda familjes. Ndonëse me diferenca të vogla, vajzat më shumë se djemtë, zonat rurale më shumë sesa ato urbane dhe ata me arsim të lartë dominojnë ndër ata që mendojnë se krizat shoqërore ndikojnë në rritjen e dhunës.

Figura 4.5.1. Efektet e krizave shoqërore në nivelin e dhunës

A mendoni se krizat shoqërore, si për shembull pandemia e Covid-19, ndikojnë në nivelin e dhunës, në një shoqëri?

Nëse po, mendoni se krizat shoqërore kanë më shumë gjasë të çojnë në



• • •

2 Shiko për një përmbledhje Virginia Le Masson, Sheri Lim, Mirianna Budimir, Jasna Selih Podboj (2016) Disasters and violence against women and girls Can disasters shake social norms and power relations?, Overseas Development Institute

Në fokusgrupet e organizuara si me të rinj dhe të reja ashtu edhe me përfaqësues të SHC u konfirmuan gjetjet mbi perceptimin për një nivel të shtuar të dhunës. Ngjashëm me 28% të të rinjve dhe të rejave të pyetur përmes pyetësorit, edhe diskutimet në DFG konfirmuan për një ulje të nivelit të raportimit, ndonëse incidenca/egërsia e dhunës ishin shtuar. Frika nga Covid19, kufizimet e vendosura, tkurrja dhe/ose mbingarkesa e shërbimeve ishin ndër arsye që kishin penguar/stepur raportimin e dhunës.

“Mendoj se dhuna ka qenë më e madhe dhe më e shfaqur. Problemet ekonomike dhe mbyllja për një periudhë të gjatë e kanë bërë më të madhe dhunën.” (DFG me të rinj)

“Unë mendoj se fokusi tek si të mbrohemi nga Covid i ka bërë më të shushatur dhe hamendësoj se ka rënë dhuna. Por kjo


nuk është e vërtetë.” (DFG me të rinj)

“Gjatë pandemisë ka pasur një bum telefonatash nga vajza dhe gra nga e gjithë Shqipëria. Jemi munduar që t'i adresojnë. Duke qenë se ne u kushtojmë shumë rëndësi postimeve hashtags etj., shumë gra nuk janë ndalur për të menduar a jemi në Shkodër apo jo? Kanë ardhur nga e gjithë Shqipëria.” (DFG me OSHC)

Në disa raste, ka qenë edhe informacioni i munguar ose i pasaktë që ka vepruar si një barrierë shtesë në raportimin dhe adresimin e çështjeve të dhunës gjatë pandemisë. Shembulli i mëposhtëm ilustron se informacioni mbi veprimtarinë e gjykatave në raport me lëshimin e urdhrave të mbrojtjes ka qenë i pasaktë edhe ndër përfaqësues të OSHC-ve që operojnë në fushë.

Figura 4.5.2. Ndikimi i mbylljes dhe situatës së pandemisë në nivelin e dhunës së familje, marrëdhëniet në çift, komunitet

Sipas perceptimit dhe eksperiencës suaj që nga muaji mars 2020 e në vijim, si ka ndikuar mbyllja dhe në përgjithësi kriza e pandemisë së Covid-19 në situatën e dhunës në:



“Nuk e kanë denoncuar shumë, sepse kishin frikën e ekonomisë. Për shkak të pasigurisë...më shumë kanë kërkuar se si ta menaxhojnë marrëdhënien. Kanë marrë këshillim ligjor, merrnin informacion, por nuk po e bënin denoncimin, sepse edhe gjykata ishte e mbyllur”. (DFG me OSHC)

Ngjashëm me raportimin e dhunës, siç u analizua më herët në këtë raport, edhe në raport me efektet e pandemisë, përgjigjedhënesit raportojnë një situatë të rënduar (përkeqësuar shumë) të dhunë në komunitetin e tyre (11%) dhe lagjen e tyre (10%) sesa në familjen e tyre (5%) apo në marrëdhënien e tyre në çift (5%). Ndryshimet midis të rinjve dhe të rejave, apo në raport me zonën dhe nivelin e edukimit nuk ishin për t'u nënvijëzuar.

5. Përfundime

Studimi është realizuar në nivel kombëtar, me 1095 përgjigjedhënës. Shumica prej tyre ishin vajza të reja, dhe banonin në zona urbane. Thuajse gjysma e përgjigjedhësve ishin me arsim të lartë dhe 1 në 3 prej tyre ishin të punësuar, por gjithsesi të ardhurat e tyre personale ishin të ulëta. Ata/o ishin të larmishëm/me për nga gjendja e tyre civile: beqar/e, të martuar, në marrëdhënie me ose pa bashkëjetesë etj. Prej atyre që kishin fëmijë, shumica ishin vajza, diçka që tregon se vajzat mund të marrohen ende më herët se djemtë dhe të kenë fëmijë, para moshës 24 – vjeçare.

Konsumimi i alkoolit dhe i substancave narkotike ishte në nivele më të larta tek të rinjtë, sesa tek të rejat, diçka që konfirmon sërish normat e shoqërisë që pranojnë ose nxisin konsumimin e alkoolit nga djemtë dhe të kundërtën për vajzat dhe gratë. Studime të tjera kanë treguar se burrat alkoolistë kanë nivele më të larta të dhunës në marrëdhëniet intime se sa ata jo – alkoolistë (Chermack, Fuller, & Blow, 2000) dhe konsumimi i madh i alkoolit në fillimet e një martesë është një parashikues i fortë për DhMI.

Ndonëse u vu re një lloj largimi nga qëndrimet stereotipike për burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë, kjo është më e hasur mes vajzave, mes të rinjve më të arsimuar dhe ata të zonave më të urbanizuara. Hendeku në qëndrime bëhej më i madh në sferën privaten dhe raportet ndërpersonale. Diferencat e mëdha veçanërisht tek pritshmëritë e ndryshme mbi rolet e burrave dhe grave në martesë dhe familje mund të çojnë drejt supozimit se çiftet/familjet e krijuara mes të rinjve me këto ndryshime në qëndrime kanë gjasa për tensione në ndarjen e roleve dhe menaxhimin e tensioneve që krijohen në përpjekjet për

të kombinuar jetën në familje me atë në tregun e punës (Knight dhe Brinton, 2017).

Ndonëse në përgjithësi u evidentua një sens komuniteti që persiston, ai vjen dhe zbehet nga konstatimi tek reagimi ndaj problemeve të dhunës, veçanërisht kur vjen puna tek ndërmarrja e iniciativës për të ndërhyrë apo bërë diçka nëse dikush në komunitet do të përfshihej në një situatë dhune në familje.

Kërcënimet me të shpeshta të lidhura me dhunën raportoheshin të vinin nga të panjohur dhe ish-partnerët dhe ato ishin më eminent për vajzat. Vajzat dominojnë ndër ata që janë ndier vazhdimisht apo shpesh herë të kërcënuar në të gjitha skenarët përveç alternativa ku përgjigjedhësit janë ndier të kërcënuar nga një i/e afërm/e apo anëtar/e i/e familjes, përveç partnerit/es dhe nga policia. Mentaliteti i superioritetit mashkullor në vendimmarrje në marrëdhëniet intime duket se persiston edhe tek të rinjtë që e gjejnë të vështirë të pranojnë iniciativën dhe vendimmarrjen e pavarur të (ish)partnereve/ëve të tyre.

Rreziku i perceptuar i ndikon dhe kufizon më shumë vajzat edhe në të përditshmen e tyre, duke i bërë ato të jenë të mbipërfaqësuar ndër ata që kanë ndryshuar sjellje për të parandaluar/shmangur sulme apo ngacmime seksuale dhe/ose fizike.

Ndërgjegjësimi për problematikat dhe incidencën e DHBGJ është në nivele relativisht të larta, por sërish vajzat dhe zonat urbane duket se janë ato që janë targetuar nga fushata dhe nisma të ndryshme ndërgjegjësuese, e për pasojë kanë fituar një nivel më të lartë

ndërgjegjësimi mbi këtë problematikë, si dhe qasjet për parandalimin/adresimin e saj. E pavarësisht kësaj, edhe midis të rinjve e të rejave në këtë studim identifikimi dhe raportimi i DHBGJ dhe DHMI duket se vazhdohet të shihen e raportohen më shumë si “problemi i të tjerëve” duke reflektuar një lloj rezistence për të pranuar se dhuna ndodh edhe në rrethin tonë shoqëror dhe familjar – kjo, ndër të tjera, edhe si pasojë e fenomenit të fajësimit të viktimave, që duket se mbetet ende problematik në raport me DHBGJ në përgjithësi.

Pengesë në raport me identifikimin/ raportimin e dhunës me bazë gjinore është edhe niveli i informimit jo vetëm në raport me njohuritë për ta njohur dhe kategorizuar atë, por edhe për mënyrën sesi mund ta raportojnë dhe kërkojnë ndihmë për ta adresuar. Familja mbetet “streha” e parë për të kërkuar ndihmë si kur të rejtat/të rinjtë ndihen të kërcënuar ashtu edhe kur janë të përfshirë në situata të DHMI, më pas, me peshë të ngjashme vinin miqtë dhe organizatat e shoqërisë civile.

Stöckl e të tjerë (2014), në analizën e tyre të DhMI mes adoleshenteve dhe vajzave të reja të moshave 15 deri 24 vjeç në nëntë vende, gjetën se ka një prevalencë të DhMI që varionte nga 19% deri në 66%. Në këtë studim 1 në 10 vajza (10%) është detyruar që të kryejë marrëdhënie seksuale për herë të parë kundër dëshirës së saj dhe në përqindje më të lartë ka qenë kryerja e marrëdhënieve seksuale me forcë në vazhdim, sidomos kur ishte fjala për ish – partnerët/et. Duke qenë se në marrëdhëniet e hershme nuk është e lehtë të gjykohet saktë për atë se çfarë është dhuna seksuale në marrëdhëniet intime, këto përqindje mund të jenë më të larta. Siç u konkludua dhe në studimin e Wilson dhe Miller (2016) 60% e vajzave të reja viktima të dhunës seksuale (jo medoemos nga një partner intim) nuk e quanin përvojën e tyre përdhunim dhe nuk mendonin se ishin viktima të dhunës seksuale dhe

përdornin më shumë emërtime si “seks i keq” ose “keqkomunikim” për të përshkruar përvojat e tyre. Për shembull, edhe në këtë studim u gjet se kryerja e marrëdhënieve seksuale nga frika e partnerit dhe ish – partnerit ishte në nivele të larta, diçka që jo medoemos konsiderohet si dhunë seksuale nga vajzat.

Gjithashtu, ka ende një paqartësi për përkufizimin dhe përcaktimin e qartë të dhunës seksuale, sidomos në marrëdhëniet intime, të cilat perceptohen si pjesë e jetës private, ku të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë. TV, mediat sociale dhe rrjetet sociale ishin burimet më të shpeshta të informacionit për dhunën ndaj vajzave dhe grave në këtë studim, ku të rinjtë/rejat ekspozohen ndaj rasteve të tilla. Ndryshe ishte ekspozimi në lagjen apo qytetin/fshatin e jetesës, ku të dëgjuarit/parit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet intime ishte në nivele më të ulëta.

Në studimin e Sweahn dhe Saltzman (2007) si dhe në të tjera të ngjashme, u konstatua se DhMI mes adoleshentëve mund të jetë më reciproke në natyrë, çka do të thotë se të dyja gjinitë mund të jenë abuzues dhe të abuzuar. Në këtë studim, të rinjtë kishte më shumë gjasa që të kishin përjetuar një dhunë fizike të formave më të rënda gjatë jetës së tyre. Nga ana tjetër, të rejtat kishin përjetuar më shumë dhunë dhe ngacmime seksuale, si në marrëdhëniet e tyre intime ashtu dhe nga njerëz të tjerë, si familjarë, shokë/qe, apo dhe njerëz të panjohur.

Përqindja e të rinjve dhe të rejave që nuk kanë kërkuar ndihmë edhe pse kanë përjetuar dhunë ishte shumë e lartë edhe në këtë studim. Mungesa e besimit tek institucionet e ndryshme (policia dhe shërbime të tjera), ndjenja e turpfit dhe e druajtjes, dhe frika nga prishja e reputacionit të familjes janë tek arsyt kryesore për të mos kërkuar ndihmë. Këto gjetje janë në përputhje me studimin e mëparshëm të AWEN (2018) si dhe me studime të tjera në këtë fushë (IDRA dhe UN Women, 2018). Siç duket, ka ende shumë

për të bërë për të krijuar besim tek viktimat e dhunës seksuale dhe fizike, por edhe për të larguar tabu – të në lidhje me këtë fenomen.

Shkaqet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime ishin përdorimi i alkoolit ose substancave narkotike, normat shoqërore patriarkale, gjendja ekonomike e viktimës si dhe konfliktet mes partnerëve. Të rinjtë e studimit shfaqën qëndrime më tolerante dhe stereotipizuese që justifikojnë dhunën seksuale në disa rrethana, si p.sh. kur është paraprirë nga flirtimi, kur nuk është thënë shprehimisht “jo”, kur personi i abuzuar ka një veshje provokuese etj. Nga ana tjetër, janë po këto norma shoqërore që i bëjnë të rinjtë e abuzuar të mos kërkojnë ndihmë, pasi supozohet se ata duhet të jenë të fortë vetë për t’u mbrojtur.

Përdorimi i metodave kontraceptive vazhdon të jetë në një shkallë të ulët. Mungesa e informimit dhe turpi janë dy arsyt kryesore për mospërdorimin e tyre, sidomos për të rinjtë dhe të rejtat e zonave rurale. Përgjigjedhënesit/et që kanë kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirë herën e parë kishin prirje për të mos përdorur metoda kontraceptive. Duket se mungesa e vendosjes së kufirit në marrëdhënien e parë seksuale ndikon në mënyrën se si përqasen vajzat e reja më vonë në marrëdhëniet e tjera seksuale, diçka që mbështetet dhe nga studimi i mëparshëm i AWEN (2019).

Vitet dhe dekadat e fundit kanë dëshmuar një rritje galopante të përdorimit të internetit, teknologjisë dhe komunikimit virtual. Një pjesë e jetëve tona, edhe më shumë si pasojë e kufizimeve dhe izolimit e distancimit fizik gjatë pandemisë Covid-19, kanë kaluar në planin virtual, dhe këtij trendi nuk i ka shpëtuar as dhuna me bazë gjinore dhe ajo në marrëdhëniet intime.

Pornografia u raportua të ishte mjaft e përhapur tek bashkëmoshatarët sesa ajo pranohej në planin individual, hendeq ky që ishte shumë i dukshëm mes vajzave. Në përgjithësi kishte një ndërgjegjësim/

njohje të ulët lidhur me impaktin e saj në jetët e të rinjve/të rejave dhe për një pjesë të të rinjve, veçanërisht vajza dhe në zona rurale mbetet një temë ende tabu për t’u eksploruar dhe studiuar më shumë.

Një pjesë e konsiderueshme e të pyeturve në këtë studim kishin bërë dhe/ose shkëmbyer imazhe dhe materiale të tjera me përmbajtje seksuale dhe gati një në 10 nga përgjigjedhënesit në këtë studim raportuan të kenë qenë të paktën një herë pre e shantazhit ku janë përdorur foto/video apo materiale të tjera me përmbajtje seksuale. Këtu rol të veçantë luajnë mediat sociale me Instagram-in dhe Facebook/Messenger si aplikacionet që përmendet më shpesh si platforma kryesore e përdorur nga shantazhuesit. Efektet e shantazhimit kanë ndikuar ndjeshëm në jetët e të shantazhuar/ave, ku më shumë vajza sesa djem jo vetëm kanë qenë viktimat të shantazhit, por edhe kanë pasur nevojë të raportojnë dhe/ose kërkojnë ndihmë për përbalimin e situatës përtej familjes apo rrjetit mbështetës shoqëror.

Kriza e shkaktuar nga pandemia Covid19, siç edhe u parashtrua në hyrje të këtij raporti, ka ndikuar negativisht në situatën e DHBGJ në të gjithë globin. Edhe perceptimet e ndara nga të rinjtë e të rejtat në këtë studim treguan për një situatë të rënduar në raport me dhunën në përgjithësi, atë me bazë gjinore dhe atë në familje në veçanti. Rritja e incidencës së dhunës nuk ishte shoqëruar me tregues në rritje të raportimit të saj. Frika nga Covid19, kufizimet e vendosura, tkurrja dhe/ose mbingarkesa e shërbimeve ishin ndër arsyt që kishin penguar/stepur raportimin e dhunës. Janë pikërisht këto arsye të kombinuara me problematikat e dhunës virtuale të amplifikuar nga “normaliteti” i ri i jetës virtuale që kërkojnë një vëmendje edhe më të shtuar dhe të vazhdueshme për çështjet e DHBGJ në përgjithësi dhe DHMI në veçanti, sidomos në grupmoshat më të reja të popullsisë.

6. Referenca

- Abramsky, T., Watts, C. H., Garcia-Moreno, C., Devries, K., Kiss, L., Ellsberg, M., . . . Heise, L. (2011). What factors are associated with recent intimate partner violence? Findings from the WHO multi-country study on women's health and domestic violence. *BMC Public Health*, 11(1)
- Aceng, S. (2017). "Revenge porn" – the understanding and impact of non – consensual intimate images violence. E marrë nga <https://impakter.com/revenge-porn-the-understanding-and-impact-of-non-consensual-intimate-images-ncii-violence/> e aksesuar në shkurt 2021
- Arqimandriti M., Lena O., Uka A., Kapllanaj M., (2018). Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë në Shqipëri, AWEN.
- Barter, C., N. Stanley, M. Wood, A. Lanau, N. Aghtaie, C. Larkins, and C. Øverlien (2017). Young People's Online and Face-to-Face Experiences of Interpersonal Violence and Abuse and Their Subjective Impact Across Five European Countries. *Psychology of Violence* 7 (3): 375–384.
- Bates, E. A. (2020). "No one would ever believe me": An exploration of the impact of intimate partner violence victimization on men. *Psychology of Men & Masculinities*, 21(4), 497–507.
- Beyene, A.S., Chojenta, C., Roba, H.S. e të tjerë (2019). Gender-based violence among female youths in educational institutions of Sub-Saharan Africa: a systematic review and meta-analysis. *Systematic Reviews*, 8 (59).
- Bruce, J. (2011). Violence against adolescent girls: A fundamental challenge to meaningful equality. New York: The Population Council, Inc. E marrë nga http://www.popcouncil.org/uploads/pdfs/2012PGY_GirlsFirst_Violence.pdf e aksesuar në shkurt 2021
- Bryman, A. 2008. *Social Research Methods*. Second edition , Oxford University press
- Campbell, R., Dworkin, E., & Cabral, G. (2009). An ecological model of the impact of sexual assault on women's mental health. *Trauma, Violence, & Abuse*, 10(3), 225–246.
- Capaldi, D. M., Kim, H. K., Shortt, J. W. (2004). Women's involvement in aggression in young adult romantic relationships. In Putallaz, M., Bierman, K.L. (Eds.), *Aggression, Antisocial Behavior and Violence Among Girls*. New York: Guilford.
- CDC (2017). Preventing intimate partner violence across the lifespan: a technical package of programs, policies and practices. E marrë nga <https://www.cdc.gov/violenceprevention/pdf/ipv-technicalpackages.pdf> e aksesuar në shkurt 2021
- Center for Disease Control, National Center for Injury Prevention and Control (2015). *Intimate Partner Violence Surveillance Uniform Definitions and Recommended*

- Data Elements. E marrë nga <https://www.cdc.gov/violenceprevention/pdf/ipv/intimatepartnerviolence.pdf> e aksesuar në shkurt 2021
- Chase, K.A., O'Farrell, T.J., Murphy, C.M., Fals-Stewart, W. dhe Murphy, M. (2003). Factors associated with partner violence among female alcoholic patients and their male partners. *Journal of Studies on Alcohol*.64:137–149.
- Chermack, S. T., Fuller, B. E., Blow, F. C. (2000). Predictors of expressed partner and non-partner violence among patients in substance abuse treatment. *Drug and Alcohol Dependence*, 58, 43-54.
- Citron, D., & Franks, M. (2014). Criminalizing revenge porn. *Wake Forest Law Review*, 49, 345–391.
- D'Angelo, D.V., Gilbert, B.C., Rochat, R.W., Santelli, J.S., Herold, J.M. (2004). Differences between mistimed and unwanted pregnancies among women who have live births. *Perspectives on Sexual and Reproductive Health*, 36(5):192-7. doi: 10.1363/psrh.36.192.04. PMID: 15519961.
- Dardis, C. M., Kraft, K. M., Gidycz, C. A. (2017). “Miscommunication” and undergraduate women’s conceptualizations of sexual assault: A qualitative analysis. *Journal of Interpersonal Violence*. Advance online publication.
- Decker, M. R., Peitzmeier, S., Olumide, A., Acharya, R., Ojengbede, O., Covarrubias, L., . . . Brahmbhatt, H. (2014). Prevalence and health impact of intimate partner violence and non-partner sexual violence among female adolescents aged 15–19 years in vulnerable urban environments: A multi-country study. *Journal of Adolescent Health*, 55(6), 58-67.
- Eckhardt, C.I., Parrott, D.J., Sprunger, J.G. (2015). Mechanisms of Alcohol-Facilitated Intimate Partner Violence. *Violence Against Women*, 21(8):939-957.
- Exner-Cortens, D., Eckenrode, J., & Rothman, E. (2013). Longitudinal associations between teen dating violence victimization and adverse health outcomes. *Pediatrics*, 131, 71-78.
- Fang, X., Corso, P. S. (2007). Child maltreatment, youth violence, and intimate partner violence: Developmental relationships. *American Journal of Preventive Medicine*, 33, 281-290.
- Faulkner, B., Goldstein, A.L. dhe Wekerle, C. (2014). Pathways from Childhood Maltreatment to Emerging Adulthood: Investigating Trauma-Mediated Substance Use and Dating Violence Outcomes Among Child Protective Services–Involved Youth. *Child Maltreatment*.19 (3-4):219-232.
- Fernet, M., Hébert, M., Brodeur, G., Théorêt V. (2019). “When You’re in a Relationship, You Say No, but Your Partner Insists”: Sexual Dating Violence and Ambiguity Among Girls and Young Women. *Journal of Interpersonal Violence*.
- Fernet, M., Hébert, M., Couture, S., Brodeur, G. (2019). Meeting the needs of adolescent and emerging adult victims of sexual violence in their romantic relationships: a mixed methods study exploring barriers to help-seeking. *Child abuse & neglect*, 91, 41-51.

- Foshee, V. A., Benefield, T. S., Ennett, S. T., Bauman, K. E., Suchindran, C. (2004). Longitudinal predictors of serious physical and sexual dating violence victimization during adolescence. *Preventive Medicine*, 39, 1007-1016.
- Foshee, V. A., Bauman, K.L., Linder, F., Rice, J. dhe Wilcher, R (2007). Typologies of Adolescent Dating Violence. Identifying Typologies of Adolescent Dating Violence Perpetration. *Journal of Interpersonal Violence* 22 (5): 498–519
- García-Moreno, C., Zimmerman, C., Morris-Gehring, A., Heise, L., Amin, A., Abrahams, N., Montoya, O., Bhate-Deosthali, P., Kilonzo, N. dhe Watts, C. (2015). Addressing violence against women: a call to action. *Lancet*, 385 (9978):1685-95.
- Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO) (2017). Baseline Evaluation Report Albania. E marrë nga <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7> e aksesuar në shkurt 2021
- Halcomb E., Hickman L. (2014) Mixed methods research. *Nursing Standard*. 29, 32, 41-47.
- Henry, N., & Flynn, A. (2019). Image-based sexual abuse: Online distribution channels and illicit communities of support. *Violence against Women*, 25(16), 1932–1955.
- Hickman, L. J., Jaycox, L. H., Aronoff, J. (2004). Dating violence among adolescents: Prevalence, gender distribution, and prevention program effectiveness. *Trauma, Violence, & Abuse*, 5, 123-142.
- Home Office (2016). Country Information and Guidance Albania: Women fearing domestic violence. E marrë nga <https://www.justice.gov/eoir/file/844791/download> e aksesuar në shkurt 2021
- IDRA dhe UNWOMEN (2018). Mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri E marrë nga https://idracompany.com/files/Sexual%20HarassmentGBV%20-2018%20ALB_0.pdf e aksesuar në shkurt 2021
- INSTAT (2019). Violence against women and girls in Albania – national population survey. E marrë nga <http://www.instat.gov.al/media/6123/publication-violence-against-women.pdf> e aksesuar në shkurt 2021
- Johnson, W. L., Giordano, P. C., Longmore, M. A., Manning, W. D. (2014). Intimate partner violence and depressive symptoms during adolescence and young adulthood. *Journal of Health and Social Behavior*, 55, 39-55.
- Kamal, M., & Newman, W. J. (2016). Revenge pornography: Mental health implications and related legislation. *The Journal of the American Academy of Psychiatry and the Law*, 44(3), 359–367.
- Katz, C.C., Courtney, M. E. dhe Sapiro, B. (2017). Emancipated foster youth and intimate partner violence: an exploration of risk and protective factors. *Journal of Interpersonal Violence*, 35 (23-24)
- Këshilli i Evropës (n.d.). What causes gender – based violence? E marrë nga <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/what-causes-gender-based-violence> e aksesuar në shkurt 2021.

- Knight, C. R., & Brinton, M. C. (2017). One egalitarianism or several? Two decades of gender-role attitude change in Europe. *American Journal of Sociology*, 122(5), 1485–1532.
- Le Masson, V., Lim, S., Budimir, M. dhe Podboj, J. S. (2016) Disasters and violence against women and girls Can disasters shake social norms and power relations?, Overseas Development Institute.
- Leonard, K. E. (2008). The role of drinking patterns and acute intoxication in violent interpersonal behaviors. In Grant, M., Fox, M., Leonard, K. E., O’Conner, C. M. (Eds.), *Alcohol and violence: Exploring patterns and responses* (fq. 29-55). Washington, DC: International Center for Alcohol Policies.
- Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar në vitin 2008, 2010 dhe 2018.
- Muehlenhard, C. L., Humphreys, T. P., Jozkowski, K. N., Peterson, Z. D. (2016). The complexities of sexual consent among college students: A conceptual and empirical review. *The Journal of Sex Research*, 53, 457-487.
- Nickerson, A., Steenkamp, M., Aerka, I. M., Salters-Pedneault, K., Carper, T. L., Barnes, J. B., & Litz, B. T. (2013). Prospective investigation of mental health following sexual assault. *Depression and Anxiety*, 30(5), 444–450.
- Nielsen, M. B., Bjørkelo, B., Notelaers, G., & Einarsen, S. (2010). Sexual harassment: Prevalence, outcomes, and gender differences assessed by three different estimation methods. *Journal of Aggression, Maltreatment & Trauma*, 19(3), 252–274.
- OBSH (2005). WHO multi – country study on women’s health and domestic violence against women. E marrë nga <http://www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/24159358X/en/> e aksesuar në qershor 2020
- OBSH (2017). Key facts - Violence against women. E marrë nga <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women> e aksesuar në janar 2021
- OHCHR (2018). How gender stereotyping affects the enjoyment of human rights. E marrë nga <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Women/WRGS/Pages/WrongfulGenderStereotyping.aspx> e aksesuar në shkurt 2021
- O’Leary, P., & Tsui, M. (2021). A long-distance wake-up call for the social work profession: From hardship to friendship. *International Social Work*, 64(1), 3–4. <https://doi.org/10.1177/0020872820980906>
- Onanubi, K.A., Olumide, A. O. dhe Owoaje, E. T. (2017). Prevalence and Predictors of Intimate Partner Violence Among Female Youth in an Urban Low-Income Neighborhood in Ibadan, South-West Nigeria. *Sage Open*, 1-11
- Orchowski, L. M., Untied, A. S., Gidycz, C. A. (2013). Social reactions to disclosure of sexual victimization and adjustment among survivors of sexual assault. *Journal of Interpersonal Violence*, 28, 2005-2023
- Organizata Botërore e Shëndetësisë, Departamenti i Shëndetit Riprodhues dhe Kërkimit Shkencor, Shkolla e Higjienës dhe Mjekësisë Tropikale në Londër, Këshilli i Kërkimeve Mjekësore të Afrikës së Jugut (2013). *Vlerësimet globale dhe rajonale*

- të dhunës ndaj grave: Përhapja dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale nga jopartneri/ët.
- Peterson, Z. D. dhe Muehlenhard, C. L. (2011). A match-and-motivation model of how women label their nonconsensual sexual experiences. *Psychology of Women Quarterly*, 35, 558-570.
- Powell, A. dhe Henry, N. (2019). Technology-facilitated sexual violence victimization: Results from an online survey of Australian adults. *Journal of Interpersonal Violence*, 34(17), 3637–3665.
- Powell, A., Henry, N., Flynn, A. dhe Scott, A. J. (2019). Image-based sexual abuse: The extent, nature, and predictors of perpetration in a community sample of Australian residents. *Computers in Human Behavior*, 92, 393–402.
- Renner, L. M., Whitney, S. D. (2012). Risk factors for unidirectional and bidirectional intimate partner violence among young adults. *Child Abuse & Neglect*, 36, 40-52.
- Richards, T. N., Branch, K. A., Ray, K. (2014). The impact of parental and peer social support on dating violence perpetration and victimization among female adolescents: A longitudinal study. *Violence and Victims*, 29, 317-331.
- Romito, P., L. Beltramini, dhe V. Escribà-Agüir (2013). Intimate Partner Violence and Mental Health Among Italian Adolescents: Gender Similarities and Differences. *Violence Against Women* 19 (1): 89–106
- Ruark, A., dhe Fielding-Miller, R. (2016). Using Qualitative Methods to Validate and Contextualize Quantitative Findings: A Case Study of Research on Sexual Behavior and Gender-Based Violence Among Young Swazi Women. *Global Health: Science and Practice*, 4(3):373-383
- Russell, M., Cupp, P. K., Jewkes, R. K., Gevers, A., Mathews, C., LeFleur-Bellerose, C., & Small, J. (2014). Intimate partner violence among adolescents in Cape Town, South Africa. *Prevention science : the official journal of the Society for Prevention Research*, 15(3), 283–295.
- Sabina, C., Cuevas, C. A., Cotignola-Pickens, H. M. (2016). Longitudinal dating violence victimization among Latino teens: Rates, risk factors, and cultural influences. *Journal of Adolescence*, 47, 5-15.
- Smith, S. G., Zhang, X., Basile, K.C., Merrick, M.T., Wang, J., Kresnow, M., Chen, J. (2018). The National Intimate Partner and Sexual Violence Survey (NISVS): 2015 Data Brief—Updated Release. Atlanta, GA: National Center for Injury Prevention and Control, Centers for Disease Control and Prevention. E marrë nga https://www.cdc.gov/violenceprevention/pdf/ipv/IPV-factsheet_2020_508.pdf e aksesuar në shkurt 2021
- Smith, S.G., Chen, J., Basile, K.C., Gilbert, L.K., Merrick, M.T., Patel, N., Walling, M., & Jain, A. (2017). The National Intimate Partner and Sexual Violence Survey (NISVS): 2010-2012 State Report. Atlanta, GA: National Center for Injury Prevention and Control, Centers for Disease Control and Prevention. E marrë nga <https://www.cdc.gov/violenceprevention/pdf/NISVS-StateReportBook.pdf> e aksesuar në qershor 2020
- Staggs, S. L., Long, S. M., Mason, G. E., Krishnan, S., Riger, S. (2007). Intimate partner

- violence, social support, and employment in the post-welfare reform era. *Journal of Interpersonal Violence*, 22, 345-367.
- Stöckl, H., March, L., Pallitto, C., & Garcia-Moreno, C. (2014). Intimate partner violence among adolescents and young women: Prevalence and associated factors in nine countries—A cross-sectional study. *BMC Public Health*, 14(1)
- Toscano, S. E. (2007). A grounded theory of female adolescents' dating experiences and factors influencing safety: the dynamics of the Circle. *BMC nursing*, 6(1), 7.
- Tucker Halpern, C., Spriggs, A., Martin, S., dhe Kupper, L. (2009). Patterns of Intimate Partner Violence Victimization from Adolescence to Young Adulthood in a Nationally Representative Sample. *Journal of Adolescent Health*, 45 (5): 508 – 5016
- Truell, R., & Crompton, S. (2020). To the top of the cliff: How social work changed with COVID-19. Marrë nga <https://www.ifsw.org/to-the-top-of-the-cliff-how-social-work-changed-with-covid-19/>
- UNICEF Albania (2019). One click – away: children's experience of Internet use in Albania. E marrë nga https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/one_click.pdf e aksesuar në shkurt 2021.
- United Nations Children's Fund. (2012). *State of the world's children 2012: Children in an urban world*. New York, NY: Author.
- United Nations Albania. (2020). UN Albania COVID-19 socio-economic recovery and response plan. Marrë nga <https://www.unicef.org/albania/media/3101/file/UN%20ALBANIA%20COVID-19%20SOCIO-ECONOMIC%20RECOVERY%20&%20RESPONSE%20PLAN.pdf>
- UNDP (2020). Gender-based violence and COVID-19 <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/gender-based-violence-and-covid-19.html>
- Vézina, J., Hébert, M. (2007). Risk factors for victimization in romantic relationships of young women: A review of empirical studies and implications for prevention. *Trauma, Violence, & Abuse*, 8, 33-66
- Weiss, K. G. (2013). "You just don't report that kind of stuff": Investigating teens' ambivalence toward peer-perpetrated, unwanted sexual incidents. *Violence and Victims*, 28, 288-302.
- Whitaker, D. J., Haileyesus, T., Swahn, M., & Saltzman, L. S. (2007). Differences in frequency of violence and reported injury between relationships with reciprocal and nonreciprocal intimate partner violence. *American Journal Public Health*, 97, 941-947.
- Williams, C.M., Larsen, U., McCloskey, L.A. (2008). Intimate Partner Violence and Women's Contraceptive Use. *Violence Against Women*, 14(12):1382-1396.
- Wilson, L. C., Miller, K. E. (2016). Meta-analysis of the prevalence of unacknowledged rape. *Trauma, Violence, & Abuse*, 17, 149-159.
- Wincentak, K., Connolly, J., Card, N. (2017). Teen dating violence: A meta-analytic review of prevalence rates. *Psychology of Violence*, 7, 224-241.

- Wisdom, J. dhe Creswell, J.W. (2013) *Mixed methods: integrating quantitative and qualitative data collection and analysis while studying patient-centered medical home models*. Rockville, MD: BMJ Publishing Group, 2013.
- Woo, J., Fine, P., Goetzl, L. (2005). Abortion disclosure and the association with domestic violence. *Obstetrics and Gynecology*, 105(6):1329-34.
- World Vision in Albania and Kosovo (2014). A study on child online safety in Albania. E marrë nga https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/child_internet_safety_wva_study_report.pdf e aksesuar në shkurt 2021
- Yan, F. A., Howard, D. E., Beck, K. H., Shattuck, T., Hallmark-Kerr, M. (2010). Psychosocial correlates of physical dating violence victimization among Latino early adolescents. *Journal of Interpersonal Violence*, 25, 808-831.

7. Shtojca

7.1. Pyetëtori

Dhuna në marrëdhëniet intime

Pyetësor

Letër e miratimit të informuar

Përshëndetje! Ky është një pyetësor i përgatitur nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), i cili kryen studime mbi tema të ndryshme që lidhen me gratë dhe çështjet e barazisë gjinore dhe realizohet në kuadrin e programit “Mbrojtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze. Do t’ju ishëm mirënjohës/e nëse do t’i përgjigjeshit pyetjeve tonarreth opinioneve dhe përvojave tuaja lidhur me sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e burrave/grave dhe marrëdhënieve intime mes tyre. Ne do të intervistojmë gra dhe burra në mbarë vendin për të kuptuar më mirë opinionet dhe përvojat e tyre.

Dëshirojmë t’ju sigurojmë se i gjithë informacioni që ne mbledhim do të ruhet me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Asnjë individ apo adresë e veçantë nuk do të mund të identifikohet në asnjë prej fazave të kërkimit/studimit. Pjesëmarrja juaj në studim është krejtësisht vullnetare dhe mund të refuzoni në çdo rast t’u përgjigjeni pyetjeve. Nëse keni pyetje/gjëra të paqarta, mund të drejtoheni tek personi/ intervistuesi që ju ka dhënë këtë pyetësor. Nëse keni pyetje lidhur me këtë kërkim, mund të kontaktoni AWEN në adresën info@awenetwork.org.

Plotësimi i pyetësorit do të zgjasë rreth 30 deri në 40 minuta.

Faleminderit!

Bashkia ku banoni aktualisht: _____

Njësia juaj administrative: _____

SEKSIONI 1. PYETJE TË PËRGJITHSHME

100. Mosha juaj (në vite) _____

101. Gjinia 1. Mashkull 2. Femër 3. Tjetër 99. Refuzoj të përgjigjem

102. Niveli më i lartë arsimor që keni kryer:

I/e paarsimuar ose me arsim fillor të papërfunduar (më pak se 4/5 klasë)	1
Arsim fillor	2
Arsim i detyrueshëm (8/9 vjeçar)	3
Arsim i mesëm	4
Arsim universitar ose pasuniversitar	5
Nuk e di	97
Refuzoj	99

103. Cili nga pohimet në vijim përshkruan më së miri gjendjen tuaj aktuale të punësimit?

Jam i/e punësuar në punë me pagesë	1
Jam i/e vetëpunësuar	2
Ndihmoj familjen në biznesin tonë familjar (pa pagesë)	3
I/e papunë	4
Student/e dhe/ose në trajnim (kurse profesionale etj.)	5
I/e papunë për shkak sëmundjeje ose aftësie të kufizuar	6
Merrem me punë shtëpie dhe përkujdesje	7
Tjetër, ju lutemi specifikoni _____	8
Nuk e di	97
Refuzoj	99

Në rast se pyetjes 103 i jeni përgjigjur me një nga alternativat 1-3, kaloni te pyetja 104

104. Punoni me kohë të plotë, me kohë të pjesshme apo thjesht me raste?

Me kohë të plotë	1
Me kohë të pjesshme	2
Me raste	3
Nuk e di	97
Refuzoj	99

Në rast se pyetjes 103 i jeni përgjigjur me 4-99, kaloni te pyetja 105.

105. Cila është mesatarja e të ardhurave tuaja personale?

Pa të ardhura	1
Deri në 26 000 lekë/muaj	2
26 001 - 35 000 lekë/muaj	3
35 001 - 50 000 lekë/muaj	4
50 001 - 70 000 lekë/muaj	5
70 001 - 100 000 lekë/muaj	6
Mbi 100 000 lekë/muaj	7
Nuk e di	97
Refuzoj	99

106. Cili nga pohimet në vijim përshkruan më së miri gjendjen tuaj civile aktuale?

Beqar/e	1
Në një marrëdhënie, por pa bashkëjetesë	2
Në një marrëdhënie bashkëjetese me partnerin/en	3
I/e martuar, por pa bashkëjetesë (p.sh. për shkak të migrimit)	4
I/e martuar, me bashkëjetesë	5
I/e ndarë/divorcuar	6
I/e ve	7
Nuk e di	97

Refuzoj	99
---------	----

107. Sa herë keni qenë më përpara:

(pa përfshirë marrëdhëniet aktuale, nëse jeni në një të tillë):

	Asnjëherë	Një herë	Dy herë	3 ose më shumë herë	Nuk e di	Refuzoj
A. I/e martuar	1	2	3	4	97	99
B. I/e përfshirë në një marrëdhënie, por pa bashkëjetuar me partnerin/en	1	2	3	4	97	99
C. I/e përfshirë në një marrëdhënie bashkëjetese me një partner/e	1	2	3	4	97	99

108. A keni fëmijë?

Jo	1
Po, një fëmijë	2
Po, dy fëmijë	3
Po, tre ose më shumë fëmijë	4
Nuk e di	97
Refuzoj	99

109. Sa shpesh e konsumoni alkoolin ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë)?

	A. Unë	B. Partneri/ja im/e
Nuk pi kurrë / pi, por nuk dehem/t	1	1
Disa herë në vit ose më rrallë	2	2
Një herë në dy muaj	3	3
Një herë në muaj	4	4
Disa herë në muaj	5	5
Një ose dy herë në javë	6	6

Përditë ose pothuajse përditë	7	7
Nuk e di	97	97
Refuzoj të përgjigjem	99	99

110. Sa shpesh merrni lëndë narkotike/drogë ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë)?

	A. Unë	B. Partneri/ja im/e
Asnjëherë	1	1
Disa herë në vit ose më rrallë	2	2
Një herë në dy muaj	3	3
Një herë në muaj	4	4
Disa herë në muaj	5	5
Një ose dy herë në javë	6	6
Përditë ose pothuajse përditë	7	7
Nuk e di	97	97
Refuzoj të përgjigjem	99	99

111. A keni vuajtur ndonjëherë ju ose partneri/ja juaj aktual/e (nëse e keni një të tillë) nga problemet e mëposhtme të shëndetit mendor? (Mund të shënoni më shumë se një alternativë për secilin)	A. Unë	B. Partneri/ja im/e
Ankth (ndjen vazhdimisht stres, je në tension, vazhdimisht alert/e, të duket sikur diçka e keqe do të ndodhë, acarohesh shpesh, shpërqendrohesh, ke probleme me gjumin etj.)		
Depresion (ke trishtim që zgjat në kohë, nuk përjeton kënaqësi nga aktivitetet e ndryshme, nuk ke energji për të punuar/studiuar/ bërë gjëra, acarohesh ose je pasiv, ke ulje të vetëvlerësimit, nuk fle dot ose fle më shumë se zakonisht, nuk ke oreks ose ke shumë oreks, etj.)		

Kriza paniku (papritmas ndjen një tension të madh, sikur je në alarm, zemra rreh shumë fort, duket sikur do “dalë nga vendi”, ke frymëmarrje të shpejtë ose marrje fryme/bllokim, ke ndjesinë sikur po “vdes” ose po “çmendesh” që mund të zgjasë dhe vetëm disa sekonda.)		
Mungesë vetëbesimi (përjeton mungesë besimi në aftësitë e tua, ke ndjesinë sikur nuk je i zoti/e zonja për të bërë diçka)		
Probleme me gjumin (mungesë gjumi ose gjumë i tepërt)		
Mungesë oreksi ose oreks i tepërt të shoqëruara me rënie ose shtim në peshë		
Probleme me përqendrimin (nuk përqendrohesh dot në një punë/detyrë, ke ndjesinë sikur mendja nuk rri në një vend/fluturon, ke vështirësi për të përfunduar një detyrë)		
Makthe		
Mendime për vetëvrasje		
Tjetër, ju lutem specifikoni_____		
Nuk e di		
Refuzoj të përgjigjem		

SEKSIONI 2. STEREOTIPAT GJINORË DHE DHUNA (ME BAZË GJINORE)

Deklaratat e mëposhtme përshkruajnë stereotipat dhe qëndrimet që kanë njerëz të ndryshëm kundrejt grave dhe burrave në shoqëri. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, vetëm opinione. Sa dakord bini me deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 deri në 4 ku (1) është plotësisht dakord dhe (4) plotësisht jodakord?

200. Sa dakord bini me deklaratat e mëposhtme?	Plotësisht dakord	Disi dakord	Disi jodakord	Plotësisht jo dakord
A. Përgjithësisht, gratë nuk janë aq të zgjuara sa burrat.	1	2	3	4
B. Pak rëndësi ka për mua nëse eprori im është femër apo mashkull.	1	2	3	4

C. Djemtë duhet të nxiten më shumë se vajzat për t'u përfshirë në sporte/ atletikë.	1	2	3	4
D. Gratë janë po aq të afta sa burrat për të menduar në mënyrë logjike.	1	2	3	4
E. Kur të dy prindërit janë të punësuar dhe fëmija i tyre sëmuret, shkolla duhet të telefonojë mamanë, jo babanë.	1	2	3	4

201. Sa dakord jeni me deklaratat e mëposhtme mbi rolet e burrave dhe grave në familje?	Plotësisht dakord	Disi dakord	Disi jodakord	Plotësisht jo dakord
Në martesë:				
A. Bashkëshorti duhet të jetë kreu i familjes.	1	2	3	4
B. Martesa funksionon më mirë nëse bashkëshorti nuk përfshihet në punët e shtëpisë.	1	2	3	4
Në rritjen e fëmijëve:				
C. Ndërrimi i pelenave të foshnjës i shkon më për shtat nënës sesa babait.	1	2	3	4
D. . Mbjajtja nën kontroll e aktiviteteve të fëmijës duhet të jetë kryesisht detyrë e nënës.	1	2	3	4
Në punësim:				
E. Nuk shkon që një burrë t'i hyjë një karriere që është tipike për gra.	1	2	3	4
F. Gratë mund t'i përballojnë presionet e punës po aq mirë sa burrat.	1	2	3	4
Në marrëdhëniet shoqërore/ ndërpersonale/heteroseksuale:				
G. Gruaja duhet të bëjë kujdes të mos duket më e zgjuar se partneri i saj.	1	2	3	4
H. Njerëzit duhet të jenë më të sjellshëm me gratë sesa me burrat.	1	2	3	4
Në arsim:				

I. Leksionet e ekonomisë shtëpiake duhet të jenë po aq të pranueshme për djemtë sa për vajzat.	1	2	3	4
J. Për gratë, zgjedhja e degës së studimit nuk është aq e rëndësishme sa për burrat.	1	2	3	4

Dhuna me bazë gjinore

202. Komuniteti	Po	Jo	Nuk e di
1. Në komunitetin tuaj a janë fqinjët në përgjithësi të prirur për ta njohur mirë njëri-tjetrin?	1	2	97
2. Nëse do të ndodhte një sherr në rrugë në komunitetin tuaj, a do të ndërhynin njerëzit/ do të bënin diçka për ta ndaluar sherrin?	1	2	97
3. Nëse dikush në komunitetin tuaj do të hynte në telashe, a do të ofronin ndihmë fqinjët?	1	2	97
4. Nëse dikush në komunitetin tuaj do të hynte në telashe, a do të telefononin policinë fqinjët?	1	2	97
5. Nëse dikush në komunitetin tuaj do të përfshihej në një situatë dhune në familje, a do të ndërhynin/bënin diçka fqinjët?	1	2	97
6. Nëse dikush në komunitetin tuaj do të përfshihej në një situatë dhune në familje, a do të telefononin policinë fqinjët?	1	2	97

Përvojat personale me dhunën me bazë gjinore

203. Gjatë 12 muajve të fundit, a jeni shqetësuar ndonjëherë se mund të sulmoheni apo lëndoheni fizikisht apo seksualisht nga ndonjë prej personave në vijim? Nëse po, sa shpesh?	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjatë gjithë kohës	Nuk e di	Refuzoj të përgjigjem
--	-----------	------------	------------	--------------------	----------	-----------------------

1. një i/e panjohur?	1	2	3	4	97	99
2. dikush në punë, në shkollë ose në kurs?	1	2	3	4	97	99
3. një i/e njohur tjetër, një fqinj/e apo shoqe/shok?	1	2	3	4	97	99
4. një i/e afërm/e apo anëtar/e i/e familjes, përveç partnerit/es suaj?	1	2	3	4	97	99
5. policia	1	2	3	4	97	99
6. partneri/ja juaj aktual/e?	1	2	3	4	97	99
7. ish-partneri/ja juaj?	1	2	3	4	97	99

204. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni kryer ndonjë prej veprimeve të mëposhtme nga frika e dhunës fizike apo sulmit seksual - përdorni një prej alternativave në këtë tabelë për t'u përgjigjur.	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjatë gjithë kohës	Refuzoj të përgjigjem
1. Keni shmangur daljet nga shtëpia vetëm?	1	2	3	4	99
2. Keni shmangur kalimin nga rrugë të caktuara apo vajtjen në vende të caktuara?	1	2	3	4	99

3. Keni shmangur frekuentimin e vendeve ku nuk ka njerëz të tjerë rrotull, si për shembull rrugë të caktuara, parkingje etj.	1	2	3	4	99
4. Keni shmangur hapjen e derës së shtëpisë kur jeni vetëm?	1	2	3	4	99
5. Keni shmangur vajtjen në shtëpi nga frika e asaj që mund t'ju priste?	1	2	3	4	99
6. Keni shmangur kthimin në qytetin/fshatin/vendin e lindjes?	1	2	3	4	99
7. Keni shmangur të nderjurit vetëm me një koleg/eapo me shefin/en në punë?	1	2	3	4	99

205. Në përgjithësi, sa e përhapur mendoni se është dhuna ndaj grave në Shqipëri (nga partnerët, persona të njohur apo të panjohur)?

Shumë e përhapur	1
E përhapur	2
Jo dhe aq e përhapur	3
Aspak e përhapur	4
Nuk e di	97
Refuzoj të përgjigjem	99

206. A keni parë apo dëgjuar së fundmi për ndonjë fushatë ndërgjegjësuese kundër dhunës ndaj grave?

Po	1
Jo	2
Nuk e di	97

Refuzoj të përgjigjem	99
-----------------------	----

207. Kur mendoni për dhunën ndaj grave në familje – p.sh. nga bashkëshorti, partneri, kunati etj – a ju vjen ndërmend ndonjë grua që ka përjetuar ndonjë prej formave të dhunës në familje:

Në rrethin tuaj shoqëror dhe familjar? 1. Po 2. Jo 97. Nuk e di 99. Refuzoj

Në lagjen tuaj? 1. Po 2. Jo 97. Nuk e di 99. Refuzoj

208. Sa i/e mirëinformuar mendoni se jeni rreth veprimeve që do t'ju duhej të ndërmerrnit nëse do të binit pre e dhunës seksuale? Për shembull, si të kërkonti ndihmë të menjëhershme nga një strehë, si të mbroni veten dhe fëmijët tuaj në të ardhmen, apo si të kërkonti mbështetje financiare.

Shumë i/e mirëinformuar	1
I/e mirëinformuar	2
Disi i/e informuar	3
Jo dhe aq i/e informuar	4
Nuk kam asnjë ide se çfarë duhet të bëj	5
Refuzoj të përgjigjem	99

209. Njerëzit kanë mendime të ndryshme për sa i përket faktit nëse gratë e dhunuara nga partneri duhet të flasin me të tjerë në lidhje me dhunën. Gjithashtu, ka mendime të ndryshme lidhur me faktin nëse është me vend që të tjerët të përfshihen në situata ku gruaja dhunohet nga bashkëshorti, partneri apo ish-partneri. Dëshirojmë t'ju bëjmë disa pyetje lidhur me këtë, të cilave mund t'ju përgjigjeni me "plotësisht dakord", "disi dakord", "disi jodakord" apo "plotësisht jodakord" për deklaratat e mëposhtme.

Një grua e dhunuar nga bashkëshorti apo partneri i saj do t'i tregonte për këtë, edhe nëse dhuna nuk do të ishte aq e shpeshtë, si për shembull jo më shumë se një herë në vit?	Plotësisht dakord	Disi dakord	Disi jodakord	Plotësisht jodakord	Nuk e di	Refuzoj të përgjigjem
...një anëtar i të familjes	1	2	3	4	97	99

...një shoku/ shoqeje apo një fqinji/fqinje	1	2	3	4	97	99
... një përfaqësuesi/eje të besimit të saj fetar	1	2	3	4	97	99
...një oficeri/eje policie	1	2	3	4	97	99
...një punonjësi/ eje të kujdesit shëndetësor	1	2	3	4	97	99
...një specialisti/ eje të shëndetit mendor	1	2	3	4	97	99
...një punonjësi/ eje (social/e) të një organizate/ shoqate - OJF-je/ OShC-je	1	2	3	4	97	99

210. Në një shkallë nga 1 deri në 5 , ku 1 është “aspak” dhe 5 është “jashtëzakonisht shumë”, sa mundësi ka që t’i drejtoheni njerëzve/punonjësve/institucioneve të mëposhtme në rastet kur personi me të cilin/ën jeni në një marrëdhënie intime ju kërcënon, dhunon fizikisht ose seksualisht?

1	2	3	4	5
Aspak	Pak	Disi	Shumë	Jashtëzakonisht shumë

Nëse personi me të cilin/ën ti je në një marrëdhënie intime...	...po të kërcënon, poshtëron ose tenton të të kontrollojë, sa mundësi ka t’i tregosh	...po të lëndon/ dhunon fizikisht, sa mundësi ka t’i tregosh	...po të detyron të kryesh një akt seksual pa dëshirën tënde, sa mundësi
A. Njërit prej prindërve			
B. Një shoku/shoqeje			
C. Një mjeku/eje			

D. Një përfaqësuesi/ eje të besimit tënd fetar			
E. Një psikologu/eje ose një këshilluesi/ eje tjetër			
F. Organizatave që punojnë më të drejtat e grave/mbrojnë gratë e vajzat në situatë dhune			
G. Policisë			
H. Tjetër _____			

211. A do ta gjykonit të pranueshme që gjatë kontrolleve rutinë, mjekët që vënë re lëndime fizike/plagë te gratë t'i pyesin ato nëse lëndimet janë shkaktuar nga dhuna?

1. Po 2. Jo 97. Nuk e di

SEKSIONI 3. NGACIMI DHE DHUNA SEKSUALE

301. Sa vjeç keni qenë kur kryet marrëdhënie seksuale për herë të parë?

1. _____ vjeç
2. Nuk kam kryer ende marrëdhënie seksuale (shko tek pyetja 306)

302. Si do ta përshkruanit marrëdhënien tuaj seksuale të parë? A ishte kjo marrëdhënie me dëshirën tuaj, apo ju nuk donit, por gjithsesi ndodhi, apo ju detyruan të kryenit marrëdhënie?

Dëshiroja të kryeja marrëdhënie	1
Marrëdhënia u krye kundër dëshirës sime	2
U detyrova të kryeja marrëdhënie	3
Nuk e di	97
Refuzoj të përgjigjem	99

303. Gjatë jetës suaj seksuale aktive, me sa partnerë keni kryer marrëdhënie seksuale _____ (numri i partnerëve)

304. Me sa partnerë keni kryer marrëdhënie seksuale gjatë 12 muajve të fundit? _____ (numri i partnerëve)

305. Cilat metoda kontraceptive keni përdorur gjatë marrëdhënies seksuale të fundit?

1. Asnjë
2. Prezervativ
3. Pilula kontraceptive
4. Injeksion
5. Pilula e emergjencës
6. Tjetër (specifikoni) _____
97. Nuk e di
99. Refuzoj të përgjigjem

306. Në përgjithësi, sa e përhapur mendoni se është dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri (nga partnerët, persona të njohur apo të panjohur)?

Shumë e përhapur	1
E përhapur	2
Jo dhe aq e përhapur	3
Aspak e përhapur	4
Nuk e di	97
Refuzoj të përgjigjem	99

307. A keni parë apo dëgjuar së fundmi ndonjë rast ngacmimi/dhune seksuale ndaj vajzave/ grave?

	Po	Jo	Nuk e di	Refuzoj të përgjigjem
A. Në media (TV/radio/shtypi i shkruar)	1	2	97	99
B. Në mediat online (portale)	1	2	97	99

C. Në mediat sociale (Facebook, Instagram, Tëitter etj.)	1	2	97	99
D. Në qytetin/fshatin tuaj	1	2	97	99
E. Në lagje	1	2	97	99
F. Në punë	1	2	97	99
G. Në rrethin e ngushtë shoqëror	1	2	97	99
H. Në familje (në rrethin familjar të afërt ose në fis)	1	2	97	99

Pyetjet në vijim janë të një natyre sensitive/të ndjeshme dhe mund t'ju bëjnë të ndiheni jorehat, çka është mëse e kuptueshme. Përgjigjet tuaja janë konfidenciale, por gjithsesi mund të mos u përgjigjeni pyetjeve të cilave nuk doni t'u përgjigjeni.

308. Sa herë ka kryer partneri/ja juaj aktual/e ndonjë prej veprimeve në vijim? Po ish-partneri/ja?	Asnjëherë	Një herë	Disa herë	Shumë herë	Nuk e di	Refuzoj
A. Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë apo duke ju lënduar në çfarëdolloj mënyre? (Me marrëdhënie seksuale nënkuptojmë seksin oral, seksin anal ose penetrimin vaginal me forcë)						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99
B. Është përpjekur t'ju detyrojë të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë apo duke ju lënduar në çfarëdolloj mënyre?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99

C. Ju ka detyruar të përfshiheni në një aktivitet seksual të çfarëdolloj forme kundër dëshirës suaj apo kur nuk keni qenë në gjendje të refuzoni?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99
D. Ju ka kërcënuar me akte seksuale të dhunshme (si përdhunimi, lënia shtatzënë kundër dëshirës etj.) në një mënyrë që ju ka trembur vërtet?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99
E. Keni pranuar të kryeni marrëdhënie seksuale pasi keni pasur frikë nga reagimi i partnerit/es tuaj nëse do të refuzoni?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99
F. Ju ka prekur në pjesët intime - në organet gjenitale apo në gjoks - kundër dëshirës suaj?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99
G. Ju ka detyruar të prekni pjesët e tyre intime - gjoksin apo organet gjenitale - kundër dëshirës suaj?						
Partneri/ja	1	2	3	4	97	99
Ish – partneri/ja	1	2	3	4	97	99

309. A jeni përballur me persona të tjerë që ju kanë trajtuar në mënyrë të padëshiruar apo fyese? Nga kush? Kur? (Përveç partnerëve/eve)

	Asnjëherë	Një herë	Disa herë	Shumë herë	Nuk e di	Refuzoj të përgjigjem	310. NGA KUSH KRYESISHT?	311. SA VJEC ISHIT?
A. Ju ka goditur me shpullë apo ju ka shkullur flokët duke ju lënduar?	1	2	3	4	97	99		
B. Ju ka goditur fort duke ju lënduar?	1	2	3	4	97	99		
C. Ju ka goditur me shkelm fort duke ju lënduar?	1	2	3	4	97	99		
D. Ju ka rrahur fort me një objekt, si p.sh. me shkop, bastun apo rrip, duke ju lënduar?	1	2	3	4	97	99		
E. Ju ka goditur me thikë apo ju ka prerë me diçka duke ju lënduar?	1	2	3	4	97	99		
F. Ka kërcënuar se do t'ju lëndonte keqazi apo t'ju vriste?	1	2	3	4	97	99		
G. Prekur, përçafuar apo puthur pa dëshirën tuaj?	1	2	3	4	97	99		
H. Vështuar ngultazi apo në mënyrë lakmuese, gjë që ju ka bërë të ndiheni në siklet?	1	2	3	4	97	99		
I. Ka komentuar apo bërë shaka me konotacion seksual, gjë që ju kanë bërë të ndiheni i/e fyer?	1	2	3	4	97	99		
J. Ju ka dërguar apo treguar pamje, fotografi apo dhurata qartësisht seksuale, të cilat ju kanë bërë të ndiheni i/e fyer?	1	2	3	4	97	99		

K. Ju ka treguar në mënyrë të turpshme pjesë intime të trupit?	1	2	3	4	97	99		
L. Ju ka detyruar të shihni apo ndiqni materiale pornografike kundër dëshirës suaj?	1	2	3	4	97	99		
M. Ju ka detyruar të pozoni nudo përpara një personi apo në fotografi, video apo kamera uebi kundër dëshirës suaj?	1	2	3	4	97	99		
N. Ju ka prekur në pjesët intime - në organet gjenitale apo në gjoks - kundër dëshirës suaj?	1	2	3	4	97	99		
O. Ju ka detyruar të prekni pjesët e tyre intime - gjoksin apo organet gjenitale - kundër dëshirës suaj?	1	2	3	4	97	99		
P. Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale me të kundër dëshirës suaj? (Shënim: Me marrëdhënie seksuale nënkuptojmë seksin oral, seksin anal ose penetrimin vaginal me forcë)	1	2	3	4	97	99		

312. A i jeni referuar ndonjëherë personave në vijim për të kërkuar ndihmë? (SHENONI TË GJITHA POHIMET E VËRTETA)

1. Policisë	
2. Një spitali/mjeku/qendre shëndetësore apo institucioni tjetër shëndetësor	
3. Shërbimeve sociale	
4. Një konsulenti ligjor/avokati	
5. Një drejtuesi/eje apo zyrtari/eje vendor/e (në bashki apo njësi administrative)	
6. Një organizate/strehe për gratë	

7. Një përfaqësuesi/eje të besimit tënd fetar	
8. Tjetër (specifikoni) _____	
9. ASNJË (Shko te pyetja 314)	
10. Nuk e di	
11. Refuzoj të përgjigjem	

313. Në rast se pyetjes 312 i jeni përgjigjur me nja nga alternativat nga 1 deri në 8, cilat janë arsye të ju kanë shtyrë të kërkonti ndihmë? (SHENONI TË GJITHA POHIMET E VËRTETA)

A. Nuk mund të duroja dot më	
B. U nxita nga miqtë/familja	
C. Kisha pësuar lëndime të rënda dhe kisha frikë se partneri/ja apo abuzuesi/ja do të më vriste	
D. Partneri/ja apo abuzuesi/ja më kërcënoi apo u përpoq të më vriste	
E. Partneri/ja kërcënoi fëmijët	
F. Më përzunë nga shtëpia	
G. Kisha frikë se mund ta vrisja partnerin/en apo abuzuesin/en tim/e	
H. Tjetër (specifikoni) _____	
I. Nuk e di	
J. Refuzoj të përgjigjem	

314. Nëse pyetjes 312 i jeni përgjigjur me ASNJË, për cilat arsye nuk kërkuat ndihmë? (SHENONI TË GJITHA POHIMET E VËRTETA)

A. U përballa vetë / përfshiva një mik / anëtar të familjes	
B. Kisha frikë nga kërcënimet/pasojat	
C. Dhuna është/ishte e papërfillshme, jo mjaftueshëm e rëndë	
D. Kisha turp/druajtje	
E. Kisha frikë se nuk do të më besonin dhe do të ma hidhnin fajin mua	
F. Nuk mendoja se do të më ndihmonin	
G. Nuk mendoja se mund të bënin diçka	
H. Kisha frikë nga partneri/ja	

I. Mendoja se ishte faji im	
J. Kisha frikë mos prishja reputacionin e familjes	
K. Tjetër (specifikoni) _____	
L. Nuk e di	
M. Refuzoj të përgjigjem	

Qëndrimet dhe perceptimet

315. Sipas mendimit tuaj, cilat janë 3 arsye kryesore të dhunës seksuale midis partnerëve? (SHËNONI 3 POHIMET QË MENDONI SE JANË MË KRYESORET)

A. Normat shoqërore lidhur me statusin e burrave dhe të grave	
B. Abuzimi me alkoolin/drogën	
C. Gjendja ekonomike e dobët e gruas/partnerit të abuzuar	
D. Problemet e shëndetit mendor	
E. Mos konsiderimi si dhunë seksuale nëse ndodh brenda çiftit	
F. Konfliktet midis partnerëve	
G. Tiparet e personalitetit	
H. Mungesa e arsimit/niveli arsimor i ulët	
I. Mungesa e sanksioneve ndaj abuzuesit	
J. Portretizimi i grave në media	
K. Tjetër (specifikoni) _____	
L. Nuk e di	
M. Refuzoj të përgjigjem	

316. A jeni dakord se marrëdhëniet seksuale kundër dëshirës mund të justifikohen në rrethanat në vijim?	Plotësisht dakord	Disi dakord	Disi Jodakord	Plotësisht Jodakord	Nuk e di	Refuzoj të përgjigjem
A. Në një martesë apo midis partnerëve që bashkëjetojnë	1	2	3	4	97	99

B. Kur personi i abuzuar ka veshur veshje ekspozuese/ provokuese apo tërheqëse	1	2	3	4	97	99
C. Kur personi i abuzuar është dehur apo ka marrë drogë	1	2	3	4	97	99
D. Kur është paraprirë nga flirtimi	1	2	3	4	97	99
E. Kur nuk është thënë shprehimisht “jo” ose nuk ka patur rezistencë fizike	1	2	3	4	97	99
F. Kur personi i abuzuar është duke ecur vetëm gjatë natës	1	2	3	4	97	99
G. Kur ka disa partnerë/e seksualë/e	1	2	3	4	97	99
H. Kur personi i abuzuar ka ftuar dikë në shtëpi, për shembull pas një feste apo takimi	1	2	3	4	97	99
I. Kur agresori/ja nuk kuptonte se çfarë po bënte, si për shembull në rastet kur ka qenë nën ndikimin e alkoolit apo drogave apo nëse pretendon se nuk ishte në dijeni të mungesës së dëshirës nga ana e personit të abuzuar	1	2	3	4	97	99

SEKSIONI 4 - PORNOGRAFIA DHE PORNOJA HAKMARRËSE

401. Sipas mendimit tuaj, sa e përhapur është pornografia mes moshatarëve tuaj?

Mjaft e përhapur	1
Disi e përhapur	2
Jo dhe aq e përhapur	3
Aspak e përhapur	4
Nuk e di	97
Refuzoj të përgjigjem	99

402. Sa shpesh shihni porno?

Pothuajse çdo ditë	1
Disa herë në javë	2
Disa herë në muaj	3
Disa herë në vit	4
Nuk shoh kurrë porno	97
Refuzoj të përgjigjem	99

403. Në çfarë moshe keni parë porno për herë të parë (qoftë edhe në mënyrë të pavullnetshme)? _____vjeç

404. Sa mendoni se ajo që tregohet në filmat porno i ngjan/duhet t'i ngjajë marrëdhënieve seksuale në realitet?

1 ___ 2 ___ 3 ___ 4 ___ 5 ___ 6 ___ 7 ___ 8 ___ 9 ___ 10

(aspak)

(totalisht)

405. Sa besoni se ajo që tregohet ne filmat porno ndikon në perceptimet dhe qëndrimet ndaj seksit tek ata që e shikojnë?

1 ___ 2 ___ 3 ___ 4 ___ 5 ___ 6 ___ 7 ___ 8 ___ 9 ___ 10

(aspak)

(totalisht)

406. A i keni bërë dikujt apo marrë ndonjëherë ndonjë foto nudo apo ndonjë imazh ose video me përmbajtje të qartë seksuale të një personi që njihni (PA përfshirë veten tuaj)?

1. Po

2. Jo (Shko tek 408)

99. Refuzoj të përgjigjem

407. Çfarë keni bërë me këto imazhe ose video? (Zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. I kam mbajtur për vete

B. Ia kam dërguar dikujt për të cilin nuk kisha ndonjë interes seksual apo marrëdhënie seksuale (p.sh. një miku/mikeshe, shoku/shoqeje dhome, kolegu/eje etj.)

C. Ia kam dërguar dikujt për të cilin kisha një interes seksual, por nuk isha në një marrëdhënie me të (p.sh. një të dashuri të ardhshëm, një të dashurë të ardhshme, një personi me të cilin dëshiroja të flirtoja)

D. Ia kam dërguar dikujt me të cilin isha i/e përfshirë në marrëdhënie seksuale dhe/ose romantike (p.sh. të dashurit/të dashurës aktuale, ish të dashurit/dashurës apo një personi me të cilin flirtoja)

E. Kam kontaktuar personin që shfaqej në imazhe apo në video

F. E kam postuar atë në mediat sociale apo në një faqe interneti. Specifikoni _____

G. Tjetër (specifikoni) _____

H. Refuzoj të përgjigjem

408. Nëse do të merrnit një foto nudo apo një imazh ose video seksuale nesër, cilat nga sa vijon do t'ju shtynin të MOS e postonit atë online? (Zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. Frika se mund të kapem, arrestohem apo ndiqem penalisht	1
B. Frika se mund t'i bëj keq një shoku/shoqeje	2
C. Frika se mund të regjistrohem si dhunues seksual	3
D. Frika se emri im do të përfundojë në media dhe do të më prishet reputacioni	4
E. Paratë (nëse më ofrohen para)	5
F. Frika se mund të përjashtohem nga shkolla	6
G. Të qenit më i ndërgjegjshëm për mënyrën sesi kjo mund të ndikojë te personi që shfaqet në imazh/video	7
H. Tjetër _____	8
I. Refuzoj të përgjigjem	99

409. A i keni bërë ndonjëherë vetes suaj foto nudo apo imazhe ose video me përmbajtje të qartë seksuale?

1. Po 2. Jo 99. Refuzoj të përgjigjem

410. Çfarë keni bërë me këto imazhe ose video? (Zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. I kam mbajtur për vete	
B. Ia kam dërguar dikujt për të cilin nuk kisha ndonjë interes seksual (p.sh. një miku/mikeshe, shoku/shoqeje dhome etj.)	
C. Ia kam dërguar dikujt për të cilin kisha një interes seksual, por nuk isha në një marrëdhënie me të (p.sh. një të dashuri të ardhshëm, një të dashurë të ardhshme, një personi me të cilin dëshiroja të flirtoja)	

D. Ia kam dërguar dikujt me të cilin isha i/e përfshirë në marrëdhënie seksuale dhe/ose romantike (p.sh. partnerit/es apo ish-partnerit/es seksual/e apo romantik/e ose një personi me të cilin flirtoja)	
E. E kam postuar në mediat sociale. Specifikoni _____	
F. Refuzoj të përgjigjem	

411. A mendoni se personat që postojnë imazhe dhe/ose video pa dëshirën e personave të përfshirë duhet të përballen me pasoja? Nëse po, me çfarë pasojash? (Zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. Duhet të ndiqen penalisht dhe të dënohen me burg	
B. Duhet të gjobiten	
C. Duhet të regjistrohen si dhunues seksualë	
D. Duhet të detyrohen të marrin këshillim	
E. Duhet të detyrohen të paguajnë dëmshpërblim financiar	
F. Duhet të përjashtohen nga shkolla	
G. Asnjë	
H. Tjetër (specifikoni) _____	
Refuzoj të përgjigjem	

412. A mendoni se faqja e internetit/media sociale që lejojnë postime të tilla duhet të përballen me pasoja? Nëse po, me çfarë pasojash? (Zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. Personat përgjegjës duhet të ndiqen penalisht dhe të dënohen me burg	
B. Personat përgjegjës duhet të gjobiten	
C. Personat përgjegjës duhet të regjistrohen si dhunues seksualë	
D. Emrat e personave përgjegjës duhet të bëhen të njohur për publikun përmes mediave	
E. Personat përgjegjës duhet të detyrohen të marrin këshillim	
G. Personat përgjegjës duhet të detyrohen të më paguajnë dëmshpërblim financiar	
H. Faqja e internetit duhet të mbyllet	
I. Asnjë	
J. Tjetër (specifikoni) _____	
Refuzoj të përgjigjem	

413. A keni rënë ndonjëherë pre e një shantazhuesi/ja?

1. Po 2. Jo (kalo te pyetja 501) 99. Refuzoj të përgjigjem (kalo te pyetja 501)
(nëse po, vazhdoni me pyetjet e tjera)

414. Cilën platformë ka përdorur shantazhuesi/ja juaj?

Instagram	1
Një aplikacion apo faqe interneti për njohje, si p.sh. Match/Tinder/E Harmony	2
Facebook/Messenger	3
Twitter	4
Snap Chat	5
Linked In	6
You Tube	7
Tik Tok	8
Një dhomë bisedimi (chatroom) në një videolojë	9
Tjetër (ju lutemi specifikoni)_____	10

415. Si jeni kontaktuar nga shantazhuesi/ja?

Ai ju njihte	1
Përmes një profili të rremë (“catfish”)	2
Përmes klikimit mbi një link	3
Përmes një shërbimi me pagesë (përmes platformave live të seksit)	4
Përmes profilin të tij real në një platformë për njohje	5
Përmes profilin të tij real në media sociale	6
Tjetër (ju lutemi specifikoni)	7

416. Cilës gjinie i përkiste shantazhuesi/ja juaj? 1.Mashkull 2.Femër 97.Nuk e di

417. Çfarë lloj materialesh intime ju janë vjedhur apo çfarë lloj veprimesh intime ju janë kërkuar me anë të shantazhit? (zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. Imazhe	
B. Video	
C. Biseda seksuale (sexting)	
D. Akte/favore seksuale të vazhdueshme	
E. Tjetër (ju lutemi specifikoni)	

418. Në ç'mënyrë është kryer shantazhi? (zgjidhni të gjitha pohimet e vërteta)

A. Shantazh për para	
B. Shantazh për përfitime materiale	
C. Shantazh për aktivitet seksual të mëtejshëm	
D. Përdorim i imazheve/videove vetëm për hakmarrje (porno hakmarrëse)	
E. Përdorim i imazheve/videove në formë kërcënimi për t'ju mbajtur nën kontroll (në një marrëdhënie intime apo shoqërore)	
F. Tjetër (ju lutemi specifikoni) _____	

419. Sa ka zgjatur kjo përvojë?

1-3 muaj

Deri në 6 muaj

Deri në 9 muaj

Pothuajse një vit

Më shumë se një vit

420. Nga 1-10 (ku 1 është shkalla më e ulët) sa ka ndikuar kjo përvojë në jetën tuaj? _____
(shëno një numër)

421. A e keni raportuar shantazhuesin/en?

1. Po

2. Jo

436 a. Nëse po, ku:

Te platformat e njohjeve

Te platformat e mediave sociale

Te policia

Tjetër _____

422. A kishit apo a gjetët ndonjë mbështetje/përfaqësim ligjor pas përvojës suaj?

1. Duke kërkuar në internet në internet
2. Organizatë bamirësie/OJF (p.sh. Women's Aid)
3. Mbështetje nga miqtë/familja
4. Këshillim
5. Mbështetje për viktimat (përmes policisë)
6. Avokat
7. Tjetër (ju lutemi specifikoni)

SEKSIONI 5. KRIZAT SHOQËRORE DHE DHUNA

501. A mendoni se krizat shoqërore, si për shembull pandemia e Covid-19, ndikojnë në nivelin e dhunës, në një shoqëri?

Po (shko tek 502)

2. Jo

97. Nuk e di

99. Refuzoj

502. Nëse po, mendoni se krizat shoqërore kanë më shumë gjasë të çojnë në (mund të shënoni më shumë se një alternativë):

1. Rritjen e dhunës	
2. Uljen e dhunës	
3. Mos/nën-raportimin e dhunës	
4. Mbiraportimin e dhunës	
5. Shtimin e dhunës vetëm brenda familjes	
6. Shtimin e dhunës vetëm në komunitet/mjedise publike	
7. Tjetër. Specifiko _____	

503. Sipas perceptimit dhe eksperiencës suaj që nga muaji mars 2020 e në vijim, si ka ndikuar mbyllja dhe në përgjithësi kriza e pandemisë së Covid-19 në situatën e dhunës në:

	1 (përkeqësuar shumë)	2 (përkeqësuar disi)	3 (nuk i ka ndryshuar)	4 (përmirësuar disi)	5 (përmirësuar shumë)	97 E paaplikueshme/ Nuk ka lidhje
Familjen tuaj	1	2	4	4	5	
Marrëdhënien tuaj në çift	1	2	4	4	5	
Komunitetin tuaj	1	2	4	4	5	
Lagjen tuaj	1	2	4	4	5	

7.2. Guida e FG

Fokus grup – Dhuna në marrëdhënie intime

Letër informuese

Ky fokus grup po realizohet në kuadrin e një studimi për “Dhunën në marrëdhënie intime”, i kryer nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), i cili realizon vazhdimisht studime mbi tema të ndryshme që lidhen me gratë dhe çështjet e barazisë gjinore. Studimi është bërë në kuadrin e programit “Mbrojtje dhe Promovim i të Drejtave të Grave në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze. Do t'ju ish mirënjohës/e nëse do t'i përgjigjeshit pyetjeve tona rreth opinioneve dhe përvojave tuaja lidhur me sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e burrave/grave dhe marrëdhënieve intime mes tyre dhe zhvillimet socio-kulturore lidhur me to në shoqërinë tonë.

Dëshirojmë t'ju sigurojmë se i gjithë informacioni që ne mbledhim do të ruhet me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoret vetëm për qëllime kërkimore. Asnjë individ apo adresë e veçantë nuk do të mund të identifikohet në asnjë prej fazave të kërkimit/studimit. Pjesëmarrja juaj në studim është krejtësisht vullnetare dhe në çdo çast mund të ndiheni të lirë të mos t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara apo të tërhiqeni nga pjesëmarrja në studim.

Të dhëna mbi pjesëmarrësit në diskutim.

Gjinia: _____

Mosha: _____

Zona: _____

Marrja e lejes për regjistrimin e FG

Pyetjet

1. Çfarë konsiderohet dhunë me bazë gjinore? Po dhunë seksuale? Kur do thoshit se ka dhunë në marrëdhëniet intime? (eksploro për diferenca gjinore dhe të ndonjë natyre tjetër, zona rurale – urbane, arsimimi etj.)
 - Ku ndryshojnë djemtë dhe vajzat në (mos)tolerancën që kanë për dhunën në përgjithësi? Po në marrëdhëniet intime? (shiko për situata: në martesë, kur dikush ka pirë, veshja ekstravagante, kur ka flirtuar më përpara, kur nuk thotë shprehimisht jo etj.)
2. Cilët janë faktorët që mendoni se shkaktojnë:
 - Dhunën në familje në përgjithësi?
 - Dhunë me bazë gjinore? Po dhunën në marrëdhëniet intime?

- Dhunën seksuale në veçanti?
 - Eksploro qëndrimet mbi alkoolin, përdorimin e drogave, shëndeti mendor, faktorët ekonomike, pabarazia ekonomike e grave, normat shoqërore?
3. Si mendoni, a kanë ndryshuar stereotipat/paragjykimet me bazë gjinore në komunitetin tuaj/lagjen tuaj?
 - Nëse po, çfarë është përmirësuar dhe çfarë jo? Mund të më jepni disa shembuj? Çfarë e ka shkaktuar këtë ndryshim?
 - Nëse jo, jepni shembuj dhe shpjegoni arsyet pse.
 4. Nga gjetjet është vënë re se ka një tendencë për të raportuar më shumë dhunën në komunitet sesa në familje/personalisht. Cilat janë barrierat që i bëjnë njerëzit më të rezervuar për ta raportuar dhunën kur vjen puna në nivel individual/familje?
 - Dhunën me bazë gjinore
 - Dhunën seksuale
 - Dhunën online?
 5. Sa të mirë-informuar ndjeni se jeni ju / bashkëmoshatarët tuaj për ta raportuar dhunën? Ku do drejtoheshit në situata të tilla? Po njerëzit e tjerë që njihni, ku mendoni se do drejtoheshin? Pse? (njerëz / institucione specifike)
 - Si do ishte efektive që të organizoheshin fushata që mundësonin vajtjen e mesazhit tek burrat dhe zonat rurale që rezultojnë më pak të informuara/të njohura me fushata ndërgjegjësuese?
 - Në zona rurale OJF – të janë më të përmendura sesa në zonat urbane. Si e shpjegoni këtë?
 6. Përdorimi i metodave kontraceptive mbetet i ulët, sipas rezultateve të studimit, si mendoni, pse është ashtu? (diferenca gjinore, të ndonjë natyre tjetër – zone, arsimimi, statusi marrëdhënieje)
 7. Pse marrëdhëniet me ish – partnerët kanë një incidencë më të lartë të dhunës?
 8. A ka elementë që lidhen me raportimin e dhunës që janë ende tabu? (p.sh. dhuna seksuale nga anëtarët e familjes, të afërmit e tjerë). A ka ndryshime mes raportimit të djemve dhe vajzave dhe zonale në raport me këto tabu – të?
 9. Si mendoni, pse ka një ndryshim mes faktit se është thënë se pornografia është e përhapur, ndërsa në nivel personal është e vështirë për ta pranuar?
 10. Si ndikon pornografia në marrëdhëniet intime? Çfarë pasojash ka?
 11. Si e shikoni rrezikun që vjen nga shkëmbimi i imazheve/videove personale/seksuale ose sexting online? (rrjeteve sociale, portaleve, dating applications etj.)
 12. A keni informacion të mjaftueshëm për të përballuar një situatë të tillë? Po bashkëmoshatarët? Çfarë do ju ndihmonte? (për përballim shantazh ose përfshirje në diçka të tillë për të cilën mund të jeni të pasigurt më vonë).

13. Si mendoni, si ka ndikuar situata që po kalojmë e pandemisë nga COVID – 19 në çështjet që diskutuam? Cila mund të jetë më e afektuar? Pse?

- Ndonjë gjë tjetër që do donit të shtonit.
- Mbyllja dhe falënderimet.

7.3. Lista e kërkueseve në terren

QYTETI	EMRI I ANKETUESES
Vlorë	Klodiana Xhelili
Fier	Xhensila Murati
Saranda	Xheni Shehu
Gjirokastra	Xheni Shehu
Shkodra	Besara Podgorica
Lezha	Sindi Kola
Kukes	Sindi Kola
Dibra	Sidorela Horeshka
Pogradec	Ina Blaceri
Korça	Olgerta Demelli
Elbasan	Nertila Tole
Tirana	Megi Zylali
	Lirie Dina
	Vjollca Kekezi
Berat	Zoica Bardhi
Durrës	Leonora Rexha
	Aida Zyka